Fusha e politikave të drogës do të trajtohet përmes një procesi të dedikuar strategjik, i cili synon krijimin e një kuadri të unifikuar dhe gjithëpërfshirës në nivel kombëtar. Në këtë kuadër, ka iniciuar procesi për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Drogave 2030 dhe Planit të saj shoqërues të Veprimit, aktualisht në zhvillim, në zbatim të urdhrit të ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 42, datë 22.01.2026 "Për ngritjen e grupit ndërsektorial të punës përgjegjës për hartimin e këtij dokumenti strategjik". Brenda kësaj kornize, strategjia synon të konsolidojë në një qasje të vetme dhe të integruar shtyllat e reduktimit të ofertës, reduktimit të kërkesës dhe reduktimit të dëmit, duke siguruar koordinim efektiv ndërinstitucional, mekanizma të fuqizuar monitorimi dhe përafrim të plotë me kuadrin strategjik të përditësuar të Bashkimit Evropian në fushën e drogës.

Korrupsioni

Korrupsioni përbën **një nga kërcënimet më të rëndësishme**, i cili ka evoluar drejt formave më të sofistikuara dhe të fshehta, duke prodhuar ndikime të ndjeshme në institucionet, ekonominë dhe sigurinë publike dhe duke shërbyer si një mekanizëm kyç që mundëson zgjerimin e krimit të organizuar. Ky fenomen përdoret për përfitime personale, manipulim të procedurave ligjore dhe keqpërdorim të fondeve publike, si dhe për pastrimin e të ardhurave të paligjshme. Kalimi nga korrupsioni i drejtpërdrejtë dhe i dukshëm në forma më të sofistikuara, dhe më pak të dukshme, si: përdorimi i ndërmjetësve dhe rrjeteve të tërthorta[3], struktura financiare më të ndërlikuara *(offshore,* kompani fiktive), ndërthurja me krimin ekonomik dhe konfliktet e interesit.

Pastrimi i parasë

Pastrimi i parave është vlerësuar si një nga **kërcënimet kryesore**, **pasi përbën një mekanizëm mundësues thelbësor për krimin e organizuar**. Ai u lejon kriminelëve të legjitimojnë të ardhurat e aktiviteteve të tyre të paligjshme dhe të integrojnë fondet e paligjshme në ekonominë legjitime duke siguruar një rrjedhë të vazhdueshme fondesh për të financuar operacione të mëtejshme kriminale, për të zgjeruar ndikimin e tyre ose për të shtuar pasurinë e tyre personale.

Pastrimi i parasë ka evoluar nga metoda tradicionale drejt skemave me komplekse me shtirje ndërkombëtare. Gjatë viteve të fundit, evidentohet një model i integruar i pastrimit të parave, i lidhur ngushtë me aktivitete kryesore kriminale nga të cilat kanë burimin këto të ardhura kriminale, si trafiku i narkotikëve, trafiku i armëve, emigrimi i paligjshëm, trafikimi i qenieve njerëzore dhe skemat mashtruese financiare. Skemat e pastrimit karakterizohen nga diversifikimi i kanaleve të transferimit dhe maskimit të fondeve, duke përfshirë sisteme informale të transferimit të vlerave

---

[3] *Rrjete të tërthorta u referohen marrëdhënieve jo të drejtpërdrejta.*

(Hawala), përdorimin e kriptovalutave, qarkullimin intensive të parasë *cash* dhe fragmentimin e transaksioneve për të shmangur raportimin financiar.

(*Për ta ilustruar, në vitin 2024 janë vërejtur **13** tipologji*[4] *të konsideruara me rrezik për pastrim parash dhe të referuara në organet ligj zbatuese për hetime të mëtejshme, kundrejt 7 tipologjive të konstatuara në dy vitet e mëparshme.)*

Krimet kibernetike

Krimet kibernetike janë rritur me 98%, pothuajse dyfishi i atyre të evidentuara në periudhën 2022–2023. Kjo rritje progresive e numrit të rasteve është ndikuar nga ndërthurja e tre faktorëve kryesorë: përhapja e gjerë e teknologjisë, evoluimi i metodave kriminale dhe mungesa relative e ndërgjegjësimit dhe edukimit në fushën e sigurisë së informacionit.

Krimet kompjuterike po evoluojnë si në shtrirje, ashtu edhe në kompleksitet dhe ndikim, duke kërkuar qasje gjithnjë e më të avancuara në parandalim dhe hetim.

Krimi kibernetik sot është një infrastrukturë mbështetëse për krimin e organizuar tradicional. Ai nuk është vetëm një krim më vete, por një mjet që lehtëson, përshpejton dhe fsheh aktivitete si pastrimi i parave, aktivitete në fushën trafiqeve të paligjshme, migracioni i parregullt etj. Ai e bën pastrimin e parave më të fshehtë, trafikun më global, migracionin e parregullt më të koordinuar etj.

Ndërhyrjet në mënyrë të paligjshme në të dhënat kompjuterike

Ndërhyrjet në të dhënat kompjuterike përbëjnë një **kërcënim në rritje** për sigurinë publike, ekonominë dhe funksionimin e institucioneve shtetërore. Këto veprime përfshijnë aksesin e paautorizuar, manipulimin, fshirjen, dëmtimin ose bllokimin e sistemeve dhe të dhënave kompjuterike, duke cenuar integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e informacionit. Kërcënimi bëhet veçanërisht i rëndësishëm për shkak të varësisë së lartë të institucioneve, bizneseve dhe shërbimeve kritike nga teknologjia dhe infrastruktura digjitale.

Sulmet kibernetike, që përfshihen në këtë vepër penale zënë një vend kyç jo domosdoshmërisht për shkak të frekuencës së tyre, por për shkak të ndikimit të lartë që mund të prodhojnë ndaj institucioneve, infrastrukturave kritike dhe sigurisë kombëtare. Ato përfaqësojnë një **kërcënim me intensitet të lartë**, ku raporti **"numër i ulët-ndikim i lartë"** i vendos ato në kategorinë e rreziqeve prioritare. Ato kanë kaluar nga forma të thjeshta të dëmtimit ose vjedhjes së të dhënave në operacione komplekse që përfshijnë *ransomware*, sabotim të sistemeve dhe sulme ndaj infrastrukturave kritike.

Pornografia *online* me të mitur

Përfshin prodhimin, shpërndarjen, posedimin dhe shkëmbimin e materialeve me përmbajtje seksuale me të mitur përmes platformave digjitale dhe rrjeteve sociale. Viktimat janë kryesisht fëmijë dhe adoleshentë, të ekspozuar ndaj *grooming*, shantazhit seksual dhe abuzimit *online*. Fenomeni favorizohet nga anonimiteti i internetit, përdorimi i pakontrolluar i teknologjisë dhe mungesa e edukimit digjital. Karakterizohet nga vështirësi hetimore, për shkak të natyrës transnacionale, enkriptimit dhe serverëve jashtë territorit të Shqipërisë. Evoluimi i inteligjencës artificiale dhe teknologjive të manipulimit digjital shton më tej kompleksitetin e kërcënimit, duke krijuar forma të reja të abuzimit.

Mashtrimet *online*

Mashtrimet *online* përfshijnë përdorimin e platformave digjitale për përfitime të paligjshme financiare përmes mashtrimeve me pagesa elektronike, *phishing*-ut, identiteteve të rreme, investimeve fiktive, dhe formave të tjera të manipulimit *online*. Kriptomonedha shfaqet si një metodë pagese dhe si një produkt mashtrimi investimi. Mashtrimi i investimeve dhe

---

[4] *Raporti Vjetor 2024 i Agjencisë së Inteligjencës Financiare, faqe 33–50.*

kompromettimi i *email*-eve të biznesit mbeten skemat më të përdorshme të mashtrimit *online*. **Evoluimi i ardhshëm** i këtyre krimeve pritet të lidhet ngushtë me zhvillimet teknologjike dhe digjitalizimin në rritje të shërbimeve. Pritet rritje e përdorimit të *"deepfake",* mesazheve të personalizuara dhe platformave të enkriptuara për realizimin e mashtrimeve më komplekse. Gjithashtu, përdorimi i kriptomonedhave mund të krijojnë hapësira të reja për fshehjen e gjurmëve financiare dhe transferimin e fitimeve të paligjshme.

Dhënia e ndihmës për kalime të paligjshme të kufirit

Dhënia e ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit vazhdon të jetë një aktivitet kriminal tërheqës dhe fitimprurës. Ai i nënshtrohet faktorëve të shumtë globalë të cilët nxisin dhe lehtësojnë këtë aktivitet duke ndikuar Shqipërinë si pikë hyrjeje, tranziti dhe daljeje. Dhënia e ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit, në thelb është një krim fizik ndërkufitar, por që është e lidhur ngushtë me zhvillimet digjitale dhe teknologjike, siç është mbështetja në platformat *online* për marketing, rekrutim, komunikim dhe transferime parash, si edhe keqpërdorimi i aplikacioneve *online* si hartimi i rrugëve për të organizuar udhëtime për migrantët e parregullt. Trafikimi i njerëzve përbën një **kërcënim të vazhdueshëm** për sigurinë kufitare, rendin publik dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke u zhvilluar kryesisht përmes rrjeteve të organizuara kriminale që shfrytëzojnë flukset migratore, paqëndrueshmërinë ekonomike dhe konfliktet rajonale. **Evoluimi** i fenomenit në të ardhmen pritet të lidhet me rritjen e përdorimit të teknologjisë dhe platformave *online* për rekrutimin, koordinimin dhe pagesat, si dhe me zhvendosjen e rrugëve të kontrabandimit në varësi të presionit ligjzbatues dhe zhvillimeve gjeopolitike në rajonin e Lindjes së Mesme.

Krimet mjedisore

Krimet mjedisore përbëjnë një **kërcënim në rritje** për sigurinë mjedisore, ekonomike dhe publike, pasi ato ndikojnë drejtpërdrejt në degradimin e burimeve natyrore, humbjen e biodiversitetit dhe përkeqësimin e cilësisë së jetës së popullsisë. Veprimtari si ndotja e ajrit dhe ujërave, prerja e paligjshme e pyjeve, dëmtimi i habitateve të mbrojtura apo menaxhimi i paligjshëm i mbetjeve të rrezikshme shkaktojnë degradim afatgjatë të ekosistemeve dhe rrisin rrezikun për shëndetin publik. Krimet mjedisore po konsiderohen gjithnjë e më shumë si fushë me rrezik të lartë, sepse ato kombinojnë fitime të mëdha me rrezik penal relativisht të ulët. Gjithashtu, shfaqin rrezik të lartë jo vetëm për dëmin e menjëhershëm që shkaktojnë, por edhe për ndikimin të zgjatur në kohë. **Evoluimi** i krimeve mjedisore karakterizohet nga zgjerimi i formave të veprimit dhe rritja e kompleksitetit të tyre, të nxitura nga përfitimet ekonomike, urbanizimi, aktivitetet industriale dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve natyrore.

Përveç analizës së kërcënimit të raportit "Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit të Organizuar dhe të Rëndë (SOCTA 2026)", vlerësimi i zbatimit të strategjisë së mëparshme ka shërbyer si bazë për zhvillimin e kësaj strategjie.

Bazuar në një analizë të hollësishme të të dhënave, përfshirë raportet e monitorimit të përgatitura nga Ministria e Punëve të Brendshme, evidencat dhe të dhënat nga një spektër i gjerë i burimeve institucionale dhe ndërkombëtare, vlerësimi i kërcënimit shërben si bazë për një kornizë strategjike më të fokusuar dhe të orientuar drejt rezultateve që kontribuon në adresimin e boshllëqeve dhe mangësive të identifikuara. Vlerësimi i kërcënimit nënvizon natyrën gjithnjë e më transnacionale dhe teknologjikisht të sofistikuar të këtyre kërcënimeve të krimit të organizuar, duke kërkuar përgjigje politike të forta dhe të përshtatshme.

Masat e zbatimit më vete nuk janë të mjaftueshme për t'iu kundërvënë efektivisht infiltrimit ekonomik nga krimi i organizuar. Një përgjigje gjithëpërfshirëse kërkon një theks më të fortë në **kornizat parandaluese**, që synojnë reduktimin e cenueshmërive përpara se aktiviteti kriminal të materializohet. Kjo përfshin **mekanizma të fortë administrativë dhe rregullatorë**, mbikëqyrje

efektive të bazuar në vlerësim rreziku dhe detyrime të forcuara të kujdesit të duhur në sektorët me rrezik të lartë, për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe trajtimin e këtyre kërcënimeve. Mjetet parandaluese si transparenca e pronarit përfitues, sistemet e zbulimit të hershëm dhe monitorimi i përmirësuar i flukseve financiare, luajnë rol përcaktues në identifikimin dhe zbutjen e rreziqeve në një fazë të hershme.

Në të njëjtën kohë, këto masa parandaluese duhet të plotësohen nga ndërprerja efektive financiare e krimit, përfshirë gjurmimin, sekuestrimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve, për të siguruar që rrjetet kriminale jo vetëm të zbulohen herët, por edhe të privohen nga fuqia e tyre ekonomike. Së bashku, parandalimi dhe zbatimi, formojnë një qasje koherente dhe reciprokisht përforcuese për trajtimin e infiltrimit të krimit të organizuar.

Të dhënat nga autoritetet ligjzbatuese kombëtare dhe partnerët ndërkombëtarë tregojnë se grupet shqiptare të krimit të organizuar kanë evoluar në rrjete transnacionale shumë fleksibël dhe të afta për t'u përshtatur, me lidhje të forta logjistike, financiare dhe me bazë diasporike në të gjithë Evropën. Këto rrjete luajnë një rol të rëndësishëm në tregjet kriminale evropiane, veçanërisht në operacionet e trafikimit të drogës që lidhin Amerikën Latine me Evropën përmes pikave kryesore të hyrjes detare dhe korridoreve të shpërndarjes tokësore. Vlerësimet e kryera me metoda që kombinojnë modelet e bazuara në sekuestrime dhe ato të bazuara në konsum, tregon se grupet shqiptare të krimit të organizuar janë të integruara ndjeshëm në tregjet evropiane të drogës.

Të dhënat operacionale nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) konfirmojnë se hetimet e krimit të organizuar mbeten strukturalisht të rëndësishme dhe gjithnjë e më komplekse. Në vitin 2025 janë regjistruar 74 çështje të krimit të organizuar. Gjithsej, 261 çështje kanë qenë nën hetim, ndërsa 185 persona janë hetuar dhe 183 persona janë dërguar në gjykatë.

Pavarësisht reduktimit të çështjeve të reja të regjistruara krahasuar me vitin e mëparshëm, numri i individëve të përfshirë në hetime u rrit, duke treguar një zhvendosje drejt synimit të rrjeteve më të mëdha dhe më komplekse kriminale.

Të dhënat nga Prokuroria e Përgjithshme (2021–2024) demonstrojnë më tej shkallën e aktivitetit kriminal të organizuar dhe përdorimin në rritje të teknikave proaktive të hetimit. Në vitin 2024 janë nisur 155 procedime penale, janë zhvilluar 405 hetime proaktive dhe janë regjistruar 354 arrestime ose ndalime. Për sa i përket **trafikimit të lëndëve narkotike**, me përjashtim të *kanabisit,* ku Shqipëria është vendi i origjinës, vendi ynë shfaqet si vend transiti në kategoritë e tjera të lëndëve narkotike, si heroina dhe kokaina. Sasitë e lëndëve narkotike të destinuara për tregun e brendshëm janë të vogla dhe shumica kalohet transit përmes territorit shqiptar, me destinacion vendet e BE-së. Vitet e fundit është zgjeruar aktiviteti i trafikimit të kokainës, e prodhuar në vendet e Amerikës së Jugut (Kolumbi, Ekuador dhe Brazil), e transportuar me rruga detare në Portin e Durrësit dhe duke vazhduar më pas drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Grupet kriminale shqiptare vazhdojnë të jenë kryesisht aktive në trafikimin e kokainës dhe kanabisit. Këto grupe janë aktive në disa shtete të Bashkimit Evropian (BE), kryesisht në Itali, Spanjë, Belgjikë, Holandë, Francë, Gjermani, si dhe në vende të tjera si Norvegji, Zvicër dhe Mbretëria e Bashkuar (MB). Këto konstatime përputhen edhe me konstatimet e raportit të Europolit për vitin 2024. Siç theksohet në raportin vjetor të SPAK-ut të vitit 2023, grupet kriminale shqiptare kanë arritur tashmë të sigurojnë blerjen e kokainës në vendet e prodhimit në Amerikën Latine. Kokaina porositet kryesisht në sasi të konsiderueshme në Bolivi, Meksikë, Peru, Ekuador dhe Paraguai. Shtetas shqiptarë, pjesëtarë të grupeve kriminale shqiptare, që banojnë në Brazil, Paraguai, Ekuador dhe Surinam, në disa raste në role drejtuese brenda grupit kriminal ose në raste

të tjera në role dytësore (kryesisht koordinuese), ndjekin të gjithë procesin e transferimit të ngarkesës nga vendi i origjinës deri në destinacion.

Këta tregues pasqyrojnë një fokus të rritur institucional në goditjen e rrjeteve të strukturuara kriminale në vend të adresimit të akteve kriminale të izoluara.

Të dhënat e inteligjencës financiare evidentojnë përmasën dhe natyrën sistemike të rreziqeve që lidhen me krimin financiar dhe pastrimin e produkteve të veprës penale. Gjatë periudhës 2019–2025, Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) ka referuar pranë autoriteteve ligjzbatuese gjithsej 1,911 raste të dyshuara për veprimtari financiare të paligjshme. Nga këto, 307 raste janë dërguar për ndjekje dhe vlerësim pranë prokurorive, 252 raste Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ndërsa 1,352 raste janë referuar pranë Policisë së Shtetit për veprime të mëtejshme operative dhe hetimore.

Treguesit e rikuperimit të aseteve ilustrojnë më tej shkallën financiare të krimit të organizuar. Në vitin 2025, afërsisht **45.4 milionë euro** në asete kriminale u sekuestruan ose konfiskuan, përfshirë **12.4 milionë euro në asete kriptovalutash**.

Të dhënat nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) tregojnë se menaxhimi i aseteve është bërë një komponent gjithnjë e më i rëndësishëm i përgjigjes së Shqipërisë ndaj krimit të organizuar.

Megjithatë, sfidat strukturore mbeten, përfshirë përgjegjësitë e fragmentuara institucionale, kostot e mirëmbajtjes së aseteve, kufizimet e regjistrimit ligjor dhe kapacitetin e kufizuar për të menaxhuar asete komplekse si bizneset dhe instrumentet financiare digjitale.

Në tërësi, këta tregues konfirmojnë se krimi i organizuar që prek Shqipërinë vepron si pjesë e një ekosistemi më të gjerë kriminal transnacional, duke kombinuar rrjetet e trafikimit të drogës, infrastrukturat financiare, rreziqet e korrupsionit dhe mekanizmat komplekse të pastrimit të parave.

Analiza identifikon disa tregje kriminale që paraqesin **kërcënimet më të rëndësishme** për Shqipërinë dhe partnerët e saj ndërkombëtarë.

Grupet e strukturuara kriminale përfaqësojnë kornizën organizative bazë të krimit të organizuar dhe përbëjnë **54% të rasteve të krimit të rëndë të organizuar** në profilin e rrezikut të SPAK-ut të vitit 2025.

Këto grupe veprojnë përmes strukturave fleksibël dhe shpesh transnacionale, duke përfshirë qelizat e udhëheqjes dhe koordinimit, rrjetet e menaxhimit financiar dhe mbështetje logjistike. Në vitin 2025, SPAK-u mori pjesë në 6 Skuadra të reja të Përbashkëta Hetimore dhe mbajti 26 të tilla aktive, duke nxjerrë në pah dimensionin ndërkombëtar të këtyre rrjeteve.

Krimi financiar dhe ekonomik përbën një kërcënim qendror dhe në evoluim për sistemin financiar të Shqipërisë, integritetin ekonomik dhe sundimin e ligjit. Ndërsa **pastrimi i parave** mbetet një komponent kyç, ai është pjesë e një spektri më të gjerë aktivitetesh kriminale që përfshin evazionin tatimor, mashtrimin dhe korrupsionin, keqpërdorimin e strukturave të bizneseve dhe flukset e paligjshme financiare të lidhura me krimin e organizuar. Këto aktivitete janë të ndërlidhura ngushtë dhe së bashku mbajnë rrjetet kriminale, duke u mundësuar atyre të infiltrohen në ekonominë e ligjshme, të shtrembërojnë konkurrencën e tregut dhe të minojnë institucionet publike. Skemat e sofistikuara të krimit financiar shfrytëzojnë cenueshmëritë në sektorët formalë dhe joformalë, me rrezik të veçantë të identifikuar në sektorin e patundshmërive, ndërtimit, turizmit, dhe shërbimeve telematike. Këta sektorë shpesh shërbejnë si kanale për integrimin e fondeve të paligjshme në ekonominë e ligjshme. Tipologjitë e reja demonstrojnë kompleksitet në rritje, përfshirë shtresimin e fondeve përmes sistemit bankar, transaksioneve ndërkufitare, kontrabandës së parave kesh, pastrimit të parave të bazuar në tregti dhe investimeve në asete me vlerë të lartë. Përdorimi i kompanive guaskë, aktiviteteve fiktive të biznesit dhe rregullimeve

ligjore të dizajnuara për të fshehur pronësinë përfituese dhe origjinën e të ardhurave, ndërlikon më tej përpjekjet e zbulimit dhe zbatimit. Në periudhën 2019-2025 AIF ka nxjerrë 52 urdhra të përkohshëm bllokimi në një vlerë prej afërsisht 26 milionë eurosh, prej të cilave mesatarisht 91% janë sekuestruar me vendim të Prokurorisë apo Gjykatës. SPAK-u regjistroi 32 procedime për pastrim parash në vitin 2025, duke konfirmuar rolin qendror të krimit financiar.

Sektori i shërbimeve telematike, përfshirë *call center*-at, është shfaqur gjithashtu si një kanal i përdorur për aktivitetet e pastrimit, shpesh me elemente ndërkombëtare të destinuara për të penguar gjurmimin financiar. Përfshirja e profesioneve jofinanciare, si noterët dhe ndërmjetësit e, pasurive të paluajtshme, shton më tej shtresa kompleksiteti. Paralelisht, në nivel ndërkombëtar kriptovalutat dhe asetet e tjera virtuale, po përdoren gjithnjë e më shumë për të lehtësuar transaksionet anonime ose të vështira për t'u gjurmuar. Megjithatë, referuar Vlerësimit Kombëtar të Riskut 2023 për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, por edhe në analiza risku të mëvonshme (2025) ka rezultuar se përdorimi i kriptovalutave në pastrimin e parave në Shqipëri mbetet në nivele ende minimale krahasuar me monedhat FIAT, si në numër rastesh, ashtu edhe në vlera të përdorura.

Në këtë kontekst, bashkëpunimi publik-privat luan një rol kritik në parandalimin dhe zbulimin e krimit financiar dhe ekonomik. Një zhvillim pozitiv është ngritja dhe funksionimi i Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës (GTNP) ku nën koordinimin e AIF realizohen takime periodike. GTNP luan një rol të rëndësishëm në koordinimin e politikave, shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. GTNP ka si anëtar përfaqësues nga organe publike si Ministria e Financave, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme, Byroja Kombëtare e Hetimit, Shërbimi Informativ i Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë të Shtetit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ILDKPKI, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Qendra Kombëtare e Biznesit, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Autoriteti i Mbikëqyrjes të Lojërave të Fatit, Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, si dhe përfaqësues të sektorit privat si Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dhoma Shqiptare e Avokatisë, Shoqata Shqiptare e Bankave, Shoqata Kombëtare e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme (NAREA), Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), Shoqata e Agjencive të Këmbimit Valutor (AFEA), Shoqata e Ndërtuesve dhe Instituti për Demokraci dhe ndërmjetësim (IDM) etj.

Njëkohësisht, korrupsioni mbetet një mundësues i vazhdueshëm dhe një formë e veçantë e krimit të organizuar në vetvete, duke minuar proceset e zbatimit të ligjit. Grupet kriminale shfrytëzojnë rregullisht dobësitë në administratën publike, duke përdorur marrëdhëniet e korruptuara për të lehtësuar aktivitetet e paligjshme dhe për t'i shmangur zbulimit. Këto dinamika u mundësojnë rrjeteve të paligjshme të lehtësojnë operacionet, t'i shmangin zbulimit dhe të sigurojnë pandëshkueshmëri.

Në vitin 2025, SPAK-u regjistroi 10 raste të korrupsionit të nivelit të lartë, 13 të pandehur, 30 zyrtarë të lartë nën hetim, 18 zyrtarë të dërguar në gjykatë.

Pozicioni strategjik gjeografik i Shqipërisë, në udhëkryqin e Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian, e bën atë shumë të cenueshme ndaj **kalimit të paligjshëm të kufirit nga emigrantët dhe trafikimit të qenieve njerëzore**. Janë identifikuar dy forma kryesore: kalimi i paligjshëm i shtetasve shqiptarë që kërkojnë hyrje të paligjshme në Mbretërinë e Bashkuar, Shtetet

e Bashkuara dhe Kanada, dhe kalimi transit i shtetasve nga vendet e treta, veçanërisht nga Pakistani, Egjipti dhe Bangladeshi, drejt BE-së. Grupet e organizuara përdorin falsifikim të avancuar të dokumenteve, shfrytëzojnë sistemet e lejeve të punës dhe vizave, dhe përdorin metoda të sofistikuara pagese, përfshirë kriptovalutat, për të lehtësuar emigrimin e paligjshëm. Grupet e cenueshme dhe të margjinalizuara, si gratë, fëmijët dhe pakicat etnike, mbeten në mënyrë disproporcionale të prekur nga këto aktivitete kriminale. Aktualisht, janë identifikuar dy forma të trafikimit të qenieve njerëzore.

Forma e parë e trafikimit përfshin shtetas shqiptarë që synojnë të udhëtojnë në mënyrë të paligjshme drejt Mbretërisë së Bashkuar, SHBA-së dhe Kanadasë. Grupet kriminale menaxhojnë të gjithë procesin, nga falsifikimi i dokumenteve të identifikimit të vendeve të BE-së deri tek organizimi i udhëtimit, akomodimit dhe orientimit të personave. Vihet re përdorimi i teknologjive të avancuara për falsifikimin e dokumenteve, si dhe i metodave më të sofistikuara të pagesës, përfshirë kriptovalutat.

Forma e dytë karakterizohet nga trafikimi i shtetasve që vijnë nga vendet e treta që përdorin Shqipërinë si pikë transiti, duke u larguar më pas në mënyrë të paligjshme drejt vendeve të BE-së. Të dhënat tregojnë se pas një rënieje të ndjeshme të numrit të imigrantëve të parregullt në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023, gjatë vitit 2025 është regjistruar një rikthim i trendit në rritje. Numri i imigrantëve të kapur u rrit me 25% në vitin 2025 dhe kjo tendencë vijon edhe gjatë vitit 2026, ku të dhënat e gjashtëmujorit të parë tregojnë një shtim të konsiderueshëm të flukseve migratore të parregullta drejt territorit shqiptar.

Analiza e të dhënave për vitin 2025 mbi shtetasit e vendeve të treta të identifikuar si viktima të trafikimit të qenieve njerëzore tregon një total prej 79 rastesh, nga të cilat shumica dërrmuese janë femra. Nga këto, 76 viktima janë gra dhe vetëm 3 janë meshkuj, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e rasteve paraqiten si viktima të dyshuara. Të dhënat evidentojnë një dominim të qartë të trafikimit të grave, kryesisht për qëllime shfrytëzimi seksual ose ekonomik, duke reflektuar tendencat ndërkombëtare të trafikimit të qenieve njerëzore. Gjithashtu, shpërndarja gjeografike e viktimave tregon se rrjetet kriminale veprojnë në mënyrë të organizuar dhe ndërkontinentale, duke përfshirë vende nga Azia, Amerika Latine, Afrika dhe Evropa Lindore.

Ndërkohë referuar të dhënave të administruara për vitin 2024 janë identifikuar dhe referuar gjithsej 178 viktima/viktima të mundshme trafikimi.

Ky fenomen trajtohet si prioritet i dedikuar në **Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2026–2030 dhe Planit të Veprimit të saj**, aktualisht në proces hartimi. Brenda kësaj kornize, kjo strategji fokusohet kryesisht në dimensionin e krimit të organizuar të kontrabandës dhe trafikimit të migrantëve, përfshirë përfshirjen e rrjeteve të strukturuara kriminale, lehtësimin ndërkufitar dhe flukset financiare.

Krimi mjedisor është shfaqur si një prioritet tematik i rëndësishëm brenda peizazhit të krimit të organizuar në Shqipëri, me ndikime në rritje mbi burimet natyrore, shëndetin publik, integritetin ekologjik dhe qëndrueshmërinë ekonomike të vendit. Të dhënat institucionale tregojnë një rritje të veprave penale mjedisore gjatë periudhës 2023–2025, duke reflektuar rëndësinë në rritje të këtij fenomeni në agjendën e zbatimit të ligjit. Krimi mjedisor trajtohet si një formë prioritare e krimit të organizuar, në përputhje me kërkesat e Direktivës (BE) 2024/1203, përmes një qasjeje të integruar që mbulon parandalimin, zbulimin, hetimin, ndjekjen penale, sanksionimin dhe konfiskimin e përfitimeve të paligjshme.

Krimi mjedisor mbetet një fushë me kompleksitet të shtuar, për shkak të natyrës së tij ndërsektoriale, mundësive për përfitime të larta dhe nevojës për koordinim të ngushtë ndërmjet institucioneve rregullatore dhe ligjzbatuese. Në këtë kuadër, është vënë re rëndësia e forcimit të

mëtejshëm të bashkëpunimit institucional dhe e rritjes së kapaciteteve hetimore dhe analitike në trajtimin e këtyre rasteve.

Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe territorit. Këto përfshijnë rishikimin dhe qartësimin e kompetencave të inspektorateve, me qëllim përmirësimin e koordinimit dhe reduktimin e mbivendosjeve funksionale, si dhe avancimin e proceseve të digjitalizimit të inspektimeve përmes platformës *e-Inspektimi.*

Zbatimi i teknologjive të avancuara, përfshirë monitorimin në kohë reale dhe përdorimin e mjeteve digjitale për dokumentimin e inspektimeve, synon të rrisë transparencën, efikasitetin dhe gjurmueshmërinë e proceseve administrative. Në këtë kuadër, është miratuar edhe një kuadër rregullator për metodologjinë e përcaktimit të masave administrative, i cili synon të forcojë qasjen e bazuar në rrezik dhe të sigurojë proporcionalitet në vendimmarrje.

Gjithashtu, janë ndërmarrë ndryshime ligjore në fushën penale dhe të planifikimit territorial, me fokus në forcimin e parandalimit dhe rritjen e efektivitetit të reagimit institucional ndaj veprave që dëmtojnë mjedisin dhe territorin, përfshirë zjarrvënien, ndërtimet e paligjshme dhe shkeljet në përdorimin e tokës. Këto ndryshime synojnë gjithashtu rritjen e përgjegjshmërisë institucionale dhe forcimin e integritetit në ushtrimin e funksioneve publike.

Në aspektin operacional, është rritur bashkëpunimi ndërmjet strukturave inspektuese në nivel qendror dhe vendor, si dhe është përmirësuar përdorimi i sistemeve digjitale për monitorim dhe kontroll, duke mundësuar një ndjekje më të efektshme të zbatimit të lejeve dhe identifikimin në kohë të shkeljeve të mundshme.

Në tërësi, këto zhvillime tregojnë një proces të vazhdueshëm të modernizimit të kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e mbrojtjes së mjedisit, me synim forcimin gradual të kapaciteteve parandaluese dhe zbatuese. Në këtë kontekst, vijon të jetë me rëndësi konsolidimi i mëtejshëm i koordinimit ndërinstitucional dhe zhvillimi i kapaciteteve teknike dhe hetimore, në funksion të rritjes së efektivitetit të përgjithshëm të sistemit.

Evoluimi i shpejtë i **krimit të mundësuar nga teknologjia kibernetike po riformëson mjedisin e kërcënimeve** në Shqipëri. Grupet kriminale të organizuara shfrytëzojnë përparimet teknologjike për të kryer mashtrime në shkallë të gjerë, vjedhje identiteti dhe skema financiare mashtruese, shpesh duke synuar viktima në juridiksione të shumta. Format e zakonshme të krimit kibernetik përfshijnë mashtrimin kompjuterik *(phishing, smishing),* kompromentimin e *email*-eve të biznesit dhe përdorimin e *deepfake*-ve të drejtuara nga IA. Në kuadër të ndërgjegjësimit, në faqen zyrtare të FIA-s është publikuar një udhëzues mbi sigurinë në epokën digjitale, i cili shpjegon konceptet e mashtrimit kompjuterik, metodat e zakonshme të mashtrimit kompjuterik, masat për mbrojtje dhe hapat që duhet ndjekur në rast se individi bie viktimë etj.

Grupet kriminale themelojnë kompani që operojnë platforma mashtruese investimi, duke përdorur *call centre* në Shqipëri dhe vendet fqinje për të mashtruar qytetarë, kryesisht nga shtetet anëtare të BE-së. Këto skema kanë rezultuar në miliona euro humbje dhe nxjerrin në pah rolin në rritje të Shqipërisë si qendër për aktivitetin kriminal të mundësuar nga teknologjia kibernetike.

Në të njëjtën kohë, **shfrytëzimi seksual i fëmijëve në internet** është një kërcënim gjithnjë e më serioz dhe në evoluim. Shkelësit përdorin platforma të enkriptuara, mediat sociale dhe rrjetin e errët për të prodhuar, shpërndarë dhe aksesuar materiale të abuzimit seksual të fëmijëve, si dhe për të joshur dhe shfrytëzuar të miturit. Natyra transnacionale e këtyre veprave penale, e kombinuar me përdorimin e teknologjive që rrisin anonimitetin, paraqet sfida të rëndësishme për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale. Adresimi i shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet kërkon kapacitete të forcuara të specializuara hetimore, bashkëpunim të rritur ndërkombëtar dhe një qasje

të orientuar nga viktima të harmonizuar me standardet e BE-së dhe ndërkombëtare. **Konvergjenca e operacioneve transnacionale dhe novacionit të shpejtë teknologjik** u mundëson grupeve kriminale shqiptare të veprojnë në juridiksione të shumta me një shkathtësi dhe anonimitet të paprecedentë, duke sfiduar qasjet tradicionale të zbatimit të ligjit.

Pavarësisht mjedisit kompleks dhe në evolucion të kërcënimit, Shqipëria ka arritur progres substancial në forcimin e përgjigjes ndaj krimit të organizuar. Periudha 2021-2025 është karakterizuar nga reforma institucionale, përparime ligjore, ngritje kapacitetesh dhe bashkëpunim i rritur ndërkombëtar.

Konsolidimi i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka qenë thelbësor për forcimin institucional, duke mundësuar hetime komplekse dhe duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar. Ngritja dhe funksionimi i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve në bazë të Ligjit nr. 44/2025, ka shtruar themelet që Shqipëria të përmirësojë gjurmimin dhe kapacitetet e konfiskimit, si edhe të harmonizojë praktikën kombëtare me standardet e BE-së. Megjithatë, zbatimi efektiv i mekanizmave të rikuperimit të aseteve dhe përdorimi sistematik i hetimeve financiare paralele mbetet i pabarabartë dhe kërkon konsolidim të mëtejshëm. Teksa hetimet financiare po integrohen gjithnjë e më shumë në çështjet e krimit të organizuar, zbatimi konsistent dhe proaktiv i tyre në të gjitha çështjet relevante është ende në zhvillim. Nismat e digjitalizimit kanë kontribuuar në modernizimin e doganave, menaxhimit të kufirit dhe sistemeve policore, duke përmirësuar efikasitetin dhe transparencën; megjithatë, mbeten sfida në garantimin e ndërveprueshmërisë së plotë, integrimin e të dhënave dhe përdorimin operacional efektiv.

Shqipëria ka ndërmarrë **reforma të rëndësishme ligjore** për të forcuar kornizën legjislative kundër krimit të organizuar dhe veprave penale të lidhura. Ndryshimet në ligjin nr. 7975 për lëndët narkotike dhe substancat psikotrope, të miratuara në fillim të vitit 2024, kanë modernizuar tabelat e klasifikimit dhe kanë lehtësuar përdorimin e kontrolluar të kanabisit për qëllime industriale dhe mjekësore. Kornizat ligjore dhe strategjike që adresojnë pastrimin e parave (PP), kundër financimit të terrorizmit (FT) dhe sigurinë kibernetike janë përditësuar, duke mundësuar zhvillimin e një infrastrukture të fortë institucionale dhe duke mbështetur hetimet e bazuara në inteligjencë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është përmirësuar dhe forcuar përmes pjesëmarrjes aktive të Shqipërisë në skuadrat e përbashkëta hetimore (SPH) dhe koordinimit të saj operacional të forcuar me Shtetet Anëtare të BE-së dhe agjencitë e BE-së, veçanërisht Europolin dhe Eurojustin, dhe partneritetit operacional me FRONTEX-in. Shqipëria është shteti i parë joanëtar i Bashkimit Evropian që ka vendosur njësi të FRONTEX-it në territorin e vet. Nisja e Operacionit të Përbashkët me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare, FRONTEX, që nga maji 2019, në kufirin juglindor të Shqipërisë, ka pasur ndikim pozitiv në menaxhimin e migracionit të paligjshëm në vendin tonë. Një nga rezultatet e para pozitive nga ky operacion ka qenë forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe logjistike për monitorimin e zonës kufitare. Si rezultat, identifikimi i migrantëve të paligjshëm në pikat e hyrjes përgjatë kufirit ka shënuar një rritje të rëndësishme, nga 40% e të gjitha rasteve në 2019 në 90-95% në 2023.

Në vijim të forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, në kuadër të procesit të integrimit evropian, me urdhrin nr. 127, datë 26.07.2024, u krijua Njësia Kombëtare e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm për Droga Sintetike dhe Substanca të Reja Psikoaktive, e cila gjatë vitit 2025 u bë plotësisht funksionale. Bashkëpunimi me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Drogat (EUDA) ka mundësuar shkëmbim të vazhdueshëm informacioni, përmes të cilit janë përcjellë 43 alarme për substanca të reja psikoaktive dhe janë identifikuar dy substanca të reja në territorin e vendit, njëra prej të cilave është raportuar në rrjetin evropian të paralajmërimit të hershëm. Ky bashkëpunim është shoqëruar gjithashtu me forcimin e kapaciteteve institucionale përmes

trajnimeve, takimeve teknike dhe shkëmbimit të praktikave më të mira evropiane për vlerësimin e rrezikut dhe monitorimin e këtyre substancave, si dhe me avancimin e koordinimit ndërinstitucional në nivel kombëtar për krijimin e një sistemi të integruar të paralajmërimit të hershëm.

Bashkëpunimi është fokusuar gjithnjë e më shumë në trajtimin e krimit të rëndë dhe të organizuar përmes hetimeve të koordinuara, shkëmbimit të inteligjencës dhe veprimeve operacionale të përbashkëta. Shqipëria ka vazhduar gjithashtu të thellojë bashkëpunimin në fushën e gjurmimit dhe rikuperimit të aseteve, përfshirë përmes ndërveprimit me strukturat përkatëse në Shtetet Anëtare të BE-së, duke mbështetur hetime ndërkufitare më efektive dhe konfiskimin e aseteve kriminale. Pjesëmarrja në mekanizmat dhe rrjetet ndërkombëtare ka mbështetur më tej harmonizimin me standardet e BE-së dhe ka lehtësuar bashkëpunimin operacional në fushat prioritare të krimit.

Partneriteti operacional me FRONTEX ose operacionalizimi i Njësisë së Informacionit të Pasagjerëve kanë kontribuar më tej në forcimin e menaxhimit të kufijve dhe bashkëpunimit të lidhur me migrimin në përputhje me standardet e BE-së. Megjithatë, strategjia vendos theks specifik në bashkëpunimin ndërkombëtar që synon rrjetet kriminale të organizuara të përfshira në kalimin e paligjshëm të kufirit dhe trafikimin e emigrantëve. Mekanizmat e paralajmërimit të hershëm dhe shkëmbimit të informacionit, përfshirë Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm për substancat e reja psikoaktive, demonstrojnë më tej angazhimin e Shqipërisë për t'u harmonizuar me direktivat dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.

Evoluimi i shpejtë i krimit të mundësuar nga teknologjia kibernetike thekson **domosdoshmërinë për të mbështetur kapacitetet digjitale dhe kibernetike**. Zhvillimi i kriminalistikë së avancuar digjitale, përmirësimi i gjurmimit të aseteve kripto dhe forcimi i inteligjencës kibernetike janë jetike për të mbajtur ritmin në përballje me taktikat gjithnjë e më të sofistikuara kriminale. Strategjia thekson nevojën për të forcuar përgjigjet institucionale dhe ligjore, përfshirë përmirësimin e kriminalistikës digjitale, zhvillimin e kapaciteteve të inteligjencës kibernetike dhe përditësimin e kornizave ligjore për të adresuar kërcënimet e reja. Megjithatë, efektiviteti i këtyre masave varet në masë të konsiderueshme nga forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional dhe brenda vetë institucioneve të përfshira, fusha në të cilat nevojiten ende përmirësime të mëtejshme për të rritur eficiencën e përgjigjes së Shqipërisë ndaj krimit të organizuar.

Ndërsa bashkëpunimi është veçanërisht përcaktues në adresimin e krimit të mundësuar nga teknologjia kibernetike për shkak të natyrës së tij ndërkufitare dhe teknike, **kjo sfidë shtrihet në të gjitha fushat e krimit të organizuar**, përfshirë hetimet financiare, trafikimin e drogës, korrupsionin, krimin mjedisor dhe trafikimin e emigrantëve.

Në nivel ndërinstitucional, ekzistojnë mundësi të mëtejshme për forcimin e shkëmbimit në kohë dhe në mënyrë sistematike të inteligjencës operacionale dhe strategjike ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave të koordinimit dhe i platformave të integruara do të kontribuonte në rritjen e efikasitetit të shkëmbimit elektronik të informacionit dhe në avancimin e analizave të përbashkëta ndërinstitucionale.

Në nivel institucional, ka potencial për përmirësimin e koordinimit ndërmjet strukturave operacionale, analitike dhe strategjike. Fuqizimi i flukseve të informacionit dhe promovimi i komunikimit horizontal dhe vertikal do të mbështesnin reagime më të shpejta dhe ndërhyrje më proaktive.

Më tej, konsolidimi i kulturës së bashkëpunimit, rritja e besimit institucional dhe zhvillimi i protokolleve të standardizuara për vendimmarrje të përbashkët do të krijonin kushte më të favorshme për operacione të udhëhequra nga inteligjenca dhe veprime të koordinuara ligjzbatuese.

Në këtë kuadër, është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi ndërinstitucional përmes zhvillimit të sistemeve të integruara të informacionit, përmirësimit të shkëmbimit të të dhënave, ngritjes së kapaciteteve të përbashkëta analitike dhe konsolidimit të mekanizmave të koordinimit, me qëllim rritjen e efektivitetit në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar.

Gjithashtu, vazhdimi i përpjekjeve për forcimin e sistemeve të integritetit, veçanërisht në sektorët me ekspozim më të lartë ndaj rrezikut, si menaxhimi i kufijve, licencimi dhe prokurimi publik, do të kontribuojë në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe besimit në administratën publike.

Mbi bazën e progresit të arritur, ekzistojnë mundësi të mëtejshme për forcimin e përpjekjeve në fushën e rikuperimit dhe menaxhimit të aseteve, përmes rritjes së profesionalizmit, përmirësimit të ndërveprueshmërisë ndërinstitucionale dhe konsolidimit të koordinimit operacional, me qëllim maksimizimin e efektivitetit dhe ndikimit të tyre.

Parandalimi në nivel komunitar paraqet potencial të konsiderueshëm për zhvillim të mëtejshëm. Rritja e fokusit në masat parandaluese në nivel vendor do të kontribuojë në reduktimin e faktorëve që favorizojnë përfshirjen në veprimtari kriminale dhe në forcimin e rezistencës së komuniteteve ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar.

Sektori bankar vijon të luajë një rol qendror në sistemin financiar dhe, për rrjedhojë, mbetet një nga kanalet kryesore përmes të cilit identifikohen dhe monitorohen flukset financiare të lidhura me pastrimin e parave. Ky pozicion lidhet me natyrën e veprimtarisë bankare dhe gamën e gjerë të shërbimeve të ofruara, me rolin dominues të sektorit bankar në tregun financiar, si dhe me volumin e lartë të klientëve dhe transaksioneve, përfshirë transfertat ndërkufitare. Në këtë kontekst, sektori bankar përfaqëson një partner kyç në forcimin e mekanizmave të parandalimit, zbulimit dhe raportimit të aktiviteteve të dyshimta.

Ndërsa Shqipëria ka konsoliduar më tej infrastrukturën e saj në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë (PPP/FT/FADM), duke mundësuar rritjen e kapaciteteve për zbulimin dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta, veçanërisht nga sektori bankar, ekzistojnë mundësi për zgjerimin e mëtejshëm të angazhimit të të gjithë aktorëve të përfshirë. Në veçanti, forcimi i pjesëmarrjes së profesioneve të caktuara jofinanciare, si avokatët, kontabilistët dhe audituesit ligjorë, do të kontribuonte në rritjen e efektivitetit të masave parandaluese dhe në fuqizimin e integritetit të sistemit kombëtar të parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave.

Raportet e BE-së dhe të organizmave të tjerë, si dhe Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024 - 2030, theksojnë nevojën për të kaluar drejt një qasjeje më gjithëpërfshirëse ndaj krimit financiar dhe ekonomik, të bazuar në rrezik dhe në bashkëpunimin më të fortë publik-privat, transparencën e zgjeruar të pronësisë përfituese, integrimin e përmirësuar të të dhënave dhe përdorimin sistematik të inteligjencës financiare në hetime. Adresimi i krimit financiar dhe ekonomik, për këtë arsye, kërkon një qasje të integruar që kombinon mbikëqyrjen parandaluese, inteligjencën financiare, zbatimin rregullator dhe hetimin penal, duke siguruar që flukset e paligjshme financiare të zbulohen herët dhe që themelet ekonomike të krimit të organizuar të ndërpriten efektivisht.

Në mënyrë të përmbledhur, vlerësimi i kërcënimeve tregon se mjedisi kriminal në Shqipëri shënohet nga rrjete të organizatave kriminale që përshtaten, transnacionale dhe teknologjikisht të avancuara. Arritjet e strategjisë 2021 - 2025 demonstrojnë kapacitetin e vendit për reformë dhe

harmonizim me normat ndërkombëtare, megjithatë, sfidat sistemike të vazhdueshme mbeten. Në këtë sfond strategjia prioritizon:

Forcimin e mjeteve administrative dhe rregullatore për të plotësuar zbatimin. Kjo përfshin forcimin e mekanizmave të fortë mbikëqyrës dhe kornizave rregullatore për të mbyllur boshllëqet që krimi i organizuar mund të shfrytëzojë. Duke përforcuar këto struktura, krahas zbatimit tradicional, autoritetet mund të sigurojnë një përgjigje më holistike dhe efektive ndaj aktivitetit kriminal.

Konsolidimin e ndërprerjes financiare, rikuperimin e aseteve dhe transparencën e pronarit përfitues. Çelësi për goditjen e rrjeteve kriminale është prioritizimi i hetimeve financiare, gjurmimi i unifikuar i aseteve. Kjo qasje pengon flukset e paligjshme financiare dhe fshehjen e aseteve pas strukturave komplekse të biznesit.

Përmirësimin e kapaciteteve digjitale dhe kibernetike. Zhvillimi i aftësive të avancuara kriminalistike digjitale dhe inteligjencës kibernetike është thelbësor për të luftuar kundër krimeve gjithnjë e më të sofistikuara, të mundësuara nga teknologjia kibernetike, si dhe për të mundësuar zbulim, hetim dhe përgjigje të shpejtë ndaj kërcënimeve digjitale.

Përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional, integrimit të të dhënave dhe profesionalizimit. Përmirësimi i bashkëpunimit midis agjencive dhe integrimi i sistemeve të tyre të të dhënave do të promovojë operacione më efektive të udhëhequra nga inteligjenca. Zhvillimi profesional dhe trajnimi në të gjitha institucionet janë gjithashtu thelbësore për ruajtjen e standardeve të larta dhe efektivitetit operacional.

Përforcimin e sistemeve të integritetit, veçanërisht në sektorët me rrezik të lartë. Zbatimi i kontrolleve të rrepta dhe rritja e mbikëqyrjes në fusha si menaxhimi i kufijve, dhe prokurimi ndihmon në parandalimin e korrupsionit dhe ruan besueshmërinë e institucioneve publike.

Zgjerimin e masave të parandalimit dhe rezistencës. Fokusi në nismat në nivel komunitar dhe ndërhyrjet proaktive synojnë reduktimin e rekrutimit të personave në krimin e organizuar dhe forcimin e mbrojtjeve shoqërore kundër ndikimit kriminal.

Thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe pajtueshmërisë me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Forcimi i partneriteteve ndërkufitare dhe harmonizimi me praktikat më të mira ndërkombëtare është jetësor për adresimin efektiv të krimit transnacional dhe mbështetjen e aspiratave të Shqipërisë për integrimin evropian.

Në raport progresin e Komisionit Evropian për vitin 2025, Bashkimi Evropian ka vlerësuar progresin e Shqipërisë nëpërmjet harmonizimit të kuadrit ligjor si dhe përparimit në ngritjen dhe zhvillimin e strukturave si Zyra e Rikuperimit të Aseteve (ARO), SPAK dhe BKH dhe rritjen e aksesit në bazat e të dhënave.

Gjithashtu, raporti i progresit i Komisionit Evropian për vitin 2024 konstaton se *"Shqipëria ka bërë progres në luftën kundër krimit të organizuar duke forcuar kapacitetet e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke përmirësuar përdorimin e hetimeve paralele financiare dhe duke ndryshuar kornizën ligjore për substancat psikotrope."*

Në **raportin më të fundit të Europol SOCTA për vitin 2025**, për Evropën, theksohet se krimi i organizuar sot nuk kufizohet më vetëm në botën fizike, por është gjithnjë e më i pranishëm në hapësirën digjitale dhe po përshpejtohet nga zhvillimi i inteligjencës artificiale dhe teknologjive të reja.

Ky transformim e bën krimin më "dinamik", më të shpejtë dhe më të vështirë për t'u zbuluar. Rrjetet kriminale përdorin internetin për rekrutim, komunikim, mashtrime dhe shpërndarje aktivitetesh ilegale, ndërsa teknologjitë e avancuara u mundësojnë të veprojnë në mënyrë më të sofistikuar dhe në shkallë më të gjerë.

Raporti identifikon shtatë fusha kryesore të krimit që përbëjnë kërcënimin më të madh për BE-në: sulmet kibernetike, mashtrimet *online*, shfrytëzimi seksual i fëmijëve në internet, kontrabanda e migrantëve, trafikimi i drogës, trafikimi i armëve dhe krimi i lidhur me mbetjet. Secila prej këtyre fushave po zhvillohet dhe po përshtatet me teknologjinë, duke u bërë më komplekse dhe më e rrezikshme.

Përveç kësaj, krimi i organizuar përdor një sërë taktikash të përbashkëta si pastrimi i parave përmes sistemeve digjitale, infiltrimi në biznese legale, korrupsioni dhe përdorimi i të rinjve për të kryer veprime kriminale. Këto metoda e forcojnë edhe më shumë aftësinë e rrjeteve kriminale për t'u zgjeruar dhe për t'i shpëtuar ligjit.

Në shumë vende, dhuna e lidhur me krimin e organizuar po rritet. Kjo dhunë nuk është vetëm fizike, por edhe digjitale, e koordinuar përmes komunikimeve të enkriptuara. Konkurrenca midis grupeve për kontrollin e tregjeve ilegale e përkeqëson situatën, ndërsa komunikimi *online* e bën më të shpejtë rekrutimin dhe organizimin.

Të rinjtë shpesh shfrytëzohen në këtë sistem, pasi janë më të lehtë për t'u manipuluar dhe përdoren si ekzekutues në nivelet më të ulëta, duke mbrojtur kështu udhëheqësit e vërtetë të rrjeteve kriminale.

Këto fenomene nuk njohin kufij shtetërorë. Rrjetet kriminale përshtaten me krizat globale, konfliktet dhe ndryshimet ekonomike për të gjetur mundësi të reja dhe për të ndryshuar mënyrat e tyre të veprimit.

Në këtë kontekst, institucionet evropiane, përfshirë Europol, theksojnë rëndësinë e një qasjeje të bazuar në inteligjencë. Qëllimi është të parashikohen kërcënimet dhe të kuptohet evoluimi i krimit përpara se ai të shkaktojë dëme më të mëdha.

Në përfundim, lufta kundër krimit të organizuar nuk është më vetëm reagim ndaj ngjarjeve të ndodhura, por një përpjekje e vazhdueshme për të qëndruar përpara rrjeteve kriminale që përshtaten dhe evoluojnë vazhdimisht.

1.5 KORNIZA INSTITUCIONALE NË FUQI, LIDHJA ME DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE PRIORITETET

Angazhimi i Shqipërisë për të luftuar krimin e organizuar dhe veprat penale të rënda ka evoluar në mënyrë të konsiderueshme gjatë dekadës së fundit. Korniza aktuale institucionale është produkt i reformave të vazhdueshme, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mësimeve të nxjerra nga ciklet e mëparshme strategjike.

Përgjigjja e vendit ndaj krimit të organizuar dhe veprave penale të rënda mbështetet nga një kornizë institucionale shumënivelëshe, e rrënjosur në prioritetet kombëtare dhe e harmonizuar me detyrimet ndërkombëtare. Strategjia për periudhën 2026–2030 bazohet në mësimet e nxjerra, duke kërkuar të balancojë zbatimin me parandalimin, ndërprerjen financiare dhe rezistencën institucionale dhe shoqërore. Sfidat kyçe mbeten, veçanërisht në integrimin e të dhënave, profesionalizimin dhe shpërndarjen e burimeve, por harmonizimi strategjik me MSA, OZHQ dhe qëllimet kombëtare të politikave ofron një bazë të fortë për progres të vazhdueshëm. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe zhvillimi i kapaciteteve janë në qendër të përpjekjeve të Shqipërisë, për të siguruar që vendi të jetë si i përgatitur ashtu edhe i aftë për luftën e vazhdueshme kundër krimit të organizuar.

Lidhjet me strategji të tjera sektoriale dhe dokumente vlerësimi të rrezikut

Kjo Strategji vepron brenda një ekosistemi të ndërlidhur të politikave kombëtare. Ndërfaqet kryesore përmblidhen në tabelën më poshtë dhe detajohen më tej në aktivitetet e koordinimit dhe protokollet e përcaktuara në Planin e Veprimit.

Strategjia/Programi	Ndërlidhja me këtë Strategji
Strategjia e Sigurisë Kombëtare;	Masat për mbrojtjen e viktimave të krimit forcojnë aksesin në drejtësi, mbështetjen dhe rehabilitimin e tyre, duke rritur besimin në institucionet ligjzbatuese, ndërsa masat për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda kontribuojnë në reduktimin e viktimizimit dhe garantimin e një mjedisi më të sigurt për individët dhe komunitetin.
Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës Kapitullin 24	Prioritetet kryesore në luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit, pastrimit të parave, korrupsionit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional e ndërkombëtar në fushën e sigurisë.
Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024–2030 (SNKK)	Angazhime të përbashkëta: masat antikorrupsion mbrojnë integritetin institucional që kërkohet për parandalimin dhe ndjekjen efektive të krimit të korrupsionit, ndërsa masat kundër krimit të organizuar kontribuojnë në kufizimin e ndikimeve kriminale që mund të favorizojnë korrupsionin.
Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHIE)	Shtylla 1 "Demokracia dhe forcimi i institucioneve dhe qeverisja e mirë" kornizon kontributin e sundimit të ligjit të Strategjisë.
Programi Kombëtar për Integrim Evropian 2024–2026 (PKIE)	Angazhimet e Strategjisë janë të ngulitura në produktet e PKIE-së për Kapitullin 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria".
Strategjia Ndërsektoriale për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit (2024–2030)	Objektivat Specifikë 1.5 dhe 2.3 zbatojnë komponentët e inteligjencës financiare dhe PPP/FT në koordinim me këtë strategji plotësuese.
Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH)	Koordinuar përmes QKEDH mbi rrugët e radikalizimit që ndërpriten me rekrutimin në krimin e organizuar.
Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufijve (2021–2027)	Korniza e përbashkët operacionale për kufijtë, doganat dhe kontrollet e migracionit që mbështet objektivat specifikë 2.1, 2.2 dhe 2.9.
Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2024–2030	Forcimi i bashkëpunimit në menaxhimin e migracionit, kontrollin kufitar dhe mbrojtjen e migrantëve, sigurinë e tyre fizike dhe ligjore, si dhe në parandalimin e migracionit të parregullt dhe trafikimit të qenieve njerëzore.
Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030	Mbi forcimin e mbrojtjes së viktimave, përmirësimin e aksesit në drejtësi dhe rritjen e efektivitetit të institucioneve në parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen e veprave penale, veçanërisht atyre që lidhen me krimin e organizuar.
Strategjia Kombëtare për Luftën e Trafikimit të Personave	Koordinim i drejtpërdrejtë për identifikimin, mbështetjen dhe riintegrimin e viktimave nën Objektivat Specifikë 1.3 dhe 2.2.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021–2025	Angazhime të përbashkëta për menaxhimin e çështjeve, kapacitetet e ndjekjes penale dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore.
Vlerësimi Kombëtar i Riskut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Shqipëri	Identifikimi i rreziqeve kryesore me të cilat mund të përballet vendi në kuadër të PP/FT.

Lidhja midis dokumentit strategjik dhe Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe *Acquis* të BE-së

Lufta kundër krimit të organizuar, midis Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, parashikohet në nenet 4, 82, 84 dhe 85 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër trafikimit të paligjshëm, midis Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, parashikohet në nenet 4 dhe 85 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër pastrimit të parave midis Republikës së Shqipërisë dhe BE-së parashikohet në nenet 4 dhe 82 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Për më tepër, nenet 5, 82 dhe 84 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit parashikojnë bashkëpunim midis Republikës së Shqipërisë dhe BE-së në fushën e luftës kundër terrorizmit. Nenet 83 dhe 85 të saj sigurojnë bashkëpunimin në luftën kundër drogës. Angazhimet në fushën e doganave janë ndërmarrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, siç përcaktohet në nenet 14, 15, 34, 43 dhe 97. Bashkëpunimi në fushën e çështjeve penale specifikohet në nenin 85 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Objektivat Specifikë janë të hartuara në ndërlidhje me Direktivat, Rregulloret dhe Vendimet Kornizë kryesore në tabelën më poshtë.

Instrumenti i BE-së	Lidhja me për Strategjinë
***Acquis* i BE-së, kapitulli 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria**	Korniza gjithëpërfshirëse e harmonizimit për krimin e organizuar, bashkëpunimin policor dhe gjyqësor.
Acquis e BE-së kapitulli 23 – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore	Prioritete të lidhura për pavarësinë dhe kapacitetin e prokurorisë dhe gjyqësorit, rikuperimin e aseteve dhe mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.
Vendimi Kornizë i Këshillit 2008/841/JHA për luftën kundër krimit të organizuar	Përkufizimet e ligjit penal kombëtar dhe dispozitat rënduese për pjesëmarrje në një organizatë kriminale.
Direktiva 2014/42/BE për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi	Pikë referimi e kornizës së rikuperimit të aseteve për OS 1.5 dhe OS 2.6.
Rregullorja (BE) 2018/1805 për njohjen reciproke të urdhrave të ngrirjes dhe konfiskimit	Pikë referimi e bashkëpunimit ndërkufitar për rikuperimin e aseteve për OS 3.2.
Direktiva 2011/36/BE për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore	Pikë referimi e mbrojtjes së orientuar drejt viktimë për OS 1.3 dhe 2.2.
Direktiva 2013/40/BE për sulmet ndaj sistemeve të informacionit	Pikë referimi e krimit kibernetik për OS 2.4.
Direktiva 2024/1203/BE e Parlamentit	Pikë referimi e krimit mjedisor për OS 2.8.

Evropian dhe të Këshillit, datë 11 prill 2024, "Për mbrojtjen e mjedisit përmes së drejtës penale", e cila shfuqizon Direktivën 2008/99/KE për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal.	
Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), Nenet 4, 78, 82, 83, 84, 85	Bashkëpunimi në luftën kundër trafikimit të paligjshëm, pastrimit të parave, terrorizmit, drogave dhe në çështjet penale.

Lidhja midis dokumentit strategjik dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Strategjia parashikon qëllimet dhe objektivat e formuluara në kuadër të përmbushjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 dhe Agjendës 2030, konkretisht me Objektivin 16 të Zhvillimit të Qëndrueshëm "Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet". Ky dokument lidhet specifikisht me:

Nënobjektivin 16.1: "Reduktimi i ndjeshëm i të gjitha formave të dhunës kudo dhe i normave të vdekjes të lidhura me to";

Nënobjektivin 16.2 "Dhënia fund e abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturës ndaj fëmijëve";

- Nënobjektivin 16.A "Forcimi i institucioneve përkatëse kombëtare, përfshirë përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, për ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për parandalimin e dhunës dhe luftimin e terrorizmit dhe krimit".

Tabela më poshtë skicon lidhjen dhe kontributin e Objektivave Specifikë (OS) në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

OZHQ-ja e synuar	Kontributi
OZHQ 16.1	Reduktimi i ndjeshëm i të gjitha formave të dhunës dhe normave të vdekjes të lidhura kudo – Qëllimi i Politikës II (narkotikët, trafikimi, goditja e GKO).
OZHQ 16.2	Dhënia fund e abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve - Objektivat Specifikë 1.3 dhe 2.2.
OZHQ 16.3	Promovimi i sundimit të ligjit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë – Qëllimi i Politikës II në tërësi dhe OS 2.7.
OZHQ 16.4	Reduktimi i ndjeshëm i flukseve të paligjshme financiare dhe të armëve, forcimi i rikuperimit dhe kthimit të aseteve të vjedhura dhe luftimi i të gjitha formave të krimit të organizuar - Objektivat Specifikë 1.5, 2.3, 2.6, 2.9.
OZHQ 16.5	Reduktimi substancial i korrupsionit dhe ryshfetit në të gjitha format e tyre - mbulim i përbashkët me SNKK 2024–2030.
OZHQ 16.A	Forcimi i institucioneve përkatëse kombëtare, përfshirë përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, për ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet për parandalimin e dhunës dhe luftimin e terrorizmit dhe krimit – Qëllimi i Politikës III dhe OS 1.4.
OZHQ 5.2	Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave - komponentët e përgjegjshëm ndaj gjinisë të OS 1.1, 1.2, 1.3 dhe 2.2.

Instrumentet ndërkombëtare dhe kornizat e bashkëpunimit

Përgjigjja e Shqipërisë ndaj krimit të organizuar është e ngulitur në një rrjet të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe kornizave operacionale. Instrumentet kryesore dhe platformat janë listuar më poshtë; pasojat operacionale pasqyrohen në Objektivat Specifikë 3.1 dhe 3.2 dhe në të gjithë Qëllimin Politik II.

Instrumenti/Korniza	Lidhja
Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (UNTOC) dhe Protokollet e Palermos (Trafikimi, Kontrabanda, Armët e Zjarrit)	Korniza shumëpalëshe themelore; e ratifikuar nga Shqipëria.
Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC)	E lidhur me Objektivat Specifikë 1.5, 2.3 dhe SNKK
Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi (Konventa e Varshavës, CETS 198)	Korniza për Parandalimin e Pastrimit të Parave (PPP) dhe për rikuperimin e aseteve. Vlerësimi periodik i MONEYVAL-it.
Rekomandimet e FATF dhe Vlerësimet e Ndërsjella (MER-të)	Pikë referimi e PPP/FT; cikli tjetër i MER-it i rëndësishëm për rishikimin afatmesëm (2027).
MONEYVAL (Këshilli i Evropës)	Vlerësim periodik i pajtueshmërisë së kornizës PPP/FT. Cikli pasues i planifikuar brenda periudhës së Strategjisë.
Konventat e INTERPOL-it dhe sistemi i njoftimeve	Korniza e bashkëpunimit operacional, përfshirë Njoftimet e Kuqe dhe sistemin e komunikimit I-24/7, të përdorura nga Byroja Qendrore Kombëtare.
Bashkëpunimi operacional i BE-së: Europol, Eurojust, EMPACT, ENFAST, Skuadrat e Përbashkëta Hetimore	Platformat operacionale për hetimin dhe ndjekjen ndërkufitare. Pjesëmarrja e plotë një prioritet për Qëllimin e Politikës III.
GRETA – Grupi i Ekspertëve për Veprimet kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore	Vlerësimi periodik i përgjigjes ndaj trafikimit udhëheq OS 1.3 dhe 2.2.
Bashkëpunimi dypalësh me Shtetet e Bashkuara (ICITAP, DEA, ndërlidhja e FBI) dhe me Shtetet Anëtare të BE-së	Partneritetet operacionale dhe të ngritjes së kapaciteteve nën OS 1.4 dhe Qëllimin e Politikës III.

Gatishmëria institucionale

Ministria e Punëve të Brendshme luan rol kyç në zhvillimin dhe mbikëqyrjen e politikave që trajtojnë krimin e organizuar dhe veprat penale të rënda, duke ushtruar udhëheqje strategjike mbi agjencitë e saj të varësisë. Në vitin 2025, ajo është mesatarisht e përgatitur, e pajisur me autoritetin legjislativ dhe rregullator të nevojshëm për të drejtuar përpjekjet kombëtare. Megjithatë, Ministria përballet me sfida në koordinimin ndërinstitucional dhe modernizimin e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit, me digjitalizimin e ndjekjes së politikave që mbetet pas.

Policia e Shtetit e ka përmirësuar kornizën e vet ligjore dhe ka krijuar struktura të reja si Zyra e Rikuperimit të Aseteve dhe mekanizmat e paralajmërimit të hershëm; megjithatë, këto mbeten vetëm pjesërisht funksionalë. Nevojat thelbësore përfshijnë forcimin e inteligjencës kriminale,

hetimet paralele financiare, trajtimin e provave digjitale dhe kontrollet e integritetit për postet me rrezik të lartë.

SPAK-u dhe BKH-ja përfaqësojnë kapacitetin më të avancuar të Shqipërisë, me një histori në rritje, akses të përmirësuar në bazat e të dhënave dhe hetime financiare më të forta. Në muajin mars 2026, pas një analize të thelluar institucionale, struktura organizative e BKH-së u riformatua me urdhrin e përbashkët nr. 404 prot., datë 25.3.2026, të Drejtorit të BKH-së dhe nr. 10135, datë 25.3.2026, të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, "Për miratimin e strukturës së Byrosë Kombëtare të Hetimit". Nëpërmjet këtij akti u formalizua forcimi i kapaciteteve analitike dhe operacionale përmes krijimit të Sektorit të Administrimit dhe Vlerësimit të Informacionit Kriminal dhe Njësisë Operacionale dhe Taktike. Këto njësi pritet të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e numrit të hetimeve proaktive, përpunimin më të shpejtë dhe më cilësor të informacionit policor dhe indicieve të siguruara nga burime të hapura, si dhe në rritjen e efektivitetit të metodave speciale të hetimit dhe ekzekutimit të urdhrave të Prokurorisë dhe Gjykatave të Posaçme. Gjithashtu, BKH-ja ka aktualisht akses në 23 databaza të institucioneve shtetërore, numër i cili parashikohet të rritet në mënyrë progresive deri në vitin 2030. Megjithatë, pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive, ngarkesa e tyre operacionale vazhdon të tejkalojë kapacitetet e personelit, infrastrukturën dhe mbështetjen analitike, duke e bërë të domosdoshëm konsolidimin e mëtejshëm të stafit, njësive të specializuara, mjeteve për administrimin e çështjeve të prapambetura dhe kapaciteteve të avancuara analitike për të garantuar performancë të qëndrueshme dhe efektive. Stafi i plotë i BKH-së, njësitë e specializuara, mjetet e administrimit të çështjeve të prapambetura dhe analitika e zgjeruar operacionale janë thelbësore për të mbështetur performancën.

Prokuroria e Përgjithshme demonstron angazhim proaktiv, por i mungon ekspertiza e specializuar dhe burimet e nevojshme për çështjet komplekse të krimit të organizuar dhe krimit financiar. Veçanërisht, prokuroritë e rretheve kanë nevojë për prokurorë të specializuar, mbështetje të strukturuar të analizës financiare dhe protokolle më të forta referimi me SPAK-un dhe policinë.

Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF)

Aktiviteti kryesor i AIF, në cilësinë e Njësisë së Inteligjencës Financiare, lidhet me analizimin e informacionit të raportuar përmes RAD-ve nga subjektet e ligjit, i cili plotësohet, kur është e nevojshme, me të dhëna shtesë për të mbështetur konkluzionet tona. Ky proces ka rëndësi themelore për funksionimin e institucionit, pasi mbi bazën e tij krijohen kushtet për nisjen e verifikimeve dhe investigimeve, referimin e informacionit pranë organeve kompetente, identifikimin dhe përditësimin e tipologjive të PP/FT, vlerësimin e rreziqeve, orientimin e subjekteve të ligjit për përmirësimin e sistemit parandalues, si dhe rritjen e efikasitetit në parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) ka zgjeruar kapacitetet dhe ka përmirësuar inventarët e pasurive; megjithatë, vazhdon të përballet me fragmentim, barrë mirëmbajtjeje dhe vështirësi në menaxhimin e pasurive komplekse apo digjitale. AAPSK-ja kërkon kapacitete më të forta për vlerësimin dhe disponimin e pasurive, si dhe në menaxhimin e punës, së bashku me regjistra të digjitalizuar dhe procedura më të qarta transferimi nga gjykata tek agjencia.

Administrata Doganore demonstron harmonizim goxha të mirë me standardet e BE-së dhe progres në digjitalizim, por vuan nga vakancat, boshllëqet në Teknologji të Informacionit (TI) dhe ndërlidhshmëri, si kapacitete të pamjaftueshme kundër mashtrimit dhe korrupsionit. Plotësimi i vakancave, përmirësimi i shënjestrimit bazuar në rrezik dhe modernizimi i laboratorëve dhe sistemeve TI në dogana janë prioritetet kyçe.

Administrata Tatimore ka avancuar përmes Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave por ende ka nevojë për procedura të thjeshtuara, kapacitete më të forta analitike, përdorim më të mirë të të dhënave të marra nga palët e treta.

Ministria e Drejtësisë, e cila ndonëse mesatarisht e përgatitur si lider në fushën e politikave, shfaq vështirësi në koordinimin e reformave dhe vonesa në digjitalizim, veçanërisht me sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve, afati i të cilit tashmë është shtyrë në vitin 2030. Nevojiten drejtim më i fortë, harmonizim legjislativ dhe kapacitete monitoruese.

Zyra e Rikuperimit të Aseteve, e krijuar rishtas, mbetet në fazat e hershme të funksionalitetit. Kuadri ligjor, personeli, aksesi në bazat e të dhënave dhe rendi operacional i punës duhet të prioritizohen për të siguruar bashkëpunim efektiv me SPAK-un, AIF-në dhe AAPSK-un.

Organe si **Agjencia e Mbikëqyrjes Policore** dhe **Inspektorati Shtetëror i Mjedisit** tregojnë gatishmëri në nivel bazë. E para kërkon mbikëqyrje më të fortë antikorrupsion, testim integriteti dhe mbrojtje të sinjalizuesve, ndërsa e dyta ka nevojë për ngritje urgjente kapacitetesh për zbulimin dhe hetimin e krimit mjedisor.

Në përgjithësi, korniza institucionale e Shqipërisë demonstron **gatishmëri në rritje, por të pamjaftueshme për të trajtuar efektivisht krimin e organizuar**. Strategjia do të fokusohet në këto fusha:

- zgjerimin e burimeve njerëzore të specializuara;
- forcimin e kapaciteteve për krimin financiar dhe provat digjitale;
- përmirësimin e ndërveprueshmërisë dhe sistemeve të të dhënave;
- konsolidimin e funksioneve të rikuperimit dhe menaxhimit të aseteve;
- përforcimin e mekanizmave të integritetit dhe mbikëqyrjes;

Këto përmirësime synojnë të ndërtojnë një sistem kombëtar koherent, të qëndrueshëm, të aftë për të ndërprerë rrjetet komplekse të krimit të organizuar dhe për të përmbushur pritshmëritë e integrimit në BE.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ushtron një rol kyç në hartimin, koordinimin dhe monitorimin e politikave kombëtare në fushën e drogave, duke adresuar dimensionin shëndetësor, social dhe parandalues të fenomenit. Ajo siguron udhëheqje strategjike në zhvillimin e ndërhyrjeve të bazuara në evidenca, përfshirë parandalimin e përdorimit, trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e individëve, si dhe kontribuon në forcimin e rezistencës së komuniteteve, veçanërisht për grupet në risk. Nëpërmjet strukturave të saj, përfshirë Observatorin Kombëtar të Drogave, Ministria garanton mbledhjen, analizën dhe raportimin sistematik të të dhënave, duke mbështetur procesin e vendimmarrjes dhe përafrimin me standardet e BE-së. Në këtë kuadër, ajo luan një rol të rëndësishëm në koordinimin ndërinstitucional me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Shtetit dhe aktorë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, në funksion të një qasjeje të integruar dhe gjithëpërfshirëse ndaj politikave të drogës.

Që nga viti 2025, Shqipëria ka një **arkitekturë funksionale për luftën kundër krimit të organizuar,** ku rolin kryesor e mbajnë Prokuroria e Posaçme (SPAK), Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) dhe Policia e Shtetit, si institucionet më të specializuara dhe me kapacitetet kryesore operacionale. Institucionet e tjera kontribuojnë në mënyrë mbështetëse, veçanërisht në aspektin e inteligjencës financiare, kontrollit kufitar, administrimit fiskal dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Për këtë arsye, Strategjia do të kombinojë prioritetet operacionale me një fokus të dedikuar për forcimin e kapacitetit institucional të fokusuar në analizë, rikuperim asetesh, digjitalizim, koordinim ndërinstitucional dhe garanci integriteti. Në mënyrë të posaçme për Byronë Kombëtare të Hetimit, një objektiv strategjik i rëndësishëm duhet të jetë forcimi gradual i pavarësisë së saj operacionale nga agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, përmes zhvillimit të

kapaciteteve të veta analitike, operacionale, teknologjike dhe logjistike. Kjo do të mundësojë kryerjen më efektive të hetimeve proaktive, përdorimin e pavarur të metodave speciale të hetimit, administrimin e informacionit kriminal dhe ekzekutimin e veprimeve hetimore në përputhje me mandatin ligjor të BKH-së, duke rritur efikasitetin, sigurinë operative dhe qëndrueshmërinë institucionale të saj.

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe integrimi i të dhënave

Bashkëpunimi dhe koordinimi efektiv ndërinstitucional janë themelorë për suksesin e përgjigjes së efektshme ndaj veprave të rënda dhe të krimit të organizuar nga strategjia. Kompleksiteti, shkalla dhe natyra transnacionale e këtyre kërcënimeve kërkojnë një qasje mbarështetërore, ku zbatimi i ligjit, hetimet dhe ndjekja penale, inteligjenca financiare dhe autoritetet rregullatore veprojnë si një sistem i integruar dhe jo si veprimtari të ndara nga njëra tjetra.

Mekanizmat e koordinimi periodik janë të ngritura në institucionet kyçe, përfshirë Policinë e Shtetit, Agjencinë e Inteligjencës Financiare, Prokurorinë e Përgjithshme dhe SPAK-un. Këto mekanizma përfshijnë shkëmbimin e informacionit, mbledhjet e përbashkëta operacionale, grupet e punës ndërinstitucionale dhe hetimet e koordinuara për të adresuar çështjet komplekse. Bashkëpunime dhe ndërveprime të tilla kanë kontribuar në harmonizim të përmirësuar operacional dhe rritje të përdorimit të qasjeve të përbashkëta hetimore. Megjithatë, pavarësisht këtyre përmirësimeve, mbetet e nevojshme forcimi i mëtejshëm i koordinimit operacional dhe konsolidimi i praktikave të bashkëpunimit ndërinstitucional, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe standardizimit të qasjeve të përbashkëta hetimore.

Në nivelin brenda-institucional, koordinimi ndërmjet strukturave të ndryshme funksionale, përfshirë njësitë operacionale, analitike, të hetimit financiar dhe kibernetik, është përmirësuar, megjithatë mbetet e rëndësishme forcimi i mëtejshëm i integrimit të informacionit dhe koordinimit operacional. Në disa raste, nevojitet harmonizim më i madh i proceseve të brendshme për të mundësuar përdorim sa më efektiv të informacionit, analizës dhe provave të disponueshme në funksion të hetimeve komplekse.

Këto sfida lidhen ngushtë me disa dobësi ende ekzistuese në integrimin e të dhënave dhe ndërveprueshmërinë, por në të njëjtën kohë ato po shërbejnë edhe si shtysë për përmirësime të rëndësishme në mënyrën se si institucionet bashkëpunojnë. Aftësia për të kombinuar, analizuar dhe ndarë informacionin ndërmjet institucioneve dhe sistemeve të ndryshme mbetet një fushë që po zhvillohet gradualisht, me hapa të vazhdueshëm drejt modernizimit dhe harmonizimit të proceseve.

Shpesh, informacioni ende ruhet në sisteme të ndara, gjë që mund të kufizojë shkëmbimin e menjëhershëm të të dhënave dhe analizën e plotë të situatave. Megjithatë, kjo ka nxitur një fokus më të madh në ndërtimin e platformave të përbashkëta dhe në rritjen e standardeve të ndërveprimit, duke e bërë bashkëpunimin ndërinstitucional një prioritet gjithnjë e më të rëndësishëm.

Si rezultat, edhe pse inteligjenca mund të ketë qenë më e fragmentuar në të kaluarën, ka një tendencë të dukshme drejt integrimit më të mirë të burimeve të informacionit. Kjo përmirëson gradualisht kapacitetet analitike, ul dyfishimin e përpjekjeve dhe rrit shpejtësinë e reagimit ndaj fenomeneve kriminale

Në këtë kuadër, këto janë edhe mundësi për transformim: forcimi i lidhjeve ndërmjet sistemeve, rritja e ndërveprimit dhe përdorimi më efektiv i të dhënave po krijojnë bazat për një qasje më të koordinuar dhe më proaktive në përballimin e krimit të organizuar. Për të adresuar këto boshllëqe strukturore, strategjia prioritizon zhvillimin e një mjedisi informacioni plotësisht të integruar dhe ndërveprues, të mbështetur nga:

- Nevoja për harmonizimin dhe formalizimin e mëtejshëm të praktikave ekzistuese të shkëmbimit të informacionit ndërmjet dhe brenda institucioneve, duke përcaktuar role, përgjegjësi dhe procedura të qarta për ndarjen e të dhënave

- Zhvillimi i sistemeve TI të ndërvepruara dhe platformave të sigurta digjitale, që mundësojnë akses në kohë reale, kryqëzim referencash dhe analizë të dhënash nëpër institucione;

- Forcimi i strukturave të përbashkëta analitike dhe operacionale, që inteligjenca, hetimet financiare dhe kapacitetet kibernetike të jenë sistematikisht të integruara;

- Promovimi i një kulture të bashkëpunimit dhe koordinimit të strukturuar, mbështetur me trajnime, operacione të përbashkëta dhe mekanizma monitorimi të performancës;

Sigurimi i pajtueshmërisë së plotë me standardet e mbrojtjes së të dhënave, privatësisë dhe

- sigurisë kibernetike, në përputhje me *Acquis* të BE-së;

Duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe atë brenda institucioneve, krahas integrimit të përmirësuar të të dhënave, strategjia do të forcojë më tej zbatimin efektiv të hetimeve të udhëhequra nga inteligjenca. Kjo mbështet prioritetet kyçe strategjike të kësaj strategjie, përfshirë konsolidimin e hetimeve paralele financiare, identifikimin dhe parandalimin e hershëm të aktivitetit të krimit të organizuar dhe zbulimin proaktiv të krimit të mundësuar nga teknologjia kibernetike.

PJESA II
QËLLIMET POLITIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË DOKUMENTIT STRATEGJIK

Strategjia mbështetet në tri qëllime politike kryesore, të cilat përbëjnë arkitekturën operacionale të përgjigjes së Shqipërisë ndaj krimit të organizuar dhe krimeve të rënda për periudhën 2026–2030. Çdo Qëllim i Politikës adreson një dimension të veçantë të përgjigjes kombëtare (parandalimin, ndjekjen penale dhe bashkëpunimin ndërkombëtar) dhe mbështetet nga një grup Objektivash Specifikë që përkthejnë prioritetet strategjike në angazhime konkrete të matshme.

Qëllimi i Politikës I – Parandalimi i krimit të organizuar dhe krimeve penale të rënda

Forcimi i mekanizmave ligjorë, institucionalë dhe komunitarë që kufizojnë kushtet në të cilat grupet e organizuara kriminale rekrutojnë, veprojnë dhe infiltrojnë në ekonominë e ligjshme, me theks të veçantë te ndërgjegjësimi, reduktimi i cenueshmërisë, mbrojtja e dëshmitarëve dhe viktimave, kapacitetet profesionale, ndërprerja financiare dhe parandalimi administrativ.

Qëllimi i Politikës II – Ndjekja penale dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda

Rritja e performancës së strukturave përgjegjëse për zbulimin, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e krimit të organizuar (narkotikët, trafikimin e paligjshëm, krimin ekonomik dhe financiar, krimin kibernetik, krimin mjedisor, kapjen e të arratisurve) dhe për gjurmimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe ripërdorimin e të ardhurave kriminale.

Qëllimi i Politik III – Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar

Forcimi i bashkëpunimit policor dhe gjyqësor ndërmjet institucioneve dhe përtej kufijve, me pjesëmarrje të plotë dhe në kohën e duhur në kornizat e bashkëpunimit të BE-së dhe ndërkombëtare (Europol, Eurojust, EMPACT, INTERPOL, instrumente dypalëshe dhe shumëpalëshe), në mënyrë që dimensioni ndërkufitar i krimit të organizuar të përputhet me një përgjigje ekuivalente ndërkufitare.

Tri Qëllimet e Politikave janë reciprokisht përforcuese: parandalimi krijon kushtet shoqërore që e bëjnë ndjekjen penale më efektive; ndjekja penale gjeneron inteligjencë financiare që ushqen përsëri parandalimin; dhe bashkëpunimi shumëfishon fushëveprimin e të dyja Qëllimeve të

Politikave të tjera. Të tria së bashku, ato përbëjnë një përgjigje gjithëpërfshirëse, të bazuar në të dhëna dhe të harmonizuar me BE-në ndaj kërcënimeve të identifikuara në Pjesën I.

2.1 QËLLIMI I POLITIKËS I: PARANDALIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA

Parandalimi i krimit të organizuar dhe veprave penale të rënda përbën një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Brendshme. Kjo strategji thekson parandalimin si mekanizmin më efektiv dhe afatgjatë për rritjen e sigurisë publike, forcimin e sundimit të ligjit dhe reduktimin e ndikimit të faktorëve që gjenerojnë kriminalitetin. Në këtë kontekst, Shqipëria synon të harmonizohet plotësisht me qasjen e BE-së, e cila në strategjitë e saj nxjerr në pah parandalimin e krimit të organizuar përmes analizës së rrezikut, trajtimit të ekonomisë kriminale, forcimit të integritetit institucional, ndërtimit të kapaciteteve hetimore dhe, në veçanti, përfshirjes së faktorëve socialë, ekonomikë dhe gjinorë që ndikojnë në shfaqjen dhe përhapjen e këtij fenomeni.

Në përputhje me këtë qasje evropiane, kjo strategjia synon përmirësimin dhe harmonizimin e kornizës ligjore me *Acquis* të BE-së, forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknologjike të institucioneve të zbatimit të ligjit, si dhe vendosjen e mekanizmave të qëndrueshëm parandalimi përmes politikave të bazuara në të dhëna. Strategjia bazohet në vizionin për të mbrojtur qytetarët dhe zhvillimin e vendit nga kërcënimet e brendshme dhe të jashtme, duke u fokusuar në reduktimin e rreziqeve që krijojnë terren për aktivitetet kriminale dhe në rritjen e fuqisë parandaluese të shtetit.

Ky dokument synon të shërbejë si udhëzues gjithëpërfshirës për parandalimin dhe luftimin e aktiviteteve të paligjshme përmes koordinimit efektiv midis qeverisë, sektorit privat, komunitetit dhe vetë qytetarëve. Në përputhje me praktikat e BE-së, ku parandalimi mbështetet nga qasjet e integruara komunitare, programet e parandalimit social, lufta kundër korrupsionit dhe transparenca publike, strategjia synon të ndërtojë një mjedis ku fenomenet kriminale identifikohen dhe neutralizohen në fazat e tyre të hershme.

SKKOKR parashikon edhe forcimin e kapaciteteve aktuale dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja në fusha kritike si analiza kriminale, inteligjenca financiare dhe përdorimi i teknologjive moderne për monitorimin e aktiviteteve kriminale. Duke forcuar aftësinë e institucioneve për të mbledhur, analizuar dhe vlerësuar të dhënat, rritet kapaciteti parashikues dhe aftësia për të ndërhyrë në kohë, në përputhje me praktikat e BE-së që e konsiderojnë analizën proaktive të rrezikut si themelin e politikave të suksesshme parandaluese. Gjurmimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale, si një nga prioritetet qendrore të BE-së në parandalimin e ekonomisë së krimit, zë gjithashtu një vend të rëndësishëm në këtë strategji, duke synuar dobësimin strukturor të grupeve kriminale që nga faza e burimeve financiare.

Në këtë mënyrë, strategjia synon jo vetëm të ndëshkojë pas faktit, por të parandalojë në mënyrë inteligjente dhe të qëndrueshme krimin e organizuar, duke materializuar plotësisht parimet, standardet dhe praktikat e përdorura nga BE-ja në këtë fushë.

Prioritetet, objektivat dhe masat konkrete të parashikuara në këtë strategji janë organizuar dhe synojnë të adresojnë tri çështje kyçe në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda: **1. Parandalimi; 2. Ndërprerja përmes ndjekjes penale; 3. Bashkëpunimi Kombëtar dhe Ndërkombëtar.**

Për qëllimin e parandalimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, është e nevojshme të ndërmerren masa të koordinuara dhe efektive që adresojnë faktorët që favorizojnë zhvillimin e aktiviteteve kriminale, përfshirë forcimin e kapaciteteve të institucioneve ligjzbatuese, si dhe bashkëpunimin e ngushtë midis aktorëve të ndryshëm në nivel ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

Objektivi Specifik 1.1: Rritja e qëndrueshmërisë publike dhe institucionale ndaj krimit të organizuar përmes përmirësimit të ndërgjegjësimit, njohurive dhe angazhimit proaktiv

Forcimi i rezistencës publike dhe institucionale ndaj krimit të organizuar fillon me një shoqëri të informuar mirë, të aftë për të njohur rreziqet, për t'i rezistuar ndikimit kriminal dhe për të mbështetur aktivisht përpjekjet e parandalimit. Shqipëria vazhdon të përballet me forma në zhvillim të krimit të organizuar që shfrytëzojnë cenueshmëritë sociale, presione ekonomike dhe boshllëqe në ndërgjegjësimin publik. Për këtë arsye, përmirësimi i njohurive, qëndrimeve dhe angazhimit të qytetarëve, të rinjve, profesionistëve dhe institucioneve, është thelbësor për ndërtimin e rezistencës afatgjatë ndaj infiltrimit dhe manipulimit kriminal. Parandalimi është më efektiv kur qytetarët fuqizohen me informacion të saktë, me aftësinë e të menduarit kritik dhe me rrugë të aksesueshme për bashkëpunim me institucionet.

Ky Objektiv Specifik fokusohet në zgjerimin dhe thellimin e përpjekjeve për ndërgjegjësim në të gjithë vendin, për të garantuar që informacioni mbi rreziqet, pasojat dhe mekanizmat e parandalimit të krimit të organizuar të arrijë audienca të ndryshme, në mënyra që janë të rëndësishme për realitetet e tyre të përditshme. Fushata të përshtatura, aktivitete edukative dhe përmbajtja multimediale do të ndihmojnë në demistifikimin e krimit të organizuar, kundërshtimin e narrativave të dëmshme dhe promovimin e modeleve pozitive, veçanërisht midis të rinjve dhe grupeve të cenueshme. Integrimi i mesazheve të përgjegjshme dhe të ndjeshme ndaj gjinisë do të garantojnë që përpjekjet e parandalimit të adresojnë rreziqet e diferencuara me të cilat përballen gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, dhe që të gjitha grupet të jenë të pajisura me njohuritë e nevojshme për të qëndruar të sigurt dhe të qëndrueshëm.

Arritja kuptimplotë dhe e qëndrueshëm të parandalimit kërkon bashkëpunim të fortë midis institucioneve, akademikëve, shoqërisë civile dhe komuniteteve vendore. Duke mobilizuar këta aktorë dhe duke ushqyer një kulturë të përgjegjësisë së përbashkët, Shqipëria mund të forcojë kapacitetin e saj kolektiv për të parandaluar krimin e organizuar dhe për të reduktuar ndikimin e tij në shoqëri. Ministria e Punëve të Brendshme do të luajë rol qendror në koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të këtyre masave, duke siguruar që nismat e ndërgjegjësimit të jenë të bazuara në të dhëna, gjithëpërfshirëse dhe të harmonizuara me prioritetet kombëtare. Përmes kësaj qasjeje gjithëpërfshirëse, Strategjia synon të kultivojë një shoqëri të informuar, vigjilente dhe aktivisht të angazhuar në mbrojtjen e vlerave demokratike dhe mirëqenies së komunitetit.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Rritja e njohurive për rreziqet e krimit të organizuar midis grupeve të synuara.

Rezultati 2: Përmirësim i matshëm në qëndrimet publike ndaj denoncimit të aktivitetit kriminal.

Rezultati 3: Forcim i angazhimit të shoqërisë civile dhe akademikëve në politikën e parandalimit të krimit.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme:

Masa 1.1.1: Përgatitja dhe zbatimi i fushatave të ndërgjegjësimit në nivel kombëtar, të përshtatura sipas nevojave vendore dhe nevojave dhe grupeve të synuara, përfshirë institucionet e arsimit (parauniversitar), duke u fokusuar te rreziqet, pasojat dhe parandalimi i përfshirjes në aktivitete kriminale, përfshirë përmbajtjen e përgjegjshme ndaj gjinisë, të bazuar në evidencë dhe në analizë gjinore.

Masa 1.1.2: Organizimi i leksioneve dhe seminareve të hapura në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë në lidhje me rastet, tendencat dhe format e shfaqjes së krimit të organizuar, me qëllim informimin dhe angazhimin në proceset e konsultimit të politikave në këtë fushë.

Masa 1.1.3: Prodhimi dhe shpërndarja e përmbajtjeve multimediale ndërgjegjësuese mbi rreziqet dhe pasojat e krimit të organizuar, si dhe promovimi i modeleve pozitive të përshtatur për rininë dhe grupet e cenueshme, përfshirë mesazhe të ndjeshme ndaj gjinisë.

Masa 1.1.4: Botimi i praktikave më të mira, manualeve dhe studimeve të përbashkëta mbi krimin financiar, korrupsionin dhe efektet e tyre negative në shoqëri.

Masa 1.1.5: Forcimi i kapaciteteve të personelit të specializuar përgjegjës në luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore, përmes trajnimit dhe shkëmbimit të njohurive.

Për të mbështetur arritjen e këtyre Masave, do të zbatohen Aktivitetet e mëposhtme (afati kohor dhe kostoja e aktiviteteve detajohen në Planin e Veprimit).

Aktivitete për masën 1.1.1

- Organizimi i fushatave të shënjestruara ndërgjegjësimi në nivel qendror dhe vendor, të përshtatura për audienca specifike, përfshirë institucionet parauniversitare, duke përdorur mesazhe të përshtatura sipas vendit mbi rreziqet, pasojat dhe parandalimin e krimit të organizuar.
- Realizimi i sesioneve të strukturuara informimi me mësues, prindër, grupe rinore dhe aktorë të komunitetit, për të përforcuar mesazhet e parandalimit dhe për të promovuar kanale të sigurta dhe të aksesueshme për raportimin dhe bashkëpunimin me institucionet.

Aktivitete për masën 1.1.2

- Organizimi i leksioneve dhe seminareve të hapura në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë mbi rastet, tendencat dhe format e krimit të organizuar, duke inkurajuar dialogun e informuar dhe pjesëmarrjen e studentëve në proceset e konsultimit të politikave.
- Angazhimi i personelit akademik, studiuesve dhe organizatave të studentëve në diskutime tematike, tryeza të rrumbullakëta dhe debate për të forcuar kontributet e bazuara në të dhëna në hartimin e politikave të parandalimit të krimit.

Aktivitete për masën 1.1.3

- Prodhimi dhe shpërndarja e materialeve multimediale ndërgjegjësuese, përfshirë video, animacione dhe përmbajtje në mediat sociale, të zhvilluara në konsultim me të rinjtë dhe grupet e tjera të synuara, duke nxjerrë në pah rreziqet dhe pasojat e krimit të organizuar dhe duke promovuar modele pozitive për të rinjtë dhe grupet e cenueshme.
- Integrimi në të gjitha produktet multimediale i mesazhe të përshtatura ndaj gjinisë, të bazuara në të dhëna të disagreguara sipas gjinisë dhe të hartuara në mënyrë që të shmangin përforcimin e stereotipave, paragjykimeve dhe supozimeve të dëmshme lidhur me viktimat dhe autorët e krimit të organizuar, dhe shpërndarja përmes platformave të përdorura zakonisht nga të rinjtë, komunitetet vendore dhe grupet e cenueshme.

Aktivitete për masën 1.1.4

- Botimi i praktikave më të mira, manualeve dhe studimeve të përbashkëta mbi krimin financiar, korrupsionin dhe ndikimin e krimit të organizuar në shoqëri, në bashkëpunim me institucionet akademike dhe shoqërinë civile.
- Shpërndarja e këtyre botimeve në shkolla, bashki, institucione publike dhe organizata komunitare dhe integrimi i botimeve në aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe trajnimit.

Aktivitete për masën 1.1.5

- Realizimi i programeve të specializuara të trajnimit për personelin përgjegjës për luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore, duke u fokusuar në parandalimin, zbulimin dhe koordinimin ndërinstitucional.

Lehtësimi i seminareve për shkëmbimin e njohurive me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë për të forcuar aftësitë profesionale dhe për të

- promovuar miratimin e praktikave moderne hetimore dhe parandaluese.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Numri i fushatave të ndërgjegjësimit të kryera çdo vit në nivel qendror dhe lokal.

Produkti 2: Numri i seminareve/leksioneve të mbajtura në institucionet e arsimit të lartë.

Produkti 3: Numri i materialeve multimediale të prodhuara dhe të shpërndara.

Produkti 4: Numri i botimeve (manualeve, studimeve, udhëzuesve) të përgatitura dhe të qarkulluara.

Institucionet përgjegjëse: Policia e Shtetit/Akademia e Sigurisë; Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit/Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

Institucionet mbështetëse: Ministria e Arsimit/Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar; IAL; Prefekti i Qarkut.

Mbështetës të tjerë: EU4LEA; EUDA; OJF.

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Përqindja e grupeve të synuara të anketuara (për shembull: të rinj dhe banorë të lagjeve të identifikuara me rrezik të lartë) që raportojnë njohuri të përmirësuara mbi rreziqet e krimit të organizuar.

Vlera bazë: Vendoset në vitin 2027 përmes një anketimi të familjeve përfaqësues në nivel kombëtar të kryer me INSTAT-in.

Synimi deri në 2030: +30% përmirësim kundrejt vlerës bazë deri në vitin 2030.

Objektivi Specifik 1.2: Reduktimi i cenueshmërisë së komuniteteve me rrezik duke përmirësuar aksesin në mekanizmat e mbështetjes sociale, ekonomike dhe të riintegrimit

Zvogëlimi i cenueshmërisë së komuniteteve me rrezik është një shtyllë qendrore e qasjes parandaluese të strategjisë, duke pranuar se përjashtimi social, vështirësitë ekonomike dhe aksesi i kufizuar në shërbimet thelbësore krijojnë terren pjellor për shfrytëzimin kriminal. Ky Objektiv Specifik fokusohet në forcimin e mekanizmave socialë, ekonomikë dhe të riintegrimit, që u mundësojnë individëve dhe komuniteteve të ndërtojnë rezistencë, të reduktojnë varësinë nga strukturat e paligjshme dhe të kenë akses në mundësi zhvillimi të ligjshme. Duke adresuar shkaqet rrënjësore që i bëjnë komunitetet të ndjeshëm ndaj krimit të organizuar, Strategjia synon të krijojë mjedise vendore më të sigurta, më të lidhura dhe më të fuqizuara.

Arritja e këtij objektivi kërkon një qasje të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse që bashkon institucionet shtetërore, qeverisjen vendore, shoqërinë civile, akademikët dhe partnerët ndërkombëtarë. Përmes vlerësimeve të synuara, shërbimeve sociale të përmirësuara, programeve të zgjeruara të riintegrimit dhe ripërdorimit strategjik të aseteve të konfiskuara në dobi të komuniteteve, Strategjia kërkon të rrisë cilësinë e jetës në zonat e cenueshme dhe të ofrojë alternativa të prekshme përkundër përfshirjes kriminale. Të dhënat e ndara sipas gjinisë dhe programimi i përgjegjshëm ndaj gjinisë garantojnë që ndërhyrjet të pasqyrojnë rreziqet dhe nevojat e diferencuara të grave, burrave, vajzave dhe djemve, veçanërisht në komunitetet ku grupet kriminale shfrytëzojnë cenueshmëritë gjinore.

Paralelisht, Strategjia promovon nisma për forcimin e rezistencës bazuar në komunitet, materiale të përshtatura parandaluese dhe kërkim të bazuar në të dhëna, për të kuptuar më mirë faktorët shtytës të krimit të dhunshëm dhe dëmin social. Forcimi i mbështetjes psikosociale në burgje, zgjerimi i trajnimit profesional dhe përmirësimi i rrugëve të riintegrimit, kontribuojnë më tej në reduktimin e recidivizmit dhe mbështetjen e stabilitetit afatgjatë social. Duke mobilizuar të gjithë aktorët përkatës dhe duke siguruar bashkëpunim të qëndrueshëm ndërmjet sektorëve, Shqipëria do të jetë e pozicionuar më mirë për të reduktuar cenueshmërinë komunitare, për të parandaluar rekrutimin kriminal dhe për të promovuar zhvillim gjithëpërfshirës. Ministria e

Punëve të Brendshme do të mbikëqyrë monitorimin e këtyre masave për të siguruar efektivitetin dhe harmonizimin e tyre me prioritetet kombëtare të parandalimit.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Reduktimi në pikat e nxehta të identifikuara të rekrutimit të krimit të organizuar në zonat e synuara.

Rezultati 2: Ulja e normës së recidivizmit ndër pjesëmarrësit në program.

Rezultati 3: Forcimi i rezistencës së komuniteteve dhe reduktimi i kushteve shoqërore që mundësojnë krimin e organizuar.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes Masave të mëposhtme:

Masa 1.2.1: Identifikimi dhe analizimi i zonave gjeografike, komuniteteve dhe grupeve sociale që janë të prekura dhe të cenueshme nga strukturat e paligjshme dhe aktivitetet kriminale, duke përdorur të dhëna të ndara sipas gjinisë.

Masa 1.2.2: Inkurajimi dhe nxitja e transferimit të pronave/aseteve të konfiskuara në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, në mënyrë që të përdoren për qëllime sociale dhe në dobi të komuniteteve.

Masa 1.2.3: Planifikimi dhe organizimi takimeve ndërgjegjësuese mbi procedurat për transferimin e aseteve të konfiskuara të aktivitetit kriminal, tek institucionet qendrore dhe vendore, me qëllim lehtësimin e ripërdorimit social të tyre.

Masa 1.2.4: Përmirësimi i trajtimit të të burgosurve për sa u përket aspekteve psikosociale dhe kulturore, si dhe i kushteve të strukturave dhe infrastrukturës së burgjeve, përfshirë përmes hartimit dhe zbatimit të programeve sociale dhe trajnimeve ose kurseve profesionale.

Masa 1.2.5: Hartimi i analizave dhe studimeve në bashkëpunim ndërmjet Akademisë së Sigurisë, specialistëve të fushës, psikologëve dhe shoqërisë civile, për të analizuar arsyet, shkaqet dhe faktorët kontribuues që çojnë në vrasje, si edhe prezantimi i opinioneve dhe alternative për trajtimin e problematikave përkatëse, si edhe luftimi i shkaqeve rrënjësore që çojnë në vrasje.

Masa 1.2.6: Përgatitja dhe zbatimi i programeve të rezistencës komunitare në të paktën 5 zona gjeografike me rrezik të lartë të identifikuara nga të dhënat e autoriteteve ligjzbatuese, që përfshijnë module të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe që adresojnë rreziqet e diferencuara.

Masa 1.2.7: Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve parandaluese me ndjeshmëri gjinore dhe programeve të riintegrimit që ofrojnë mbështetje të përshtatur për gratë, burrat dhe të rinjtë.

Për të mbështetur arritjen e këtyre Masave, do të zbatohen Aktivitetet e mëposhtme (afati kohor dhe kostoja e aktiviteteve detajohen në Planin e Veprimit).

Aktivitete për masën 1.2.1

- Kryerja vlerësimeve të strukturuara të cenueshmërisë në zonat gjeografike me rrezik të lartë, duke përdorur të dhëna të ndara sipas gjinisë, tregues socio-ekonomikë dhe inteligjencë të ligjzbatimit, me qëllim identifikimin e komuniteteve më të ekspozuara ndaj infiltrimit kriminal.
- Përgatitja e raporteve analitike që hartëzojnë faktorët e rrezikut, nevojat e komunitetit dhe cenueshmëritë gjinore specifike, si dhe ndarja e tyre me qeverisjen vendore dhe ofruesit e shërbimeve sociale, për të orientuar ndërhyrjet e synuara.

Aktivitete për masën 1.2.2

- Lehtësimi i koordinimit midis institucioneve qendrore, AAPSK-së dhe njësive të qeverisjes vendore për të përshpejtuar transferimin e pronave të konfiskuara për projekte në dobi të komunitetit.
- Ofrimi i udhëzimeve teknike NjVV-ve për përgatitjen e propozimeve, vlerësimeve të fizibilitetit dhe planeve të ripërdorimit social, që të sigurohet përdorim i qëndrueshëm dhe transparent i aseteve të konfiskuara.

Aktivitete për masën 1.2.3

- Organizimi i takimeve dhe seminareve ndërgjegjësuese me institucionet qendrore dhe vendore për të sqaruar procedurat ligjore, përgjegjësitë dhe afatet kohore për transferimin e aseteve të konfiskuara.
- Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve udhëzuese, praktike për përdoruesin, që shpjegojnë hapat, dokumentacionin dhe kriteret e nevojshme për ripërdorimin social të pronave të konfiskuara.

Aktivitete për masën 1.2.4

- Zhvillimi dhe zbatimi i programeve psikosociale, kulturore dhe profesionale në burgje, që mbështetin rehabilitimin, reduktojnë recidivizmin dhe forcojnë perspektivat e riintegrimit.
- Përmirësimi i strukturave dhe infrastrukturës së burgjeve për të siguruar kushte humane dhe për të mundësuar ofrimin e trajnimeve të strukturuara, këshillimit dhe shërbimeve të riintegrimit.

Aktivitete për masën 1.2.5

- Kryerja e studimeve ndërdisiplinore, së bashku me Akademinë e Sigurisë, psikologët, kriminologët dhe shoqërinë civile, për të analizuar shkaqet rrënjësore, modelet e sjelljes dhe faktorët shtytës socio-ekonomikë që çojnë në vrasje.
- Formulimi i rekomandimeve politike dhe opsioneve praktike për parandalimin, ndërhyrjen e hershme dhe përgjigjen në nivel komunitar, për të reduktuar krimin e dhunshëm.

Aktivitete për masën 1.2.6

- Hartimi dhe zbatimi i programeve të rezistencës komunitare në të paktën pesë zona me rrezik të lartë, duke përfshirë module të përgjegjshme ndaj gjinisë që adresojnë rreziqet e diferencuara me të cilat përballen gratë, burrat, vajzat dhe djemtë.
- Mobilizimi i aktorëve vendorë, shkollat, bashkitë, OShC-të, grupet rinore, për të ofruar aktivitete parandaluese, nisma mentorimi dhe ndërhyrje për forcimin e komuniteteve, të përshtatura sipas cenueshmërive vendore.

Aktivitete për masën 1.2.7

- Përgatitja e materialeve parandaluese të ndjeshme ndaj gjinisë dhe mjete riintegrimi të përshtatura me nevojat e grave, burrave dhe të rinjve, duke adresuar cenueshmëritë specifike që shfrytëzojnë grupet kriminale.
- Ofrimi i mbështetjes me synim riintegrimin, si këshillim, udhëzim profesional dhe rrugë referimi, për individët me rrezik, duke siguruar që shërbimet të pasqyrojnë nevojat dhe pengesat gjinore specifike.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Numri i raporteve të hartimit të cenueshmërisë të prodhuara dhe të përditësuara.

Produkti 2: Numri i të burgosurve të regjistruar në programe rehabilitimi dhe profesionale.

Produkti 3: Numri i programeve të qëndrueshmërisë komunitare të zbatuara në zonat me rrezik të lartë.

Produkti 4: Numri i materialeve të ndjeshme ndaj gjinisë të prodhuara dhe të shpërndara.

Institucionet përgjegjëse: Policia e Shtetit, Agjencia e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Ministria e Punëve të Brendshme.

Institucionet mbështetëse: Bashkitë, Prefekti i Qarkut, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministritë përkatëse të linjës;.

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Ulja e normës së rasteve të regjistruara të krimit të rëndë dhe të organizuar për 10,000 banorë në njësitë e vetëqeverisjes vendore (NjVV) të identifikuara si me rrezik të lartë.

Vlera bazë: 2025 – 40 raste për 10,000 banorë.

Synimi deri më 2030: -15% krahasuar me vlerësimin bazë deri në vitin 2030.

Objektivi Specifik 1.3: Forcimi i sigurisë dhe i mbrojtjes së individëve me rrezik, përfshirë dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë, përmes standardeve të mbrojtjes të harmonizuara me ato të BE-së

Forcimi i mbrojtjes, sigurisë dhe riintegrimit të individëve të rrezikuar, veçanërisht të dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe viktimave të krimit të organizuar ose veprave të rënda penale, është thelbësor për një përgjigje efektive dhe të besueshme ndaj krimit të organizuar. Këta individë, shpesh përballen me kërcënime serioze për jetën, integritetin fizik dhe mirëqenien e tyre psikologjike dhe gatishmëria e tyre për të bashkëpunuar me institucionet e drejtësisë varet nga ekzistenca e mekanizmave të mbrojtjes të fuqishëm, të besueshëm dhe konfidencialë. Siguria e tyre nuk është vetëm detyrim ligjor, por edhe parakusht themelor për goditjen e strukturave kriminale dhe për ndjekje penale të suksesshme. Në këtë kuadër, duhet të sigurohet që shërbimet e mbrojtjes dhe riintegrimit të jenë të aksesueshme dhe të përshtatshme, përfshirë strehimore dhe shtëpi të sigurta fizikisht të aksesueshme, si dhe personel të trajnuar për të ofruar mbështetje për individë me nevoja të ndryshme, përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e cenueshme.

Ky Objektiv Specifik përqendrohet në përafrimin e sistemeve të mbrojtjes së Shqipërisë me standardet e BE-së, duke forcuar kapacitetet institucionale, duke përmirësuar procedurat operative dhe duke zgjeruar gamën e shërbimeve mbështetëse në dispozicion të individëve nën mbrojtje. Kërkohet një qasje gjithëpërfshirëse, një qasje që kombinon mbrojtjen fizike dhe teknike, mbështetjen psikologjike, ndihmën financiare dhe rrugët afatgjata të riintegrimit. Duke forcuar programet e mbrojtjes së dëshmitarëve, duke rritur bashkëpunimin ndërkufitar për sistemimin e individëve dhe duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve të rehabilitimit dhe riintegrimit, Strategjia synon të ndërtojë një sistem që viktimat dhe bashkëpunëtorët mund t'i besojnë, duke i mundësuar atyre të marrin pjesë në mënyrë të sigurt dhe kuptimplotë në proceset gjyqësore. Të gjitha ndërhyrjet nën këtë objektiv udhëhiqen nga qasja e orientuar drejt viktimës dhe bazohen në të drejtat e njeriut, duke siguruar mbrojtje, mosdiskriminim, konfidencialitet, dhe zbatimin e parimit të mosndëshkimit për viktimat e trafikimit ose krimit të organizuar. Procedurat standarde operacionale do të hartohen në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke siguruar privatësinë dhe mekanizmat e sigurt të referimit dhe do të përshtaten vazhdimisht në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare për të rritur efikasitetin dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave. Përmes këtyre masave, Shqipëria do të forcojë besimin e publikut tek institucionet shtetërore, do të përforcojë sundimin e ligjit dhe do të garantojë që individët me rrezik të marrin mbrojtjen, dinjitetin dhe mbështetjen që u nevojitet për të rindërtuar jetën e tyre.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Rritja e gatishmërisë së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve për të dëshmuar, e matur me shkallë të rritur të bashkëpunimit në procedimet e krimit të organizuar.

Rezultati 2: Siguri fizike e qëndrueshme e personave të mbrojtur, me zero humbje për shkak të dështimeve të sigurisë dhe mbrojtjes së tyre.

Rezultati 3: Integrimi i suksesshëm pas daljes nga programi i mbrojtjes në jetën normale i pjesëmarrësve.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes Masave të mëposhtme:

Masa 1.3.1: Garantimi i jetës dhe sigurisë fizike të dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë, viktimave të trafikimit dhe zyrtarëve të ngarkuar me luftimin e krimit të organizuar.

Masa 1.3.2: Nënshkrimi i marrëveshjeve me njësitë homologe për rialokimin jashtë të programeve të mbrojtjes me qëllim përforcimin e mekanizmave të sigurimit të jetës së bashkëpunëtorëve dhe dëshmitarëve të drejtësisë.

Masa 1.3.3: Garantimi i mbrojtjes fizike dhe teknike në vendin e banimit si dhe gjatë lëvizjeve të tyre, për personat e përfshirë në programin e mbrojtjes me Vendim të Komisionit për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

Masa 1.3.4: Ofrimi i mbështetjes dhe testimit periodik dhe vjetor psikologjik për personat e përfshirë në programin e mbrojtjes.

Masa 1.3.5: Rehabilitimi social i personave të përfshirë në programin e mbrojtjes me Vendim të Komisionit për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

Masa 1.3.6: Ofrimi i ndihmës financiare për personat e përfshirë në programin e mbrojtjes me Vendim të Komisionit për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

Masa 1.3.7: Ofrimi i rikualifikimeve profesionale, me qëllim integrimin pas përfundimit të programit të mbrojtjes, për personat e përfshirë në programin e mbrojtjes me Vendim të Komisionit për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

Masa 1.3.8: Ofrimi i këshillimit dhe ndihmës ligjore të specializuar për personat e përfshirë në programin e mbrojtjes me Vendim të Komisionit për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

Për të mbështetur arritjen e këtyre Masave, do të zbatohen Aktivitetet e mëposhtme:

Aktivitete për masën 1.3.1

- Kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme të rrezikut dhe hartimi i planeve të sigurisë të përshtatura për çdo person të mbrojtur, duke siguruar përshtatje të shpejtë me kërcënimet në evolim dhe rrethanat operacionale.
- Forcimi i njësive mbrojtëse përmes trajnimit të specializuar, sistemeve të sigurta të komunikimit dhe protokolleve të koordinuara operacionale për të garantuar siguri fizike të pandërprerë.

Aktivitete për masën 1.3.2

- Negocimi dhe formalizimi i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të bashkëpunimit me njësitë homologe të mbrojtjes, për të mundësuar zhvendosje të sigurt jashtme vendit kur mbrojtja brenda vendit është e pamjaftueshme.
- Miratimi i procedurave të standardizuara për transferimet ndërkombëtare, përfshirë protokollet e ndarjes së informacionit, garancitë e konfidencialitetit dhe planifikimin e koordinuar operacional.

Aktivitete për masën 1.3.3

- Hartimi dhe mbajtja e masave mbrojtëse teknike, si sistemet e mbikëqyrjes, transportin e sigurt dhe rregullave të aksesit të kontrolluar në vendbanime dhe vendndodhje e tjera të sigurta.
- Kryerja e operacioneve të sigurta dhe të paraplanifikuara të zhvendosjes/lëvizjes, duke përdorur vlerësim të rrezikut të rrugë të përdorura, skuadra shoqëruese dhe monitorim në kohë reale, për të parandaluar ekspozimin ndaj kërcënimeve.

Aktivitete për masën 1.3.4

- Kryerja e vlerësimeve periodike psikologjike dhe e sesioneve të këshillimit, për të monitoruar mirëqenien emocionale, reagimet ndaj traumës dhe nivelet e stresit të personave të mbrojtur.

- Hartimi i planeve të personalizuara të mbështetjes psikologjike, përfshirë mekanizmat e ndërhyrjes në krizë dhe referimet te profesionistët e specializuar të shëndetit mendor, kur është e nevojshme.

Aktivitete për masën 1.3.5

- Realizimi i programeve të strukturuara të rehabilitimit, që përfshijnë zhvillimin e aftësive sociale, mbështetjen familjare dhe rrugët e riintegrimit komunitar, të përshtatura me nevojat individuale.
- Koordinimi me ofruesit e shërbimeve sociale, bashkitë dhe shoqërinë civile, për të siguruar strehim, arsim, kujdes shëndetësor dhe rrjete mbështetëse me bazë komunitare.

Aktivitete për masën 1.3.6

- Alokimi dhe menaxhimi i paketave të mbështetjes financiare, që mbulojnë shpenzimet bazë të jetesës, nevojat emergjente dhe kostot e riintegrimit, për individët në programin e mbrojtjes.
- Rishikime periodike të ndihmës financiare për të siguruar mjaftueshmëri, transparencë dhe harmonizim me nevojat e ndryshueshme të personave të mbrojtur.

Aktivitete për masën 1.3.7

- Përgatitja dhe zbatimi i programeve të trajnimit profesional dhe të zhvillimit të aftësive, të përshtatura me nevojat e tregut të punës dhe profilet personale të personave të mbrojtur.
- Mbështetje për sistemimit në punë, përfshirë këshillimin e karrierës, angazhimin e punëdhënësve dhe referimin te shërbimet e punësimit për të siguruar riintegrim të qëndrueshëm.

Aktivitete për masën 1.3.8

- Ofrimi i këshillimit të vazhdueshëm ligjor për personat e mbrojtur mbi të drejtat, detyrimet dhe aspektet procedurale të bashkëpunimit gjyqësor, duke siguruar pjesëmarrje të informuar në procedime.
- Ofrimi i përfaqësimit ligjor të specializuar dhe mbështetjes gjatë proceseve gjyqësore, procedurave administrative dhe çështjeve ligjore të lidhura me riintegrimin.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Numri i personave të pranuar dhe aktivisht të mbrojtur nga programi i mbrojtjes.

Produkti 2: Numri i marrëveshjeve dypalëshe të lidhura për zhvendosje jashtë vendit.

Produkti 3: Numri i vlerësimeve psikologjike dhe sesioneve mbështetëse të ofruara.

Produkti 4: Numri i paketave të rikualifikimit dhe riintegrimit të ofruara.

Institucionet përgjegjëse: Policia e Shtetit.

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Shkalla e suksesit të mbrojtjes së individëve të rrezikuar, përfshirë dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë.

Vlera bazë: Vlera bazë e programit (93% shkalla e mbrojtjes së suksesshme) e vendosur në vitin 2026.

Synimi deri në 2030: 96% shkalla e mbrojtjes së suksesshme.

Objektivi Specifik 1.4: Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë

Në një kohë kur krimi i organizuar vazhdon të gjejë mënyra të reja dhe më të sofistikuara për të vepruar, përfshirë pastrimin e parave dhe aktivitetet e paligjshme në shumë aspekte, rritja e profesionalizmit të institucioneve ligjzbatuese është një domosdoshmëri dhe prioritet strategjik. Për të mundësuar një luftë më efektive kundër krimit, është thelbësore që shërbimet ligjzbatuese, prokuroritë dhe gjykatat të kenë njohuri të thella, teknologji moderne dhe kapacitete të avancuara për hetime dhe procedura ligjore. Ky profesionalizëm duhet të shtrihet jo vetëm në nivelin e

njohurive teknike, por edhe në aftësinë për të menaxhuar sfidat e reja që rrjedhin nga zhvillimet e shpejta në teknologji dhe metodat e krimit.

Për të arritur këtë, nevojiten investime në trajnim të vazhdueshëm, zhvillim të kapaciteteve, si dhe shkëmbim të përvojave me partnerët ndërkombëtarë. Në të njëjtën kohë, mekanizmat e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies brenda institucioneve të zbatimit të ligjit duhet të forcohen, me qëllim parandalimin e çdo mundësie abuzimi me pushtetin dhe zbatimin e barabartë të ligjit për të gjithë. Rritja e nivelit të profesionalizmit do të përmirësojë jo vetëm efikasitetin e institucioneve, por do të krijojë gjithashtu besim më të madh publik te drejtësia dhe ligji, duke mundësuar një mjedis më të sigurt dhe më të drejtë për shoqërinë.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Rritje e matshme në zbulimin dhe hetimin e çështjeve komplekse të krimit të organizuar.

Rezultati 2: Përqindje më e lartë e hetimeve që zbatojnë teknikat e hetimit paralel financiar.

Rezultati 3: Cilësi e përmirësuar e të dhënave të menaxhimit të çështjeve që mundëson alokim të burimeve bazuar në të dhëna.

Rezultati 4: Sigurimi i pavarësisë operacionale të BKH-së.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes Masave të mëposhtme:

Masa 1.4.1: Reformimi i Policisë Kriminale përmes modernizimit të strukturës organizative, përmirësimit të kapaciteteve teknologjike, trajnimit, zhvillimit profesional të personelit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, përfshirë zbatimin e dispozitave të ligjit të ri nr. 82/2024 për Policinë e Shtetit.

Masa 1.4.2: Rritja e kapaciteteve hetimore kundër të gjitha formave të krimit të organizuar (në veçanti krimit ekonomik dhe financiar, krimit kibernetik, hetimit financiar, identifikimit dhe sekuestrimit të aseteve), përmes trajnimeve të avancuara, futjes dhe përdorimit të vazhdueshëm të teknologjive moderne, forcimit të kapaciteteve teknike, financiare, dhe infrastrukturore, përdorimit të inteligjencës kriminale, dhe bashkëpunimit e shkëmbimit të informacionit me partnerët ndërkombëtarë.

Masa 1.4.3: Rekrutimi punonjësve për shërbimin e policisë gjyqësore, në përputhje me nevojat operacionale të identifikuara dhe boshllëqet e prioritizuara të aftësive.

Masa 1.4.4: Profilizimi i programeve të Akademisë së Sigurisë dhe arsimimi/trajnimi i punonjësve të Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë përmes përditësimit të kurrikulave dhe ofrimit të moduleve të specializuara të Akademisë së Sigurisë.

Masa 1.4.5: Trajnimi i oficerëve të policisë gjyqësore për hetimin financiar paralel me hetimin penal, për veprat parësore që gjenerojnë të ardhura kriminale.

Masa 1.4.6: Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe efikasitetin e hetimit dhe ndjekjeve të veprave penale.

Masa 1.4.7: Rritja kapaciteteve hetimore dhe analitike (njerëzore dhe teknike) të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe efikasitetin e hetimit dhe ndjekjeve të veprave penale.

Masa 1.4.8: Operacionalizimi plotë i sistemit *e-Presto,* për të cilin masat administrative paraprake për zhvillimin teknologjik kanë përfunduar, ndërkohë që prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme finalizojnë dhe përditësojnë çështjet dhe seksionet përkatëse.

Masa 1.4.9: Operacionalizimi plotë i i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve në Prokurorinë e Përgjithshme.

Masa 1.4.10: Operacionalizimi plotë i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Për të mbështetur arritjen e këtyre Masave, do të zbatohen Aktivitetet e mëposhtme:

Aktivitete për masën 1.4.1

- Zbatimi i masave të ristrukturimit organizativ dhe modernizimit që kërkon ligji nr. 82/2024, përfshirë rolet e përditësuara funksionale, strukturat e thjeshtuara të komandimit dhe mekanizmat e përmirësuar të llogaridhënies së brendshme.
- Modernizimi i kapaciteteve teknologjike (si mjetet e hetimit digjital, sistemet e komunikimit të sigurt dhe platformat analitike) dhe ofrimi i programeve të vazhdueshme të zhvillimit profesional të harmonizuara me standardet e policisë në BE.

Aktivitete për masën 1.4.2

- Ofrimi i programeve të avancuara të trajnimit mbi krimin ekonomik dhe financiar, hetimin e krimit kibernetik, profilizimin financiar dhe teknikat e gjurmimit të aseteve, duke siguruar zbatim të metodologjive moderne nga ana e hetuesve.
- Zgjerimi i përdorimit të inteligjencës kriminale, kriminalistikës digjitale dhe mjeteve analitike, dhe forcimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për të mbështetur hetime komplekse ndërkufitare.

Aktivitete për masën 1.4.3

- Kryerja e vlerësimeve të nevojave për të identifikuar boshllëqet operacionale dhe fushat prioritare ku kërkohet personel shtesë të policisë gjyqësore.
- Zbatimi i proceseve transparente të rekrutimit për të garantuar përzgjedhjen e kandidatëve të kualifikuar me aftësitë e nevojshme për funksionet e specializuara hetimore.

Aktivitete për masën 1.4.4

- Përditësimi i kurrikulave të Akademisë së Sigurisë, duke futur module të specializuara mbi krimin e organizuar, hetimin financiar, krimin kibernetik dhe policimin e udhëhequr nga inteligjenca.
- Ofrimi i cikleve të vazhdueshme të trajnimit për punonjësit e Policisë së Shtetit, duke siguruar harmonizim me tendencat evoluese të krimit, standardet e BE-së dhe nevojat operacionale.

Aktivitete për masën 1.4.5

- Ofrimi i trajnimeve të specializuara për kryerjen e hetimeve financiare krahas hetimeve të veprave penale parësore, përfshirë gjurmimin e aseteve, analizën financiare dhe mbledhjen e provave.
- Përgatitja e procedurave standarde operacionale dhe e ushtrimeve praktike të çështjeve, për të siguruar zbatim konsistent të teknikave të hetimit paralel financiar.

Aktivitete për masën 1.4.6

- Rekrutimi i prokurorëve shtesë të specializuar, analistë dhe personel mbështetës, për të forcuar aftësinë e SPAK-ut, si dhe të hetuesve dhe oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore në Byronë Kombëtare të hetimit, me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale për hetimin dhe ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në kuadër të zbatimit të strukturës së re organizative, BKH-ja parashikohet të rekrutojë 40 hetues dhe 40 oficerë të shërbimeve të policisë gjyqësore.
- Prokurimi i teknologjive të avancuara hetimore, sistemeve digjitale të sigurta dhe mjeteve analitike dhe pajisjeve në funksion të pavarësisë operacionale, për të rritur efikasitetin operacional të SPAK-ut dhe kapacitetet për trajtimin e çështjeve.

Aktivitete për masën 1.4.7

- Ngritja e skuadrave analitike shumëdisiplinore, të pajisura me mjete moderne për analizën e të dhënave, skicimin e lidhjeve, profilizimin financiar dhe përpunimin e provave digjitale.

- Ofrimi i trajnimit të vazhdueshëm për hetuesit dhe analistët e SPAK-ut mbi ndërtimin e çështjeve komplekse, shfrytëzimin e inteligjencës dhe mekanizmat e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Aktivitete për masën 1.4.8

- Përfundimi i hedhjes së të dhënave, përditësimeve të çështjeve dhe popullimit të seksioneve nga prokurorët në zyrat me juridiksion të përgjithshëm, për të siguruar funksionalitet të plotë të sistemit *e-Presto.*

- Ofrimi i trajnimit dhe mbështetjes teknike për prokurorët dhe personelin administrativ, për të siguruar përdorim konsistent të sistemit për menaxhimin dhe raportimin e çështjeve.

Aktivitete për masën 1.4.9

- Finalizimi i integrimit të sistemit, aksesit të përdoruesit dhe migrimit të të dhënave, për të mundësuar përdorim të plotë operacional të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve në Prokurorinë e Përgjithshme.

- Ofrimi i trajnimit për prokurorët dhe personelin administrativ mbi funksionalitetet e SMÇ-së, që të përmirësohet cilësia e të dhënave, gjurmimi i çështjeve dhe alokimi i burimeve bazuar në të dhëna.

Aktivitete për masën 1.4.10

- Instalimi, konfigurimi dhe funksionimi i sigurt i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve brenda SPAK-ut, përfshirë integrimin me mjetet hetimore dhe analitike.

- Ofrimi i trajnimit të specializuar për prokurorët dhe personelin e SPAK-ut për të maksimizuar përdorimin e sistemit për menaxhimin e çështjeve komplekse, monitorimin e performancës dhe planifikimin strategjik.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Numri i njësive organizative të Policisë Kriminale të ristrukturuara sipas ligjit nr. 82/2024, si dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit sipas Ligjit nr. 95/2026, i ndryshuar.

Produkti 2: Numri i oficerëve, hetuesve dhe shërbimeve të policisë gjyqësore në BKH të trajnuar në hetime financiare dhe teknika të specializuara në çështjet kundër krimit të organizuar.

Produkti 3: Numri i vendeve të punës në policinë gjyqësore të plotësuara për cikël rekrutimi.

Produkti 4: Statusi operacional i *e-Presto* dhe SMÇ-së, si dhe metrika e popullimit të çështjeve.

Institucionet përgjegjëse: Policia e Shtetit, Akademia e Sigurisë, Byroja Kombëtare e Hetimit, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokuroria e Përgjithshme.

Institucionet mbështetëse: Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme;, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Byroja Kombëtare e Hetimit, Policia e Shtetit/Akademia e Sigurisë, Ministria e Drejtësisë.

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Përqindja e çështjeve të krimit të organizuar të dërguara për gjykim që përfshijnë hetim financiar paralel.

Vlera bazë: Viti 2025, SPAK: 20%;

Synimi deri në 2030: do të konfirmohet në vitin 2026.

Objektivi Specifik 1.5: Reduktimi i stimujve dhe mundësive financiare për krimin e organizuar nëpërmjet forcimit të kontrolleve ekonomike dhe ndërprerjes së burimeve të financimit

Krimi i organizuar lulëzon kur gjen mundësi financiare dhe aftësia e tij për të gjeneruar, fshehur dhe riinvestuar fitimet e paligjshme është ajo që mban strukturat kriminale të qëndrueshme me

kalimin e kohës. Prandaj, reduktimi i incentivave dhe mundësive financiare për krimin e organizuar është një komponent kritik i arkitekturës parandaluese dhe zbatuese të Shqipërisë. Duke forcuar kontrollet ekonomike, duke përmirësuar mbikëqyrjen e bazuar në rrezik dhe duke ndërprerë flukset e paligjshme financiare, Strategjia synon të dërgojë një mesazh të qartë dhe të qëndrueshëm: përfshirja në krimin e organizuar nuk ia vlen. Vendosja në shënjestër e dimensionit financiar të aktivitetit kriminal jo vetëm dobëson rrjetet kriminale, por edhe dekurajon shkelësit e mundshëm duke hequr përfitimet ekonomike që nxitin pjesëmarrjen në tregjet e paligjshme.

Ky Objektiv Specifik fokusohet në rritjen e kapacitetit të institucioneve shtetërore në zbulimin, parandalimin dhe kundërpërgjigjen ndaj krimeve financiare të lidhura me grupet e organizuara kriminale. Përmes vlerësimeve gjithëpërfshirëse të kërcënimeve, inspektimeve të koordinuara dhe zhvillimit të mjeteve specifike sektoriale të vlerësimit të rrezikut, institucionet do të jenë më të mirëpajisura në identifikimit e sektorëve me rrezik të lartë, në monitorimin e aktiviteteve të dyshimta dhe në ndërhyrjen e hershme. Forcimi i kontrolleve kundër informalitetit, evazionit fiskal dhe shmangies tatimore do të reduktojnë më tej hapësirën ekonomike në të cilën veprojnë grupet kriminale, ndërsa përmirëson transparencën dhe llogaridhënien në të gjithë ekonominë. Këto masa mbështesin edhe përpjekjet më të gjera kombëtare për të përmirësuar integritetin fiskal dhe për t'u harmonizuar me standardet e BE-së për luftën kundër pastrimit të parave dhe për mbikëqyrjen financiare.

Element kyç i këtij objektivi është përdorimi strategjik i aseteve të konfiskuara, në mënyrë që të ardhurat kriminale jo vetëm t'u hiqen shkelësve, por edhe të riinvestohen për interes publik. Duke promovuar ripërdorimin social të pronave të konfiskuara dhe duke integruar metodologjitë e bazuara në rrezik në sistemet e inspektimit, Shqipëria përforcon një model parandalues që ndërpret financat kriminale, ndërsa mbështet zhvillimin komunitar. Përmes veprimit të koordinuar midis autoriteteve ligjzbatuese, tatimore dhe doganore, qeverisjes vendore dhe partnerëve ndërkombëtarë, Strategjia synon të ndërtojë një kornizë të fortë për ndërprerjen e krimeve financiare, forcojë rezistencën institucionale dhe kontribuojë në stabilitetin afatgjatë ekonomik dhe social.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Rritje e konsiderueshme e vlerës vjetore të aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Rezultati 2: Hetimi paralel financiar bëhet standard operacional për të gjitha veprat penale që sigurojnë të ardhura të jashtëligjshme.

Rezultati 3: Monitorimi i bazuar në rrezik i sektorëve me rrezik të lartë institucionalizohet dhe mbahet i qëndrueshëm.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes Masave të mëposhtme:

Masa 1.5.1: Kryerja e vlerësimit kombëtar të kërcënimeve nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda.

Masa 1.5.2: Rritja e kontrolleve të bazuara në rrezik, të kryera kundër informalitetit, evazionit fiskal dhe shmangies tatimore.

Masa 1.5.3: Forcimi i kontrolleve dhe inspektimeve të koordinuara dhe inspektimeve te bizneset me rrezik të lartë.

Masa 1.5.4: Monitorimi i mallrave me risk të lartë mallrave të cenueshme ndaj evazionit fiskal.

Për të mbështetur arritjen e këtyre Masave, do të zbatohen Aktivitetet e mëposhtme.

Aktivitete për masën 1.5.1

- Kryerja e një vlerësim gjithëpërfshirës kombëtar të kërcënimeve, duke integruar inteligjencën ligjzbatuese, të dhënat e sektorit financiar dhe treguesit specifikë sektorialë të rrezikut, për të identifikuar tregjet kriminale, tendencat në zhvillim dhe sektorët me rrezik të lartë.

- Përgatitja e një raport analitik me kërcënimet e prioritizuara, masat zbutëse të rekomanduara dhe inteligjencën që orienton veprimet, me qëllim që të udhëheqë planifikimin operacional dhe alokimin e burimeve nëpër institucione.

Aktivitete për masën 1.5.2

- Zbatimi i inspektimeve dhe auditime të shënjestruara të bazuara në rrezik, në sektorët me ekspozim të lartë ndaj informalitetit dhe evazionit fiskal, duke përdorur analitikë të të dhënave dhe shkëmbim ndërinstitucional të informacionit për të prioritizuar çështjet.

- Forcimi i zbatueshmërisë duke integruar rezultatet e inteligjencës financiare, treguesit e transaksioneve të dyshimta dhe profilet specifike sektoriale të rrezikut në planifikimin e inspektimeve dhe procedurat vijuese.

Aktivitete për masën 1.5.3

- Ngritja e skuadrave të përbashkëta të inspektimit/kontrollit/mbikëqyrjes, që përfshijnë autoritetet mbikëqyrëse në fushën e PPP/FT, autoritetet doganore dhe tatimore, autoritetet licencuese, për të kryer kontrolle të koordinuara të bizneseve me rrezik të lartë, duke siguruar zbatim konsistent dhe dublikim të reduktuar, sipas fushës së përgjegjësisë.

- Zhvillimi dhe zbatimi i mjeteve specifike sektoriale të vlerësimit të rrezikut, për të identifikuar bizneset me ekspozim të shtuar ndaj infiltrimit të krimit të organizuar, duke mundësuar ndërhyrje të hershme dhe mbikëqyrje të bazuar në risk.

Aktivitete për masën 1.5.4

- Monitorimi sistematik i mallrave me rrezik të lartë, si karburanti, duhani, alkooli dhe produktet e akcizës, duke përdorur sistemet digjitale të gjurmimit, të dhënat doganore dhe profilizimin e bazuar në rrezik.

- Kryerja e veprimeve të përbashkëta operacionale për të zbuluar parregullsitë në zinxhirët e importit, eksportit dhe shpërndarjes, duke siguruar referim në kohë të rasteve të dyshimta për hetim dhe ndjekje financiare.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Numri i manualeve të vlerësimit sektorial të rrezikut të hartuar dhe të përditësuar çdo vit.

Produkti 2: Vlera vjetore e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara përmes hetimit paralel financiar.

Produkti 3: Volumi i informacioneve (inteligjencës financiare) të ndarë nga AIF, tek institucionet e zbatimit të ligjit (DPT, PP dhe PSH) dhe rezultatet hetimore të raportuara prej këtyre agjencive (rastet e referuara në prokurori).

Institucionet përgjegjëse: Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Institucionet mbështetëse: Ministritë relevante të linjës; Policia e Shtetit, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Shërbimi Informativ i Shtetit, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, Prokuroria e Përgjithshme; Prokuroria e Posaçme; Byroja Kombëtare e Hetimit;

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Norma e aseteve të konfiskuara kundrejt vlerës së pasurive të sekuestruara në procedimet penale.

Vlera bazë: Vlera bazë e 2025 (3%): pasuri të sekuestruara 5,885,833,434 ALL; konfiskuara 180,670,028.80 ALL;

Synimi deri në 2030: +8% rritje e vlerës deri në vitin 2030.

Objektivi specifik 1.6: Zbatimi i efektshëm i qasjes administrative për të parandaluar infiltrimin e krimit të organizuar në ekonomi dhe në administratën publike

Qasja administrative ndaj krimit të organizuar është një model gjithëpërfshirës i politikave publike, që përdor instrumentet ligjore dhe administrative ekzistuese për të parandaluar, dobësuar dhe kufizuar veprimtarinë e strukturave kriminale pa u kufizuar vetëm në ndjekjen penale. Në këtë kuptim, ajo është plotësuese me hetimin e veprave penale, jo zëvendësuese, dhe synon të ndërhyjë në fazat e hershme të ciklit kriminal, duke bllokuar të ardhurat dhe aksesin e aktorëve kriminalë në ekonomi dhe institucionet publike. Përfshirja e elementeve të qasjes administrative në kornizën strategjike të luftës kundër krimit të organizuar mund të krijojë një kornizë më të balancuar dhe parandaluese për masa institucionale në këtë fushë. Kjo qasje forcon instrumentet që parandalojnë ndikimin ekonomik dhe institucional të strukturave kriminale, duke rritur efikasitetin e përgjigjes shtetërore përtej mekanizmave penalë ekzistues.

Përfshirja e qasjes administrative ndaj krimit të organizuar në Strategjinë Kombëtare 2026-2030 dhe në Planin e Veprimit 2026-2028, përbën një hap të nevojshëm drejt modernizimit të politikave publike të sigurisë dhe forcimit të komponentit parandalues të shtetit shqiptar në luftën kundër krimit të organizuar, në pajtim të plotë me kornizën e politikave të Bashkimit Evropian në fushën e drejtësisë dhe sigurisë (Kapitujt 23 dhe 24), si dhe me Strategjinë Evropiane për Sigurinë e Brendshme - ProtectEU (COM(2025) 148 final) dhe prioritetet e EMPACT-it.

Qasja administrative është tashmë një instrument i konsoliduar në Shtetet Anëtare, ku përdoret për:

- pengimin e futjes së strukturave kriminale në ekonominë e ligjshme dhe administratën publike;
- forcimin e rezistencës institucionale ndaj korrupsionit dhe ndikimeve kriminale;
- plotësimin e mekanizmave penalë me mjete administrative, tatimore, fiskale, mjedisore dhe licencimi.

Për Shqipërinë, e cila është në fazë të avancuar negocimin për mbylljen e Kapitujve 23-24, ndjekja e kësaj qasjeje do të sinjalizonte një harmonizim të drejtpërdrejtë me *Acquis* të BE-së dhe me praktikat e Rrjetit Evropian për Qasjen Administrative (ENAA), në të cilin vendet e rajonit janë tashmë të përfshira si vëzhgues.

Në realitetin shqiptar, ku krimi i organizuar ka dimension të theksuar ekonomik dhe shpesh vepron përmes infiltrimit në sektorët publikë dhe privatë, qasja administrative ofron një mjet praktik, fleksibël dhe parandalues për ndërhyrje të hershme.

Kjo qasje:

- forcon bashkëpunimin ndërinstitucional, duke ndërlidhur policinë, prokurorinë, autoritetet tatimore, doganat, inspektoratet dhe njësitë vendore në një sistem paralel parandalimi;
- redukton mbështetjen te ndjekjet e veprave penale si mekanizmi i vetëm kundër krimit të organizuar;
- shmang koston dhe vonesat e procedimeve gjyqësore, duke vepruar përmes mjeteve administrative ligjore ekzistuese;
- krijon një model të qëndrueshëm për mbrojtjen e integritetit publik dhe ekonomik.

Përfshirja e qasjes administrative si objektiv specifik si dhe masa konkrete në Planin e Veprimit 2026-2028 ndihmojnë në: i. forcimin e koordinimit midis institucioneve rregullatore dhe atyre ligjzbatuese; ii. rritjen e efikasitetit në zbatimin e Strategjisë; iii. dhe krijimin e mekanizmave kombëtarë për vlerësimin e rrezikut administrativ, të cilët aktualisht mungojnë në kornizën ligjore shqiptare.

Dimensioni institucional i qasjes administrative bazohet në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe shkëmbimin e vazhdueshëm të informacionit midis institucioneve të ligjzbatuese, administratës tatimore, inspektorateve, njësive vendore dhe institucioneve financiare. Ky mekanizëm mundëson identifikimin e hershëm të rrezikut, miratimin e masave parandaluese administrative dhe përgjigje të shpejtë institucionale, duke forcuar integritetin dhe bashkëpunimin kombëtar.

Në të njëjtën kohë, dimensioni ekonomik, parandalues dhe social synon të dobësojë motivimin financiar të krimit përmes masave administrative si revokimi i licencave, përjashtimi nga tenderët dhe inspektimet e bazuara në risk. Kjo qasje e zhvendos fokusin nga reagimi penal te parandalimi, duke mbrojtur ekonominë e ligjshme dhe duke forcuar kulturën e integritetit, transparencës dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Verifikimi i subjekteve të krimit të organizuar zbatohet në të gjitha vendimet përkatëse të prokurimit publik dhe licencimit.

Rezultati 2: Reduktimi i dokumentuar i infiltrimit të suksesshëm në kontratat publike dhe licencat me rrezik të lartë.

Ky objektiv specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme:

Masa 1.6.1: Hartimi i Udhëzuesit Kombëtar për Qasjen Administrative ndaj Krimit të Organizuar

Masa 1.6.2: Ngritja e një rrjeti ndërinstitucional për zbatimin e qasjes administrative, që përfshin të gjitha agjencitë me kompetenca inspektimi dhe licencimi, për shkëmbimin e të dhënave dhe sinjalizimin e rrezikut.

Masa 1.6.3: Ngritja e mekanizmave të verifikimit të integritetit për operatorët ekonomikë që marrin pjesë në tenderë publikë, licenca, ose subvencione shtetërore, përmes filtrave të bazuar në të dhëna administrative.

Masa 1.6.4: Trajnimi i zyrtarëve të administratës publike dhe vendore mbi qasjen administrative, menaxhimin e rrezikut dhe parandalimin e infiltrimit kriminal në vendimmarrjen administrative.

Për të mbështetur arritjen e këtyre masave, do të zbatohen aktivitetet e mëposhtme:

Aktivitete për masën 1.6.1

- Hartimi i Udhëzuesit Kombëtar duke konsoliduar praktikat më të mira të BE-së (ENAA), legjislacionin kombëtar dhe mandatet institucionale, si dhe duke vendosur procedura të qarta për parandalimin, shkëmbimin e informacionit dhe zbutjen e riskut administrativ.
- Kryerja e konsultimeve ndërinstitucionale me autoritetet ligjzbatuese dhe tatimore, doganat, inspektoratet, qeverisjen vendore dhe shoqërinë civile, për të konsoliduar Udhëzuesin dhe për të siguruar zbatueshmëri praktike nëpër sektorë.

Aktivitete për masën 1.6.2

- Formalizimi i rrjetit ndërinstitucional përmes memorandumeve të bashkëpunimit, duke përcaktuar role, përgjegjësi, protokolle të shkëmbimit të të dhënave dhe procedura të sinjalizimit të rrezikut midis të gjitha organeve të inspektimit dhe licencimit.
- Ngritja dhe vënia në punë e një platformë të sigurt për ndarjen e informacionit, e cila mundëson shkëmbim në kohë reale të të dhënave administrative, sinjalizimeve dhe tregues të rrezikut, midis institucioneve pjesëmarrëse.

Aktivitete për masën 1.6.3

- Miratimi dhe zbatimi i filtrave administrativë të integritetit, bazuar në të dhënat tatimore, historikun e licencimit, konstatimet e inspektimeve, informacionin për pronësinë përfituese dhe

sinjalizimet e autoriteteve ligjzbatuese, me qëllim skanimin e operatorëve ekonomikë përpara se të merren vendimet publike.

- Integrimi i procedurave të verifikimit të integritetit në praktikat e prokurimit, licencimit dhe subvencionit, duke siguruar që operatorët me rrezik të lartë të sinjalizohen, rishikohen ose përjashtohen në përputhje me dispozitat ligjore.

Aktivitete për masën 1.6.4

- Trajnimi i zyrtarëve të administratës publike dhe vendore mbi qasjen administrative, menaxhimin e rrezikut dhe parandalimin e infiltrimit kriminal.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Numri i kontrolleve të prokurimit publik të kryera kundrejt listave të subjekteve të krimit të organizuar.

Produkti 2: Numri i licencave me rrezik të lartë të verifikuara dhe të lëshuara në kuadrin e procedurave administrative të parandalimit.

Produkti 3: Numri i skualifikimeve dhe veprimeve korrigjuese të ndërmarra ndaj subjekteve të infiltruara.

Institucionet përgjegjëse: Ministria e Punëve të Brendshme.

Institucionet mbështetëse: Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Kontrolli i Lartë i Shtetit, ASIG, Bashkitë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Ministria e Financave.

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Ulja e rasteve të identifikuara të infiltrimit të krimit të organizuar në prokurimet publike dhe sektorët e licencuar.

Vlera bazë: Vlera bazë e rasteve aktuale të infiltrimit dhe normave të kontrollit/verifikimit do të vendoset në vitin 2026;

Synimi deri në 2030: -9% ulje e rasteve të identifikuara të infiltrimit të krimit të organizuar në prokurimet publike dhe sektorët e licencuar.

2.2 QËLLIMI I POLITIKËS II: NDJEKJA PENALE DHE GODITJA E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA

Ndjekja penale dhe ndërprerja operacionale e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda përbën Qëllim Politik të dytë të kësaj strategjie, duke përfshirë nëntë objektiva specifikë që adresojnë spektrin e plotë të kërcënimeve kriminale të identifikuara në Pjesën I. Qëllimi i Politikës II kalon nga parandalimi te zbatimi i drejtpërdrejtë, duke ndërtuar kapacitetet hetimore, kriminalistike, analitike dhe institucionale të nevojshme për zbulimin, ndërprerjen, ndjekjen penale dhe goditjen e rrjeteve të organizuara kriminale.

Nëntë Objektivat Specifikë nën këtë Qëllim mbulojnë: zbatimin e luftës kundër narkotikëve të udhëhequr nga inteligjenca dhe sistemin kombëtar të monitorimit të drogës; ndërprerjen e trafikimit të paligjshëm në të gjitha format e tij; zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar dhe krimit kibernetik; cilësinë dhe akreditimin të shërbimit forenksik; gjurmimin, sekuestrimin dhe ripërdorimin e aseteve; hetimet dhe ndjekjet penale të synuara me vlerë të lartë të udhëheqësve të grupeve të organizuara kriminale; luftën kundër krimit mjedisor; dhe ndjekjen ndërkombëtare të personave të kërkuar. Së bashku, ato përfaqësojnë një arkitekturë gjithëpërfshirëse të ndjekjes penale, bazuar në evidenca, të harmonizuar me prioritetet EMPACT të BE-së dhe rekomandimet e Raportit të Progresit të BE-së 2024 për Shqipërinë.

Një parim ndërsektorial sipas këtij Qëllimi është zbatimi sistematik i hetimeve paralele financiare, krahas të gjitha hetimeve penale për krimin e organizuar, trafikimin dhe korrupsionin.

Kjo qasje "ndiq paranë" garanton që hetimet penale të adresojnë njëkohësisht si aktivitetin kriminal, ashtu edhe dimensionin e tij financiar, duke maksimizuar ndërprerjen e të ardhurave kriminale dhe efektin parandalues të ndjekjes penale.

Objektivi Specifik 2.1: Reduktimi i disponueshmërisë, prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve përmes forcimit të zbulimit, hetimit dhe koordinimit ndërinstitucional

Ky objektiv synon të ndërmarrë masa efektive dhe të koordinuara për të forcuar kontrollin dhe monitorimin e aktiviteteve të dyshimta të lidhura me trafikimin dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike. Për arritjen e këtij qëllimi, krijimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit të ngushtë dhe të vazhdueshëm midis agjencive kombëtare ligjzbatuese, institucioneve të sigurisë dhe organeve hetimore, si dhe partnerëve ndërkombëtarë që veprojnë në fushën e luftimit të lëndëve narkotike, është një element thelbësor. Ky bashkëpunim do të mundësojë shkëmbimin në kohë të informacionit të nevojshëm, koordinimin e operacioneve të përbashkëta dhe ndarjen e praktikave më të mira, duke rritur kështu kapacitetin e përgjithshëm për ndërprerjen e rrjeteve kriminale që veprojnë në këtë sektor.

Në kuadrin e këtij objektivi, procesi i reformimit dhe forcimit të sistemit ligjor dhe institucional do të vazhdojë, me qëllim sigurimin e funksionimit efikas të mekanizmave të avancuar dhe strukturave për identifikimin, ndjekjen penale dhe parandalimin e aktiviteteve kriminale të lidhura me lëndët narkotike. Kjo përfshin përmirësimin e kornizës ligjore për t'u përshtatur me sfidat e reja dhe vendimet e Komisionit për Lëndët Narkotike, si dhe forcimin e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe hetimin e këtyre aktiviteteve. Për më tepër, parashikohet investim në teknologji dhe trajnim të specializuar për punonjësit e strukturave përgjegjëse, duke rritur aftësinë për të zbuluar dhe ndërprerë zinxhirët e shpërndarjes së drogës, duke siguruar kështu një përgjigje më të shpejtë dhe më efektive ndaj këtij fenomeni kompleks. Në këtë mënyrë, strategjia synon të krijojë një sistem të qëndrueshëm dhe efikas në luftën kundër lëndëve narkotike, që do të kontribuojë në ruajtjen e sigurisë dhe shëndetit publik.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Rritja e evidentimit të veprave penale në fushën e narkotikëve

Rezultati 2: Normë më e lartë e goditjes së rrjeteve kryesore të trafikimit të narkotikëve dhe dënimeve të trafikantëve.

Rezultati 3: Synim i forcuar i udhëhequr nga inteligjenca përmes të dhënave të bazuara në të dhëna dhe pjesëmarrjes në EMPACT, ku Byroja Kombëtare e Hetimit është në proces aplikimi për aderim në EMPACT.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes Masave të mëposhtme:

Masa 2.1.1: Goditja në fushën e narkotikëve përmes operacioneve të zbulimit të udhëhequra nga inteligjenca dhe teknologjia, përfshirë përdorimin sistematik të inteligjencës kriminale, mjeteve analitike, kapaciteteve të mbikëqyrjes dhe veprimeve operacionale të synuara për të identifikuar, ndërprerë dhe shkatërruar rrjetet kriminale të lidhura me drogën.

Masa 2.1.2: Përditësimi dhe mirëmbajtja e bazës së veçantë të të dhënave për kultivimin e bimëve narkotike me informacion nga të gjitha burimet e mundshme të brendshme dhe të jashtme, përfshirë raportimin e autoriteteve ligjzbatuese, konstatimet e monitorimit në distancë, informacionin gjyqësor dhe kontributet e partnerëve ndërkombëtarë, për të mbështetur analizën e rrezikut, synimin dhe planifikimin operacional.

Masa 2.1.3: Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe efikasitetit me agjencitë e ligjzbatuese, si Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, BKH-ja dhe Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm, përmes aktiviteteve periodike të përbashkëta për çështje specifike, me qëllim operacionet e përbashkëta kundër krimit të organizuar që synojnë

rritjen e zbulimit, hetimit dhe ndjekjes penale të veprave penale përfshirë përmes protokolleve të bashkëpunimit, planifikimit të koordinuar operacional, dhe trajnimeve të përbashkëta.

Masa 2.1.4: Rritja e hetimeve proaktive të veprave penale në fushën e narkotikëve me qëllim parandalimin dhe goditjen e aktiviteteve kriminale, përfshirë përmes nisjes së çështjeve të bazuara në inteligjencë, zbatimit të teknikave proaktive të hetimit special dhe prioritizimit të hetimeve që synojnë organizatorët, lehtësuesit, logjistikën dhe të ardhurat nga krimi.

Masa 2.1.5: Monitorimi dhe kontrolli i territorit për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike, përfshirë përmes kontrolleve të koordinuara në terren, monitorimit ajror dhe teknologjik, planifikimit të patrullave të bazuar në rrezik dhe veprimeve të reagimit të shpejtë për identifikimin, verifikimin dhe eliminimin e zonave të dyshuara të kultivimit.

Masa 2.1.6: Forcimi i kapaciteteve dhe procedurave për shkëmbimin e informacionit mbi Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm për lëndët e reja psikotrope (NPS), me qëllim rritjen e koordinimit institucional dhe efikasitetit në identifikimin dhe përgjigjen ndaj NPS, përfshirë përmes rrugëve të qarta të raportimit, bashkëpunimit laboratorik dhe flukseve të strukturuara të informacionit me partnerët përkatës kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Masa 2.1.7: Rritja e kapaciteteve teknologjike për shkatërrimin e sigurt dhe mjedisor neutral të substancave narkotike dhe psikotrope, përfshirë përmes përmirësimit të infrastrukturës dhe pajisjeve përkatëse, zbatimit të standardeve të sigurisë dhe mjedisit dhe sigurimit të procedurave të gjurmueshme për ruajtjen, transportin dhe shkatërrimin.

Masa 2.1.8: Koordinimi dhe mbështetja e zbatimit të projektit *"Horizon Europe – Cluster 3, Civil Security for Society",* në fushën e zbulimit, identifikimit dhe gjurmimit të shpejtë dhe novator të farave dhe bimëve të kanabisit në kufirin doganor, përfshirë përmes koordinimit ndërinstitucional, testimit operacional dhe integrimit të produkteve të projektit në praktikat e kontrollit kufitar.

Masa 2.1.9: Ndryshimi i Ligjit nr. 8874, datë 29.3.2002, "Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope", me qëllim harmonizimin e plotë me *Acquis* të BE-së në këtë fushë, përfshirë harmonizimin e përkufizimeve, masave të kontrollit, përgjegjësive të mbikëqyrjes dhe dispozitave sanksionuese.

Masa 2.1.10: Identifikimi dhe trajtimi i rasteve të devijimit nga sasitë e kanabisit të mbjellë, të identifikuara përmes mbikëqyrjes dhe monitorimit të zbatimit të lejeve ose licencave, përfshirë verifikimin e vendimeve për shkatërrimin e kultivimit të paautorizuar, dhe zbatimin e sanksioneve administrative dhe/ose penale, sipas rastit.

Masa 2.1.11: Shkëmbimi informacionit të mbledhur sipas ligjit nr. 61/2023 me autoritetet përgjegjëse, me qëllim identifikimin e prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, përfshirë pastrimin e të ardhurave nga aktivitetet e paligjshme të lidhura me lëndët narkotike, duke siguruar ndjekje operacionale të koordinuar dhe referim në kohë të rasteve përkatëse.

Për të mbështetur arritjen e këtyre masave, do të zbatohen aktivitetet e mëposhtme:

Aktivitete për masën 2.1.1

- Forcimi i operacioneve të zbulimit të udhëhequra nga inteligjenca dhe teknologjia, duke kryer veprime të shënjestruara bazuar në inteligjencën kriminale, mjetet analitike dhe kapacitetet e mbikëqyrjes, me qëllim identifikimin dhe goditjen e rrjeteve të lidhura me drogën.
- Përmirësimi i efektivitetit operacional përmes instalimit, të koordinuar dhe të bazuar në rrezik, të sistemeve të zbulimit teknologjik si skanerët, dronet dhe njësitë *mobile* të mbikëqyrjes në zonat me rrezik të lartë, me qëllim mbështetjen e ndërhyrjeve proaktive.

Aktivitete për masën 2.1.2

- Përditësimi i vazhdueshëm i bazës së veçantë të të dhënave për kultivimin e bimëve narkotike, duke integruar informacion nga raportimet e autoriteteve ligjzbatuese, monitorimi në distancë, të dhënat gjyqësore dhe partnerët ndërkombëtarë.

- Përgatitja e përmbledhjeve analitike periodike nga baza e të dhënave, për të mbështetur analizën e rrezikut, planifikimin operacional dhe identifikimin e hershëm të tendencave të reja të kultivimit.

Aktivitete për masën 2.1.3

- Organizimi i takimeve periodike të koordinimit, seminareve tematike dhe sesioneve të përbashkëta të planifikimit me SPAK-un, BKH-në dhe prokurorët me juridiksion të përgjithshëm, me qëllim forcimin e bashkëpunimit operacional.

- Hartimi dhe zbatimi i protokolleve të bashkëpunimit dhe moduleve të trajnimit të përbashkëta, të cilat rrisin shkëmbimin e informacionit, hetimet e koordinuara dhe veprimet operacionale ndërinstitucionale.

Aktivitete për masën 2.1.4

- Nisja e hetimeve proaktive, të bazuara në inteligjencë, që synojnë organizatorët, lehtësuesit dhe mundësuesit logjistikë të trafikimit të narkotikëve.

- Zbatimi i teknikave të posaçme të hetimit, si dhe prioritizimi i rasteve me elemente ndërkufitare ose me të ardhura të konsiderueshme financiare, me qëllim goditjen e strukturave kriminale me vlerë të lartë.

Aktivitete për masën 2.1.5

- Kryerja e inspektimeve të koordinuara në terren dhe e patrullimeve në zonat me risk të lartë, për parandalimin dhe zbulimin e kultivimit të bimëve narkotike.

- Instalimi i mjeteve të monitorimit ajror dhe teknologjik, si dhe miratimi i mekanizmave të reagimit të shpejtë, për verifikimin dhe eliminimin e vendndodhjeve të dyshuara të kultivimit.

Aktivitete për masën ***2.1.6***

- Forcimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm, duke vendosur praktika të qarta raportimi dhe flukse të strukturuara informacioni për substancat e reja psikotrope të identifikuara.

- Përmirësimi i bashkëpunimit laboratorik dhe pjesëmarrja në shkëmbimet ndërkombëtare të EWS-së, për të siguruar identifikim në kohë, vlerësim dhe shpërndarje të sinjalizimeve për substancat e reja.

Aktivitete për masën 2.1.7

- Modernizimi i infrastrukturës, pajisjeve dhe procedurave për shkatërrimin e sigurt, të gjurmueshëm dhe në pajtim me mjedisin të substancave narkotike dhe psikotrope.

- Trajnimi i personelit të specializuar mbi protokollet e trajtimit të sigurt, ruajtjen, transportin dhe shkatërrimin, për të siguruar respektim të plotë të standardeve të sigurisë dhe mjedisit.

Aktivitete për masën 2.1.8

- Koordinimi i zbatimit kombëtar të projektit "Horizon Europe – Cluster 3", duke lehtësuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe testimin operacional të teknologjive të zbulimit në dogana.

- Integrimi i produktet e verifikuara të projektit në praktikat e kontrollit kufitar, si dhe raportimi i progresit te palët e interesuara kombëtare dhe ndërkombëtare.

Aktivitete për masën 2.1.9

- Realizimi i një analize të boshllëqeve ligjore të Ligjit nr. 8874 përkundër *Acquis* të BE-së dhe standardeve ndërkombëtare, duke identifikuar ndryshimet e kërkuara.

- Hartimi dhe konsultimi i ndryshimeve ligjore të propozuara, duke siguruar harmonizimin e përkufizimeve, masave të kontrollit, përgjegjësive të mbikëqyrjes dhe sanksioneve.

Aktivitete për masën 2.1.10

- Monitorimi i përditësimeve të BE-së për substancat e kontrolluara dhe substancat e reja psikoaktive (NPS) dhe përgatitja e propozimeve për përfshirjen në kohë të substancave të reja në planet kombëtare.

- Konsultimi me laboratorët, autoritetet shëndetësore dhe ligjzbatuese, për të konsoliduar përditësimet dhe për të siguruar shpërndarjen e listave të rishikuara.

Aktivitete për masën 2.1.11

- Miratimi i mekanizmave të strukturuar për shkëmbimin e informacionit të mbledhur sipas ligjit nr. 61/2023 me autoritetet përgjegjëse.

- Analizimi i të dhënave të ndara për identifikimin e prodhimit të paligjshëm, trafikimit dhe pastrimit të parave të lidhura me to, si dhe referimi i rasteve për ndjekje operacionale.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Numri i sekuestrimeve të narkotikëve të kryera çdo vit, sipas substancës dhe rajonit.

Produkti 2: Numri i rrjeteve të goditura të trafikimit dhe dënimeve të nivelit të lartë, në vit.

Produkti 3: Numri i operacioneve të përbashkëta të udhëhequra nga inteligjenca, të kryera me partnerët ndërkombëtarë.

Institucionet përgjegjëse: Policia e Shtetit.

Institucionet mbështetëse: Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme, Byroja Kombëtare e Hetimit, Policia e Shtetit; Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë; Ministria e Financave; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit, ISHP, AKBPM, OKD, ZSKD, QSUT, AKPB, AKKC.

Mbështetës të tjerë: Organizatat joqeveritare që veprojnë në fushën e drogave dhe shëndetit publik; EUDA;

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Numri i procedimeve për trafikim të narkotikëve dhe numri i individëve të nënshtruar procedimeve penale në vit.

Vlera bazë: 2025 – 69 procedime me 28 të pandehur;

Synimi deri në 2030: do të konfirmohet në 2026.

Objektivi Specifik 2.2: Reduktimi i ndjeshëm i trafikimit, duke rritur zbulimin, goditjen e rrjeteve kriminale dhe forcimin e kontrolleve kufitare dhe kapaciteteve hetimore

Strategjia i kushton fokus të veçantë reduktimit të kërcënimeve që rrjedhin nga aktivitetet e paligjshme në fusha të ndryshme të trafikimit, të cilat paraqesin sfida serioze për sigurinë dhe rendin publik. Këto përfshijnë trafikimin e qenieve njerëzore, një krim që cenon drejtpërdrejt të drejtat dhe dinjitetin njerëzor, si dhe ndihmën në kalimin e paligjshëm të kufirit (i njohur ndryshe si trafikimi i emigrantëve), që ka pasoja të rënda humanitare dhe ligjore. Ky fenomen trajtohet si prioritet i dedikuar në Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Personave dhe në Planit e Veprimit të saj, aktualisht në finalizim me mbështetje ndërkombëtare. Në këtë kuadër, kjo Strategji fokusohet kryesisht në dimensionin e kalimit të paligjshëm dhe trafikimit të emigrantëve të lehtësuar nga krimi i organizuar që përfshin rolin e rrjeteve të strukturuara kriminale, lehtësimin e kalimit ndërkufitar të paligjshëm, dhe flukset financiare.

Gjithashtu, Strategjia trajton trafikimin e armëve të zjarrit, municionit dhe lëndëve plasëse, fenomene që rrezikojnë sigurinë publike dhe stabilitetin në rajon. Po ashtu, rëndësi e madhe i

kushtohet luftimit të trafikimit të veprave të artit dhe pasurive kulturore, që jo vetëm përbën një humbje të madhe për trashëgiminë kombëtare, por paraqet edhe një sfidë në nivel ndërkombëtar.

Për të adresuar këto kërcënime, Strategjia parashikon zbatimin e masave dhe veprimeve të specializuara, të cilat do të jenë pjesë e planit të veprimit, duke përshkruar konkretisht metodat, përgjegjësitë dhe burimet e nevojshme për efektivitetin e tyre. Këtu përfshihet forcimi i kapaciteteve hetimore dhe operacionale të agjencive ligjzbatuese, rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, si dhe përdorimi i teknologjive moderne për monitorimin dhe luftimin e këtyre rrjeteve kriminale. Për më tepër, do të vihet theksi në rëndësinë e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik për të mbështetur përpjekjet ligjzbatuese dhe për të krijuar një mjedis më rezistent ndaj këtyre formave të krimit të organizuar. Në këtë mënyrë, strategjia synon të ndërtojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar për të minimizuar ndikimin dhe përhapjen e trafikimit të paligjshëm në të gjitha format e tij.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Rritja e konsiderueshme në identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit, në harmonizim të plotë me Direktivën 2011/36/BE.

Rezultati 2: Goditja e rrjeteve kryesore të trafikimit (qenieve njerëzore, emigrantëve, armëve të zjarrit dhe pasurive kulturore) dhe rritja e dënimeve, në mënyrë të vazhdueshme.

Rezultati 3: Rritja e evidentimit të veprave penale në fushën e trafiqeve

Ky objektiv specifik do të zbatohet përmes Masave të mëposhtme:

Masa 2.2.1: Rritja e aktivitetit hetimor për parandalimin e trafikimit të paligjshëm bazuar në inteligjencën dhe provat e disponueshme, përfshirë përmes zbatimit të metodave të posaçme hetimore, përdorimit sistematik të teknologjisë dhe mjeteve analitike, dhe një qasjeje proaktive që synon rrjetet e krimit të organizuar si dhe logjistikën, lehtësuesit dhe të ardhurat kriminale të tyre.

Masa 2.2.2: Rritja e kontrollit kufitar për parandalimin dhe luftën e trafikimit ndërkombëtar të drogës, përfshirë përmes profilizimit të bazuar në risk, kontrolleve të forcuara në pikat e kalimit kufitar, përdorimit të zgjeruar të teknologjive të zbulimit, procedurave të përmirësuara të shënjestrimit dhe veprimeve të koordinuara midis strukturave kufitare, doganore dhe hetimore.

Masa 2.2.3: Rritje e numrit dhe efektivitetit operacional të patrullave të Policisë Kufitare, me qëllim luftën e kontrabandës dhe kalimit të paligjshëm të kufirit, përfshirë përmes vendosjes të bazuar në rrezik, patrullave të intensifikuara në zonat me rrezik të lartë, koordinimit të përmirësuar me strukturat e tjera ligjzbatuese dhe përdorimit të informacionit operacional, me qëllim zbulimin dhe parandalimin e aktivitetit kriminal ndërkufitar.

Masa 2.2.4: Forcimi i bashkëpunimit me strukturat ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, përfshirë përmes shkëmbimit të informacionit, analizës së përbashkët të rrezikut dhe veprimeve operacionale të koordinuara, me qëllim parandalimin, zbulimin dhe luftën e aktivitetit kriminal në fushën e trafikimit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

Masa 2.2.5: Rritje e aktivitetit hetimor dhe operacioneve të përbashkëta të Policisë së Shtetit kundër trafikimit të armëve të zjarrit dhe municioneve, përfshirë përmes shënjestrimit të orientuar nga inteligjenca, hetimet proaktive dhe metodat e posaçme të hetimit, duke pasur mbështetjen e ligjshme në gjurmim dhe balistikë si dhe bashkëpunim të përforcuar me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Masa 2.2.6: Rritje e kontrollit kufitar për parandalimin dhe luftën kundër kontrabandës së mjeteve motorike, përfshirë përmes profilizimit të rrezikut, kontrolleve të përforcuara të mjeteve motorike dhe dokumentacionit, përdorimit përkatës të bazave kombëtare dhe ndërkombëtare të të dhënave, si edhe koordinimit ndërmjet Policisë Kufitare, doganave dhe strukturave hetimore, me qëllim zbulimin dhe referimin në kohë të rasteve.

Masa 2.2.7: Rritje e kontrollit kufitar për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit ndërkombëtar të pasurive kulturore, përfshirë përmes kontrolleve të shënjestruara në pikat kufitare, procedurave të përmirësuara të identifikimit dhe verifikimit, përdorimit të ekspertizës së specializuar dhe bazave të të dhënave dhe veprimit të koordinuar me institucionet përgjegjëse kombëtare dhe partnerët ndërkombëtarë.

Masa 2.2.8: Hartimi dhe miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit "Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme", për vitet 2026-2028.

Masa 2.2.9: Ngritja dhe vënia në funksion e databazës së Objekteve të Humbura, bazuar në procedura të standardizuara për administrimin dhe përditësimin e të dhënave.

Për të mbështetur arritjen e këtyre Masave, do të zbatohen Aktivitetet e mëposhtme:

Aktivitete për masën 2.2.1

Kryerja e hetimeve proaktive, të udhëhequra nga inteligjenca, që synojnë rrjetet e organizuara - kriminale të përfshira në trafikimin e personave, kalimin e paligjshëm të kufirit nga emigrantët, trafikimin e armëve dhe krimin ndaj pasurive kulturore, duke përdorur metoda të posaçme hetimore aty ku është e ligjshme.

- Zgjerimi i përdorimit sistematik të mjeteve analitike, kriminalistikës digjitale dhe inteligjencës operacionale, për të identifikuar zinxhirët e logjistikës, lehtësuesit, flukset financiare dhe lidhjet ndërkufitare, duke mundësuar ndërprerjen e hershme të aktivitetit kriminal.

Aktivitete për masën 2.2.2

- Forcimi i profilizimit të bazuar në rrezik dhe procedurave të shënjestrimit në pikat e kalimit kufitar, përmes përdorimit të zgjeruar të teknologjive të zbulimit, inteligjencës doganore dhe bazave të integruara të të dhënave.

- Kryerja e operacioneve të koordinuara të kontrollit kufitar midis Policisë Kufitare, Doganave dhe strukturave hetimore, për të zbuluar narkotikët e fshehur, për të goditur trafikimin dhe për të siguruar referim në kohë për hetimet.

Aktivitete për masën 2.2.3

- Dislokimi i patrullave të Policisë Kufitare bazuar në vlerësimet e rrezikut, duke u fokusuar në zonat me rrezik të lartë dhe korridoret e njohura të kontrabandës dhe trafikimit, dhe duke përdorur informacionin operacional për të udhëhequr modelet e patrullimit.

- Përmirësimi i koordinimit midis Policisë Kufitare, Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera ligjzbatuese, për të siguruar përgjigje të shpejtë, patrullime të përbashkëta dhe zbulim efektiv të aktivitetit kriminal ndërkufitar.

Aktivitete për masën 2.2.4

- Miratimi i mekanizmave të strukturuar të shkëmbimit të informacionit dhe proceseve të analizës së përbashkët të rrezikut me agjencitë vendase dhe partnerët ndërkombëtarë, për të identifikuar rrjetet e trafikimit dhe lehtësuesit ndërkufitarë.

- Kryerja e veprimeve të koordinuara operacionale, si hetime të përbashkëta, dorëzime të kontrolluara dhe operacione të njëkohshme zbatimi, me qëllim parandalimin, zbulimin dhe goditjen e rrjeteve të trafikimit të paligjshëm.

Aktivitete për masën 2.2.5

- Zbatimi i shënjestrimit bazuar në inteligjencë të rrjeteve të trafikimit të armëve, mbështetur nga hetimet proaktive, metodat e posaçme të hetimit dhe kapacitetet e zgjeruara të gjurmimit balistik.

- Forcimi i bashkëpunimit me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, përfshirë Europolin dhe platformat rajonale, për të gjurmuar armët, për të identifikuar zinxhirët e furnizimit dhe për të goditur rrjetet e organizuara të përfshira në trafikimin e armëve.

Aktivitete për masën 2.2.6

- Zbatimi i teknikave të profilizuara të rrezikut dhe kontrolleve të zgjeruara të dokumenteve dhe mjeteve motorike në pikat kufitare, duke përdorur bazat e të dhënave kombëtare dhe ndërkombëtare (si p.sh., regjistrat e mjeteve të vjedhura), për të zbuluar parregullsitë.
- Koordinimi i veprimeve midis Policisë Kufitare, Doganave dhe strukturave hetimore për të siguruar referim, sekuestrim dhe hetim në kohë të rasteve të dyshuara të trafikimit.

Aktivitete për masën 2.2.7

- Kryerja e kontrolleve të shënjestruara në pikat e kalimit kufitar, duke përdorur procedura të specializuara identifikimi, mbështetje eksperte dhe akses në bazat e të dhënave kombëtare dhe ndërkombëtare të pasurive kulturore.
- Koordinimi me institucionet përgjegjëse kombëtare dhe partnerët ndërkombëtarë, me qëllim verifikimin e autencititetit, zbulimin e lëvizjeve të paligjshme të objekteve kulturore dhe ndjekjen e shpejtë operacionale.

Aktivitete për masën 2.2.8

- Hartimi dhe miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit "Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme", për vitet 2026-2028, duke përcaktuar përgjegjësi, masa, afate kohore dhe mekanizma koordinimi të qartë midis të gjitha institucioneve përgjegjëse.
- Monitorimi periodik dhe raportimi mbi progresin e zbatimit, përfshirë vlerësimin e rezultateve operacionale, bashkëpunimit institucional dhe rreziqeve në zhvillim.

Aktivitete për masën 2.2.9

- Ngritja dhe vënia në përdorim e bazës së të dhënave të Objekteve të Humbura me procedura të standardizuara procedura për hedhjen e të dhënave, përgjegjësi institucionale për mirëmbajtjen dhe mekanizma të kontrollit të cilësisë.
- Përditësimi periodik i bazës së të dhënave dhe Regjistrit Kombëtar të Pasurive Kulturore, si dhe vendosja e kanale të shkëmbimit të informacionit me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të mbështetur identifikimin dhe rikuperimin e objekteve kulturore të vjedhura.

Institucionet përgjegjëse: Policia e Shtetit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit/Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

Institucionet mbështetëse: Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit/Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Numri i procedimeve penale të lidhura me veprat penale të trafikimit.

Vlera bazë: do të konfirmohet në vitin 2026;

Synimi deri më 2030: do të konfirmohet në vitin 2026.

Objektivi Specifik 2.3: Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë

Edhe pse Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar, krimit ekonomik dhe financiar, si dhe në parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe korrupsionit, sfidat në këto fusha mbeten të konsiderueshme dhe komplekse. Për këtë arsye, Strategjia do të vazhdojë të fokusohet në përmirësimin e vazhdueshëm të efektivitetit të politikave ekzistuese, duke synuar konsolidimin e rezultateve të arritura dhe zgjerimin e kapaciteteve në luftën kundër krimit ekonomik dhe pastrimit të parave. Për të arritur këtë qëllim do të ndërmerren masa si, forcimi i kapaciteteve institucionale dhe teknike të agjencive ligjzbatuese, rritja e bashkëpunimit

dhe koordinimit me institucionet e drejtësisë, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, si dhe krijimi i mekanizmave më të avancuar dhe novatorë për identifikimin, gjurmimin dhe konfiskimin e të ardhurave të fituara në mënyrë të paligjshme.

Për më tepër, Strategjia do të fokusohet në zhvillimin e kornizës ligjore dhe rregullatore në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare, duke mundësuar përgjigje më të shpejtë dhe më efektive ndaj fenomeneve të pastrimit të parave dhe krimit ekonomik. Do të intensifikohet edhe përdorimi i teknologjive të avancuara dhe mjeteve analitike për monitorimin e lëvizjeve të dyshimta financiare dhe për zbulimin e shfrytëzimit të sistemeve financiare për aktivitete kriminale. Rëndësi të veçantë do t'i kushtohet forcimit të kapaciteteve të personelit përmes trajnimeve të specializuara, të cilat do të rrisin aftësinë për të kryer hetime të hollësishme dhe ndjekje efektive penale të veprave penale.

Për të arritur rezultate të qëndrueshme, Strategjia parashikon thellimin e bashkëpunimit me sektorin privat dhe institucionet financiare, përfshirë bankat, institucionet e pagesave elektronike dhe subjektet e tjera financiare, për të përmirësuar mekanizmat e raportimit dhe verifikimit të transaksioneve të dyshimta. Një fokus tjetër i rëndësishëm është rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik për rreziqet dhe pasojat e krimit ekonomik dhe pastrimit të parave, me qëllim krijimin e një mjedisi më të përgjegjshëm dhe rezistent ndaj këtyre fenomeneve. Të gjitha hetimet e kryera për krimin e organizuar dhe krimet e rënda do të përfshijnë një hetim paralel financiar dhe, aty ku lejohet me ligj, edhe vendosjen e hershme të masave të sekuestrimit mbi të ardhurat e dyshuara dhe instrumentet e krimit. Kjo qasje operacionalizon parimin "ndiq paranë", pasi çdo hetim do të trajtojë si aktivitetin kriminal, ashtu edhe dimensionin e tij financiar, si dhe asetet e mundshme do të identifikohen, ruhen, menaxhohen dhe konfiskohen me shpejtësi. Për më tepër, hetimet do të kryhen në koordinim të ngushtë me autoritetet financiare, agjencitë ndërkombëtare dhe strukturat e specializuara ligjzbatuese, duke përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm dhe duke kontribuar në ndërprerjen e rrjeteve kriminale dhe parandalimin e pastrimit të parave.

Në mbështetje të këtyre objektivave, Shqipëria ka krijuar dhe vënë në përdorim Regjistrin e Pronarit Përfitues, në përputhje me standardet e BE-së dhe rekomandimet ndërkombëtare të FATF-së, në lidhje me transparencën e pronësisë përfituese të personave juridikë (Rekomandimi 24) dhe rregullimeve juridike (rekomandimi 25).

Regjistri është publikisht i aksesueshëm përmes QKB-së, ndërsa autoritetet kompetente, përfshirë organet mbikëqyrëse, hetuese dhe Agjencinë e Inteligjencës Financiare, disponojnë akses të zgjeruar për qëllime verifikimi dhe hetimi. Në këtë kuadër, mbetet e rëndësishme forcimi i vazhdueshëm i mekanizmave të verifikimit dhe cilësisë së të dhënave, me qëllim garantimin e saktësisë, përditësimit dhe përdorimit efektiv të informacionit mbi pronarin përfitues.

Fokus i veçantë do t'u kushtohet produkteve të krimit mjedisor, si një kategori e veçantë brenda kornizës kombëtare për parandalimin e pastrimit të parave, përfshirë identifikimin, monitorimin dhe trajtimin e aseteve të fituara nga aktivitete që dëmtojnë mjedisin, si trafikimi i mbetjeve të rrezikshme, shpyllëzimi i paligjshëm, ndotja e ujit dhe tregtia e paligjshme e specieve të mbrojtura. Ky fokus siguron që mekanizmat ligjorë dhe financiarë të jenë të mirëpajisur për ndjekjen dhe konfiskimin e pasurive të përftuara nga këto krime, duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e fitimeve të paligjshme, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare për parandalimin e pastrimit të parave.

Kjo Strategji rithekson qartë garancitë për mbrojtjen dhe integritetin e të dhënave në të gjitha hetimet financiare dhe proceset e rikuperimit të aseteve, duke siguruar që masat zbatuese të jenë plotësisht në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut përmes këtyre hapave:

- Të gjitha hetimet financiare dhe masat e konfiskimit do të kryhen në përputhje me garancitë e procesit të rregullt ligjor, përfshirë prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën e rishikimit efektiv gjyqësor;

- Standardet e mbrojtjes së të dhënave dhe konfidencialitetit do të zbatohen në mënyrë konsistente në mbledhjen, shkëmbimin dhe analizën e inteligjencës financiare, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare;

- Përfshirja e mbrojtjes për sinjalizuesit që janë punonjës të subjekteve raportuese dhe zyrtarët publikë që raportojnë dyshimet e korrupsionit, pastrimit të parave ose keqpërdorimit të burimeve publike.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Rritja e zbulimit dhe ndjekjes penale të veprave penale të pastrimit të parave dhe financiare.

Rezultati 2: Përqindje më e lartë e çështjeve kryesore të krimit që përfshijnë hetim paralel financiar.

Rezultati 3: Koordinim i përmirësuar ndërinstitucional midis agjencive ligjzbatuese dhe rregullatorëve financiarë.

Ky objektiv specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme:

Masa 2.3.1: Forcimi i luftës kundër pastrimit të parave përmes një qasjeje të udhëhequr nga inteligjenca, duke u mbështetur në hetim proaktiv, analizë të thelluar të riskut dhe bashkëpunim të ngushtë me prokurorinë, me qëllim përmirësimin e zbulimit, hetimit dhe ndjekjes penale të pastrimit të parave si vepër autonome dhe si komponent paralel i hetimeve të krimit të organizuar.

Masa 2.3.2: Shkëmbimi i informacionit nga Agjencia e Inteligjencës Financiare me agjencitë ligjzbatuese dhe ato të inteligjencës, në kuadër të zbatimit të fushës së saj të veprimtarisë.

Masa 2.3.3: Kryerja e inspektimeve të bazuara në risk për subjektet e ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, i ndryshuar.

Masa 2.3.4: Kryerja e Vlerësimit Kombëtar të Riskut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, përfshirë duke mbledhur dhe analizuar të dhënat sasiore dhe cilësore nga autoritetet përgjegjëse dhe subjektet e detyruara, duke identifikuar dhe prioritizuar risqet sektoriale dhe tematike, si dhe duke shndërruar konstatimet në masa zbutëse të koordinuara dhe në prioritete politikash.

Masa 2.3.5: Trajnime për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit të organeve ligjzbatuesve, gjyqtarëve, prokurorëve dhe të inteligjencës për rreziqet e pastrimit të parave, me tematika të lidhura me rrezikun e mbledhjes, lëvizjes së fondeve të Shqipërisë, përdorimin e fondeve për territorin e Shqipërisë, përdorimin e personave juridik, strukturave komplekse, profesionistëve, për pastrimin e parave si vepër autonome, risku nga keqpërdorimi i OJF-së, financimin e terrorizmit (përfshirë edhe atë të lidhur me tregtinë apo forma të tjera të mundshme etj.).

Masa 2.3.6: Rritja e kapaciteteve të specializuara qendrore dhe vendore për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar, përmes integrimit të metodave novatore hetimore, mbështetjes teknologjike, menaxhimit të përmirësuar të burimeve, si dhe një plani të integruar trajnimi midis strukturave policore dhe aktorëve të tjerë shtetërorë që kontribuojnë në hetimin dhe ndjekjen penale.

Masa 2.3.7: Konsolidimi i praktikave për zbatimin e njëkohshëm të hetimeve financiare paralele me hetimet për vepra penale të krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, me qëllim identifikimin, gjurmim, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave, pasurive dhe mjeteve kriminale në kohë dhe në mënyrë të koordinuar.

Masa 2.3.8: Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional për trajtimin e korrupsionit në të gjitha format dhe nivelet e tij, përfshirë përmes punës së koordinuar në trajtimin e çështjeve, shkëmbimit të informacionit, produkteve të përbashkëta analitike dhe protokolleve të forcuara të bashkëpunimit midis institucioneve hetimore, mbikëqyrëse dhe të prokurorisë.

Masa 2.3.9: Rritja e kërkesave për hetime paralele dhe të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë, përmes veprimeve hetimore proaktive, të mbështetura nga analiza e tendencave më të fundit kriminale, në fushën e krimit ekonomik dhe aseteve të përftuara në mënyrë të paligjshme në Shqipëri dhe jashtë vendit, si dhe me qëllim forcimin e gjurmimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve ndërkufitare.

Masa 2.3.10: Trajtimi i krimit ekonomik dhe mashtrimit financiar përmes hetimeve proaktive, përfshirë përmes përzgjedhjes së çështjeve të udhëhequr nga inteligjenca, zbatimit të teknikave të posaçme të hetimit, aty ku lejohet me ligj, forcimit të kapaciteteve të kontabilitetit kriminalistik dhe gjurmimit digjital, si dhe prioritizimit të çështjeve me ndikim të lartë dhe të ardhura të konsiderueshme kriminale.

Masa 2.3.11: Zgjerimi i aksesit dhe verifikimit *online* në bazat e të dhënave, për qëllime të verifikimeve paraprake dhe hetimeve në fushën ekonomiko-financiare, përfshirë duke forcuar ndërveprueshmërinë, duke përmirësuar procedurat e aksesit të ligjshëm dhe duke mundësuar verifikim në kohë të informacionit të nevojshëm për analizën e riskut dhe zhvillimin e çështjes.

Masa 2.3.12: Rritja e sekuestrimeve dhe konfiskimeve të pasurive që kanë prejardhje kriminale mbështetur në hetime thelluara.

Masa 2.3.13: Inicimi i procesit të vlerësimit për ngritjen e një Task-Force *ad hoch* të specializuar për Pastrimin e Parave në fushën e Pronave të Paluajtshme për ndërgjegjësim dhe kontroll të forcuar mbi profesionet e lira dhe kategorive të caktuara të bizneseve dhe profesioneve jofinanciare, duke përfshirë avokatët, agjentët e pasurive të paluajtshme, kontabilistët etj.

Për të mbështetur arritjen e këtyre Masave, do të zbatohen aktivitetet e mëposhtme:

Aktivitete për masën 2.3.1

- Kryerja e hetimeve proaktive për pastrimin e parave, duke u udhëhequr nga inteligjenca dhe duke përdorur analizë të thelluar financiare, modele transaksionesh të dyshimta dhe inteligjencë ndërinstitucionale, për të zbuluar pastrimin e parave si vepër autonome dhe si komponent paralel i çështjeve të krimit të organizuar.
- Forcimi i bashkëpunimit me organin e akuzës përmes takimeve të përbashkëta të përzgjedhjes së çështjeve, planeve të koordinuara hetimore dhe zbatimit të hershëm të masave të sekuestrimit për të ruajtur të ardhurat kriminale.

Aktivitete për masën 2.3.2

- Dërgimi i informacioneve midis Agjencisë së Inteligjencës Financiare dhe organeve ligjzbatuese, që janë të sigurta dhe shkëmbejnë informacion në një kohë sa më të shpejtë.
- Zbatimi i mekanizmave të strukturuar të reagimit, për të përmirësuar cilësinë e raporteve të transaksioneve të dyshimta dhe për të rritur rëndësinë e inteligjencës financiare për hetimet proaktive.

Aktivitete për masën 2.3.3

- Kryerja e inspektimeve të bazuara në rrezik duke përdorur tregues specifikë sektorialë të rrezikut, duke prioritizuar subjektet me rrezik të lartë dhe në varësi të ndryshimeve/dinamizmit të riskut mbajtja në vëmendje të veçantë edhe e sektorëve/subjekteve me risk të mesëm si agjentët e pasurive të paluajtshme, kontabilistët, kazinotë dhe bizneset e shërbimeve monetare.

- Ndjekja e vazhdueshme e zbatimit të rekomandimeve, përmes planeve për veprime korrigjuese dhe sanksioneve, aty ku është e përshtatshme, si dhe monitorimit të përmirësimeve të pajtueshmërisë me kalimin e kohës.

Aktivitete për masën 2.3.4

- Mbledhja dhe analizimi i të dhënave sasiore dhe cilësore nga autoritetet përgjegjëse dhe subjektet e detyruara, për të identifikuar risqet sektoriale dhe tematike të pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit.
- Shndërrimi i konstatimeve të Vlerësimit Kombëtar të Riskut për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit në masa zbutëse të koordinuara, politika të përditësuara dhe veprime operacionale të prioritizuara në të gjitha institucionet përkatëse.

Aktivitete për masën 2.3.5

- Ofrimi i trajnimeve të specializuara mbi tipologjitë e pastrimit të parave, qarkullimin ndërkufitar të fondeve, keqpërdorimin e personave juridikë, strukturat komplekse të pronësisë dhe financimin e terrorizmit (përfshirë edhe atë të lidhur me tregtinë apo forma të tjera të mundshme etj.).
- Ofrimi i moduleve të posaçme mbi risqet e keqpërdorimit të OJF-ve, profesioneve me rrezik të lartë dhe teknologjive financiare në zhvillim, duke siguruar harmonizim me standardet FATF-së.

Aktivitete për masën 2.3.6

- Integrimi i metodave hetimore novatore, si mjetet kriminalistike e digjitale, kontabilitetin kriminalistik dhe analitikën e avancuar, në strukturat hetimore qendrore dhe vendore.
- Zbatimi i një plani trajnimi të koordinuar midis policisë, autoriteteve tatimore, doganave dhe prokurorëve, me qëllim forcimin e kapaciteteve të përbashkëta hetimore.

Aktivitete për masën 2.3.7

- Zbatimi sistematik i hetimeve paralele financiare në të gjitha çështjet kryesore të krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, me qëllim identifikimin, gjurmimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave kriminale.
- Zbatimi i procedurave standarde operacionale dhe protokolleve të përbashkëta operacionale, për të siguruar nisje të hershme të hetimit financiar dhe veprime të koordinuara të gjurmimit të aseteve.

Aktivitete për masën 2.3.8

- Koordinimi i punës me çështjet dhe produktet e përbashkëta analitike, midis institucioneve hetimore, mbikëqyrëse dhe të prokurorisë, me qëllim evidentimin e modeleve të korrupsionit dhe sektorët me rrezik të lartë.
- Forcimi i protokolleve të bashkëpunimit dhe mekanizmave të shkëmbimit të informacionit, për të siguruar referim në kohë, hetim të përbashkët dhe ndjekje konsistente të çështjeve të korrupsionit.

Aktivitete për masën 2.3.9

- Nisja e hetimeve paralele dhe të përbashkëta me autoritetet e huaja, bazuar në tendencat në zhvillim kriminal, flukset financiare ndërkufitare dhe inteligjencën mbi asetet e mbajtura jashtë vendit.
- Forcimi i gjurmimit, sekuestrimit dhe konfiskimit ndërkufitar të aseteve, përmes bashkëpunimit të zgjeruar me Europolin, Njësitë e Inteligjencës Financiare (NjIF-të) dhe rrjetet ndërkombëtare të hetimit financiar.

Aktivitete për masën 2.3.10

- Zhvillimi i proceseve të përzgjedhjes së çështjeve, të udhëhequra nga inteligjenca, me qëllim që të prioritizohen çështjet e krimit ekonomik me ndikim të lartë, të cilat përfshijnë të ardhura të rëndësishme ose cenueshmëri sistemike.

- Zbatimi i teknikave të posaçme të hetimit, forcimi i kapaciteteve të kontabilitetit kriminalistik dhe zgjerimi i mjeteve të gjurmimit digjital, me qëllim zbulimin e skemave komplekse të mashtrimit.

Aktivitete për masën 2.3.11

- Forcimi i ndërveprueshmërisë dhe i procedurave të aksesit të ligjshëm në bazat kryesore të të dhënave që përdoren në hetimet ekonomiko-financiare, duke mundësuar verifikim të shpejtë të pronësisë, transaksioneve dhe treguesve të rrezikut.

- Ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes teknike për hetuesit, që të sigurojnë përdorim konsistent dhe efektiv të mjeteve të verifikimit *online* për zhvillimin e çështjes.

Aktivitete për masën 2.3.12

- Përmirësimi i metodologjive të gjurmimit të aseteve, zhvillimit të provave dhe koordinimit me prokurorët, për të mbështetur sekuestrimin dhe konfiskimin në kohë të të ardhurave kriminale.

- Forcimi i bashkëpunimit me strukturat e menaxhimit të aseteve, për të siguruar trajtim të duhur, vlerësim dhe asgjësim të aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Aktivitete për masën 2.3.13

- Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të cenueshmërive sektoriale në sektorin e pasurive të paluajtshme, profesionet e lira dhe bizneset jofinanciare për të përcaktuar nevojën dhe strukturën e një Task-Force të specializuar kundër pastrimit të parave.

- Hartimi i propozimeve për forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe kontrollit për profesionet dhe sektorët e identifikuar me risk të lartë ndaj pastrimit të parave, sipas gjetjeve të Vlerësimit Kombëtar të Riskut për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, por duke mbajtur në vëmendje të veçantë edhe sektorët me risk të mesëm (si p.sh.) ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme, kontabilistët dhe profesionet e tjera relevante), me qëllim përmirësimin e zbulimit dhe raportimit të aktiviteteve të dyshimta.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Numri i hetimeve të krimit financiar të nisura dhe i çështjeve të dërguara në ndjekje penale.

Produkti 2: Numri i operacioneve të gjurmimit të aseteve dhe vlera e aseteve të gjurmuara.

Produkti 3: Numri i oficerëve/zyrtarëve të trajnuar në hetimin e krimit financiar.

Institucionet përgjegjëse: Policia e Shtetit, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Inteligjencës Financiare.

Institucionet mbështetëse: Prokuroria e Përgjithshme; Byroja Kombëtare e Hetimit; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Agjencia e Inteligjencës Financiare; Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e Shtetit; Agjencia e Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Ministria e Drejtësisë, Banka e Shqipërisë, Shërbimi Informativ i Shtetit, Agjencia për Inteligjencën dhe Sigurinë e Mbrojtjes; Banka e Shqipërisë, Qendra Kombëtare e Biznesit, Dhoma Kombëtare e Avokatisë e Shqipërisë;

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Numri i referimeve dhe procedimeve për veprat penale të korrupsionit dhe pastrimit të parave.

Vlera bazë: do të konfirmohet në vitin 2026;

Synimi deri më 2030: do të konfirmohet në vitin 2026.

Objektivi Specifik 2.4: Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik, përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

Si përgjigje ndaj sfidave të shumta që paraqet zhvillimi i shpejtë teknologjik, si dhe duke u përballur me krimet kibernetike që shfrytëzojnë këto përparime për të dëmtuar rendin dhe parimet demokratike, autoritetet ligjzbatuese duhet të jenë të përgatitura dhe të kenë kapacitetet e nevojshme për të mbrojtur sigurinë kombëtare dhe rendin publik. Kjo kërkon zhvillimin dhe forcimin e aftësive teknike, ligjore dhe operacionale, si dhe investimin e vazhdueshëm në teknologji moderne dhe trajnim të specializuar për personelin e tyre.

Për më tepër, një nga objektivat kryesorë është krijimi dhe përcjellja te qytetarët e ndjenjës së besimit dhe sigurisë në hapësirën kibernetike, ku të drejtat digjitale dhe privatësia mbrohen në mënyrë efektive. Kjo është jetësore për ndërtimin e një mjedisi *online* të sigurt dhe të qëndrueshëm, ku zhvillimi teknologjik shërben si faktor për progresin dhe jo si kërcënim për sigurinë dhe rendin demokratik.

Për të arritur këto objektiva, qasja strategjike bazohet në zbatimin e një sërë masash, përfshirë forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, ndërtimin e kapaciteteve për hetime të avancuara kibernetike, hartimin e legjislacionit modern dhe përmirësimin e infrastrukturës teknologjike, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimin e qytetarëve për rreziqet dhe masat e sigurisë në botën digjitale.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Operacionalizim i përmirësuar dhe i plotë i kapacitetit të specializuar të hetimit dhe ndjekjes penale të krimit kibernetik.

Rezultati 2: Rritje e zbulimit dhe ndjekjes penale të veprave të krimit kibernetik.

Rezultati 3: Kapacitet i përmirësuar në mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe në kundërpërgjigjen ndaj kërcënimeve kibernetike.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme:

Masa 2.4.1: Forcimi kapaciteteve hetimore, operacionale dhe teknologjike për trajtimin e krimit kibernetik, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve për analizën digjitale dhe kriminalistikën digjitale, si dhe duke përdorur mjete moderne dhe platformave për të mbështetur zbulimin, hetimin dhe dokumentimin e krimit kibernetik.

Masa 2.4.2: Hartimi dhe zbatimi i programeve edukative dhe ndërgjegjësuese për qytetarët dhe bizneset mbi rreziqet kibernetike dhe masat mbrojtëse, përfshirë udhëzime për sjelljen e sigurt *online*, higjienën bazë kibernetike, rrugët e raportimit dhe masat parandaluese për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aseteve digjitale.

Masa 2.4.3: Trajtimi efektiv dhe i qëndrueshëm i të gjitha formave të krimit kibernetik, përmes realizimit të hetimeve proaktive, përfshirë përdorimin e inteligjencës digjitale dhe metodave të avancuara teknologjike hetimore, me qëllim parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e aktiviteteve kriminale në hapësirën kibernetike.

Masa 2.4.4: Ofrimi i trajnimit të vazhdueshëm për të përditësuar njohuritë dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional, përfshirë trajnime të specializuara, përdorimin e softuerëve modernë dhe mjeteve hetimore, si dhe trajnime të përbashkëta me agjencitë ligjzbatuese, me fokus të veçantë te gjurmimi i aktiviteteve të paligjshme që përfshijnë kriptovalutat, hetimi i krimit kibernetik dhe identifikimi i grupeve kriminale që veprojnë *online*.

Masa 2.4.5: Rritja e bashkëpunimit me institucionet publike, subjektet private dhe partnerët ndërkombëtarë për trajtimin e shpejtë dhe të saktë të rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve *online*,

përfshirë identifikimin dhe prioritizimin e rasteve urgjente, si dhe analizën efektive të provave në mbështetje të hetimit dhe ndjekjes penale.

Masa 2.4.6: Hartimi dhe zbatimi i programeve edukative dhe ndërgjegjësuese për fëmijët mbi sigurinë në internet dhe mbrojtjen nga rreziqet kibernetike, si dhe ofrimi i trajnimit të vazhdueshëm të përbashkët për punonjësit e policisë dhe aktorët vendore të vijës së parë, mbi tendencat në zhvillim të krimit kibernetik, dëmet *online* dhe procedurat e duhura të reagimit dhe referimit.

Masa 2.4.7: Krijimi dhe aktivizimi i kapaciteteve teknike dhe teknologjike për të monitoruar *Dark Web*-in, me qëllim forcimin e parandalimit dhe zbulimit e hershëm të krimeve kibernetike, përfshirë përmes mjeteve të dedikuara, personelit të trajnuar dhe procedurave për mbledhjen e inteligjencës dhe ndjekjen operacionale.

Masa 2.4.8: Forcimi i rrjeteve të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimit të informacionit në luftën kundër krimit kibernetik, përmes pikave të kontaktit 24/7, me qëllim sigurimin e asistencës në kohë, shkëmbim të shpejtë të informacionit dhe përgjigje të koordinuara operacionale ndaj incidenteve dhe hetimeve kibernetike ndërkufitare.

Masa 2.4.9: Standardizimi dhe optimizimi i procedurave për funksionim efektiv të pikës së kontaktit 24/7, përfshirë duke sqaruar rolet dhe përgjegjësitë, duke vendosur afatet kohore të reagimit, duke siguruar komunikim dhe dokumentim të sigurt dhe duke miratuar mekanizma të sigurimit të cilësisë për kërkesat dhe shkëmbimet e lidhura me krimin kibernetik.

Masa 2.4.10: Forcimi i bashkëpunimit me institucionet publike, OJF-të, ofruesit e shërbimeve të internetit, kompanitë telefonike dhe organizatat globale për të siguruar akses në kohë dhe informacion në kohë reale, aty ku është përshtatshme, si dhe për të parandaluar aktivitetet kriminale në hapësirën kibernetike, përfshirë përmes koordinimit operacional, procedurave të thjeshtuara të ruajtjes dhe dhënies së informacionit, si dhe ndërgjegjësimit dhe masave parandaluese të përbashkëta.

Masa 2.4.11: Pjesëmarrja në projektet e BE-së dhe të tjera ndërkombëtare që mbështesin raportimin dhe mbrojtjen e të miturve dhe qytetarëve nga abuzimi *online*, duke shfrytëzuar nismat ekzistuese dhe duke ndjekur pjesëmarrjen në platformat e reja të raportimit si "Help4U", përmes organizimit të takimeve, pjesëmarrjes aktive në aktivitetet e projektit, dhe ndjekjes së procedurave të aplikimit.

Masa 2.4.12: Propozimi i ndryshimeve nënligjore për të siguruar mbështetje të qëndrueshme financiare për kapacitetet hetimore të krimit kibernetik, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së strukturave të specializuara, mirëmbajtjes dhe modernizimit të mjeteve teknologjike, dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të kapaciteteve të krimit kibernetik brenda strukturave të Policisë së Shtetit.

Për të mbështetur arritjen e këtyre Masave, do të zbatohen Aktivitetet e mëposhtme:

Aktivitete për masën 2.4.1

- Zhvillimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të kriminalistikës digjitale dhe analizës kibernetike, duke pajisur njësitë e specializuara me mjete moderne për nxjerrjen e të dhënave, analizën e maluerëve, kriminalistikën e rrjetit dhe ruajtjen e provave.
- Zbatimi i punës së strukturuar operacionale për hetimin e krimit kibernetik, duke përdorur platforma të avancuara për zbulimin, dokumentimin dhe gjetjen e autorëve të incidenteve kibernetike.

Aktivitete për masën 2.4.2

- Përgatitja dhe ofrimi i fushatave të ndërgjegjësimit në të gjithë vendin, për qytetarët dhe bizneset, mbi rreziqet kibernetike, sjelljen e sigurt *online*, higjienën kibernetike dhe rrugët e raportimit për incidentet kibernetike.

- Hartimi i materialeve praktike udhëzuese, si listat e kontrollit, tutorialet dhe këshillat specifike sektoriale, për të ndihmuar individët dhe bizneset të mbrojnë të dhënat personale dhe asetet digjitale.

Aktivitete për masën 2.4.3

- Kryerja e hetimeve proaktive të krimit kibernetik, duke përdorur inteligjencën digjitale, inteligjencën nga burime të hapura (OSINT) dhe mjete të avancuara teknologjike, për të zbuluar aktivitetin kriminal në hapësirën kibernetike.
- Zbatimi i teknikave të specializuara hetimore, si monitorimi i rrjetit, gjurmimi i kriptovalutave dhe operacionet e fshehta *online*, aty ku lejohet me ligj, me qëllim parandalimin dhe ndërprerjen e veprimeve penale kibernetike.

Aktivitete për masën 2.4.4

- Ofrimi i programeve të specializuara të trajnimit për policët, prokurorët dhe zyrtarët e inteligjencës, mbi hetimin e krimit kibernetik, gjurmimin e kriptovalutave, trajtimin e provave digjitale dhe tendencat e reja të krimit *online*.
- Organizimi i ushtrimeve trajnuese të përbashkëta me agjencitë ligjzbatuese vendase dhe ndërkombëtare, me qëllim përmirësimin e koordinimit operacional dhe kuptimin e përbashkët të kërcënimeve kibernetike.

Aktivitete për masën 2.4.5

- Vendosja e procedurave të reagimit të shpejtë me institucionet publike, subjektet private dhe partnerët ndërkombëtarë, për të siguruar identifikim, prioritizim dhe hetim në kohë të materialit të abuzimit seksual *online* të fëmijëve.
- Forcimi i kapacitetit të kriminalistikës digjitale për të analizuar provat në mënyrë efikase dhe për të mbështetur ndjekjet penale, përfshirë përmes mjeteve të specializuara dhe personelit të trajnuar.

Aktivitete për masën 2.4.6

- Zbatimi i programeve edukative të përshtatshme për moshën në shkolla dhe qendra komunitare, me qëllim që fëmijët të mësojnë mbi sigurinë *online*, rreziqet kibernetike dhe sjelljen e përgjegjshme digjitale.
- Ofrimi i trajnimit të vazhdueshëm të përbashkët për oficerët e policisë, mësuesit dhe aktorët vendorë në vijën e parë, mbi dëmet e aktivitetit *online*, procedurat e referimit dhe protokollet e mbrojtjes së fëmijëve.

Aktivitete për masën 2.4.7

- Alokimi i kapaciteteve të dedikuara për monitorimin e *DarWeb*-it, përfshirë mjete të specializuara, analistë të trajnuar dhe procedura operacionale për mbledhjen e inteligjencës dhe zbulimin e hershëm të krimit kibernetik.
- Integrimi i inteligjencës së *Dark Web*-it në praktikën hetimore, për të mbështetur zhvillimin e çështjes, vlerësimet e kërcënimit dhe ndjekjen operacionale.

Aktivitete për masën 2.4.8

- Mbajtja e bashkëpunimit aktiv 24/7 me pikat e kontaktit të partnerëve ndërkombëtarë, për të siguruar shkëmbim të shpejtë informacioni, asistencë në kohë dhe përgjigje të koordinuara ndaj incidenteve kibernetike ndërkufitare.
- Pjesëmarrja në platformat e koordinimit ndërkombëtar të krimit kibernetik, operacionet e përbashkëta dhe nismat e shkëmbimit të inteligjencës për të rritur kapacitetin hetimor ndërkufitar.

Aktivitete për masën 2.4.9

- Hartimi dhe zbatimi i procedurave standarde operacionale që përcaktojnë rolet, përgjegjësitë, afatet kohore të reagimit dhe kërkesat e dokumentimit për të gjitha operacionet e pikave të kontaktit 24/7.

- Miratimi i mekanizmave të sigurimit të cilësisë, që garantojnë komunikim të sigurt, përpunim të saktë të kërkesave dhe ndjekje konsistente të shkëmbimeve ndërkombëtare.

Aktivitete për masën 2.4.10

- Thjeshtimi i procedurave për ruajtjen e të dhënave, zbulimin e ligjshëm të informacionit dhe koordinimin operacional me ofruesit e shërbimeve të internetit, operatorët e telekomunikimit dhe platformat *online*, për të mbështetur hetimet e krimit kibernetik.

- Realizimi i nismave të përbashkëta të ndërgjegjësimit dhe parandalimit me OJF-të, institucionet publike dhe partnerët e sektorit privat, me qëllim reduktimin e rreziqeve *online* dhe përmirësimin e raportimit të hershëm.

Aktivitete për masën 2.4.11

- Angazhimi aktiv në nismat e BE-së dhe ato ndërkombëtare, si "Help4U" dhe platformat e ngjashme, duke marrë pjesë në takimet e projektit, aktivitetet pilote dhe proceset e aplikimit.

- Integrimi i produkteve të projektit në mekanizmat kombëtarë të raportimit dhe mbrojtjes, për të rritur sigurinë *online* të të miturve dhe të grupeve të cenueshme.

Aktivitete për masën 2.4.12

- Realizimi i vlerësimit institucional të nevojave afatgjata financiare për njësitë hetimore të krimit kibernetik, përfshirë personelin, mjetet dhe mirëmbajtjen.

- Hartimi dhe propozimi i ndryshimeve nënligjore për të siguruar financim të qëndrueshëm për strukturat e specializuara të krimit kibernetik dhe modernizime të vazhdueshme teknologjike.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Progresi i modernizimit të infrastrukturës laboratorike të IPSh dhe statusi i akreditimit ISO.

Produkti 2: Numri i testeve kriminalistike të kompletuara dhe koha mesatare e përpunimit të çështjes.

Produkti 3: Numri i specialistëve kriminalistikë të trajnuar dhe akredituar.

Institucionet përgjegjëse: Policia e Shtetit.

Institucionet mbështetëse: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Posaçme, Byroja Kombëtare e Hetimit, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Shërbimi Informativ i Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Banka e Shqipërisë, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Arsimit; Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike;

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Numri i çështjeve penale që lidhen me krimin kibernetik dhe numri i personave të dërguar për gjykim.

Vlera bazë: Viti 2025: Prokuroria e Përgjithshme: Nr. total i procedimeve të regjistruara: 206; Nr. total i procedimeve të dërguara në gjykatë: 17; Nr. total i të pandehurve të regjistruar: 29; Nr. total i të pandehurve të dërguar në gjykatë: 24. *(Nenet: 74/a; 84/a; 119/a; 119/b; 143/b; 186/a; 192/b; 293/a; 293/b; 293/c; 293/ç);

Synimi deri më 2030: Do të konfirmohet në vitin 2026.

Objektivi Specifik 2.5: Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave

Planifikimi strategjik për të pasur shërbim kriminalistik të akredituar dhe të fortë përbën një komponent kyç në garantimin e integritetit të provave brenda sistemit të drejtësisë penale. Kjo

qasje bazohet në zbatimin rigoroz të standardeve ndërkombëtare të akreditimit, si ISO 17025, duke siguruar kompetencë teknike, paanshmëri dhe besueshmëri të analizave kriminalistike. Një strukturë e tillë përforcon transparencën institucionale dhe forcon zinxhirin e ruajtjes, duke kontribuar drejtpërdrejt në legjitimitetin e vendimmarrjes gjyqësore dhe forcimin e sundimit të ligjit.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: IPSh plotësisht i modernizuar me disiplina kriminalistike të zgjeruara dhe akreditim ISO.

Rezultati 2: Reduktim i çështjeve kriminalistike të prapambetura dhe afate më të shpejta të finalizimit të çështjes.

Rezultati 3: Cilësi dhe pranueshmëri e përmirësuar e provave kriminalistike në ndjekjet penale.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes Masave të mëposhtme:

Masa 2.5.1: Miratimi i projektvendimit "Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Policisë Shkencore" dhe hartimi i një plani veprimi bazuar në vendimin e miratuar, ku përcaktohen përgjegjësitë, afatet kohore, burimet dhe modalitetet e monitorimit për të siguruar zbatim efektiv të reformës.

Masa 2.5.2: Miratimi një plani të detajuar për sistemimin e strukturës së Policisë Shkencore në ambientet e reja, përfshirë planifikimin e hapësirës, zonimin funksional të laboratorëve dhe zonave të provave, kërkesat e sigurisë, masat e sigurisë në punë, afatet kohore të zhvendosjes në faza dhe modalitetet e vazhdimësisë së punës, për të shmangur ndërprerjen e shërbimeve kriminalistike.

Masa 2.5.3: Zbatimi i standardeve minimale të cilësisë për hetimet në vendin e ngjarjes dhe për administrimin e provave nga vendi i ngjarjes deri në sallën e gjyqit, përfshirë procedurat standarde operacionale për sigurimin, dokumentimin, mbledhjen, paketimin, transportimin, ruajtjen, ekzaminimin dhe paraqitjen e provave, me qëllim garantimin e integritetit, gjurmueshmërisë dhe pranueshmërisë së provave.

Masa 2.5.4: Krijimi dhe sigurimi i funksionimit të bazave të të dhënave për administrimit të të dhënave të ADN-së dhe daktiloskopike, në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", përfshirë duke përcaktuar qëllimet e ligjshme të përpunimit, kontrollet e aksesit, rregullat e ruajtjes, gjurmët e auditimit dhe garancitë e sigurisë së të dhënave për të mbrojtur të dhënat personale, ndërsa mundësohet krahasimi efektiv kriminalistik.

Masa 2.5.5: Rishikimi dhe përditësimi i programit fillestar dhe të vazhdueshëm të trajnimit për oficerët e Policisë Shkencore dhe personelin civil të Institutit të Policisë Shkencore, përfshirë vlerësimet e nevojave, përditësimin e kurrikulës, kërkesat e certifikimit/kompetencës dhe modulet praktike të harmonizuara me standardet ISO dhe metodat e reja kriminalistike.

Masa 2.5.6: Mundësimi i shkëmbimit me partnerët të të dhënave të automatizuara në fushën e të dhënave të ADN-së dhe daktiloskopike, në bazë të dispozitave të Marrëveshjes PCC Prum, duke siguruar ndërveprueshmëri teknike, kanale të sigurta komunikimi, procedura të standardizuara të kërkimit dhe ndjekjes, si dhe pasjtueshmërinë me kërkesat e mbrojtjes së të dhënave.

Masa 2.5.7: Arritja e akreditimit të shërbimeve të ofruara nga Instituti i Policisë Shkencore sipas standardeve ISO, i zbatuar në faza, duke prioritizuar disiplinat shkencore me ndikim të lartë, duke kryer auditimet e brendshme, duke adresuar mospërputhjet (identifikimi, dokumentimi, vlerësimi dhe korrigjimi i devijimeve nga standardet e cilësisë së vendosur) dhe duke siguruar përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë.

Masa 2.5.8: Hartimi një plani të dedikuar për zbatimin e metodave novatore në shkencat kriminalistike në luftën kundër krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera kriminale, përfshirë

identifikimin e metodave prioritare, pajisjeve dhe trajnimit të kërkuar, procedurat e validimit dhe integrimin në flukset operacionale të punës.

Masa 2.5.9: Mbështetja dhe forcimi i kapaciteteve për procesin e menaxhimit të cilësisë në nivel rajonal të hetimit të vendngjarjes dhe në nivel qendror, përfshirë përmes procedurave të harmonizuara, mentorimit, kontrolleve të brendshme dhe rishikimeve periodike të cilësisë për të siguruar zbatim konsistent të standardeve në të gjithë vendin.

Masa 2.5.10: Ngritja dhe mirëmbajtja e një regjistri për inventarin e pajisjeve kriminalistike duke identifikuar sistematikisht nevojat për kalibrim, mirëmbajtje, rinovim ose zëvendësim të tyre, përfshirë duke vendosur afate, caktuar përgjegjësi dhe siguruar gjurmueshmërinë e ndërhyrjeve për të mbrojtur besueshmërinë e rezultateve kriminalistike.

- Ndjekja proaktive e çështjeve me autoritetet partnere për verifikimin, përditësimin dhe mbajtjen e të dhënave të sakta të shtetasve shqiptarë të shpallur në kërkim ndërkombëtar.
- Mbështetja e procedurave të ekstradimit, duke ofruar në kohë dokumentacionin e kërkuar, sqarimet ligjore dhe asistencën operacione për autoritetet e huaja, për të garantuar ekzekutim të shpejtë të urdhrave ndërkombëtarë të arrestit.

Aktivitete për masën 2.9.4

- Mbajtja dhe përditësimi periodik i të dhënave të identitetit, fotografive dhe identifikuesve të individëve më të rrezikshëm në kërkim ndërkombëtar, për të mbështetur njohjen dhe lokalizimin e shpejtë.
- Publikimi dhe shpërndarja e sigurt e informacionit mbi personin e kërkuar te partnerët përkatës kombëtarë dhe ndërkombëtarë, në përputhje me kërkesat ligjore të mbrojtjes së të dhënave.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Numri i të kërkuarve të kapur përmes hetimeve kombëtare dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Produkti 2: Numri i Njoftimeve të Kuqe të INTERPOL-it të lëshuara dhe kapjeve që rezultojnë nga Njoftimet e Kuqe.

Produkti 3: Numri i kërkesave të ekstradimit të përpunuara dhe koha e finalizimit..

Institucionet përgjegjëse: Policia e Shtetit.

Institucionet mbështetëse: Ministria e Punëve të Brendshme, Europol, INTERPOL, Shërbimi Informativ i Shtetit.

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Shkalla vjetore e personave të shpallur në kërkim, të kapur.

Vlera bazë: viti 2025 me rreth 22% (sipas të dhënave të Policisë së Shtetit më 1 janar të vitit 2025).

Synimi deri më 2030: +4.5% rritje krahasuar me vlerësimin bazë deri në vitin 2030.

2.3 QËLLIMI I POLITIKËS III: BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar përbën Qëllimin e Politikës III të kësaj strategjie, duke theksuar se asnjë përgjigje e brendshme ligjzbatuese, sado e pajisur mirë me burime dhe e ekzekutuar profesionalisht, nuk mund të adresojë plotësisht dimensionin transnacional të krimit të organizuar që prek Shqipërinë. Rrjetet shqiptare kriminale veprojnë në shumë vende, shfrytëzojnë boshllëqet rregullatore ndërkufitare, pastrojnë të ardhurat ndërkombëtarisht dhe rekrutojnë shërbime logjistike dhe lehtësuese përtej kufijve kombëtarë. Prandaj, përgjigjja efektive kërkon që Shqipëria të funksionojë si partner i aftë, i besueshëm dhe proaktiv brenda arkitekturave të sigurisë evropiane dhe globale.

Qëllimi i Politikës III përcakton dy objektiva specifikë: forcimin e bashkëpunimit policor ndërkombëtar dhe përmirësimin e efektivitetit të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar. Së bashku, ofrojnë kornizat, mekanizmat dhe mjetet operacionale përmes të cilave Shqipëria projekton kapacitetin e saj zbatues përtej kufijve të saj, kontribuon dhe përfiton nga ndarja evropiane e inteligjencës, merr pjesë në hetime të përbashkëta dhe siguron zbatimin reciprok të vendimeve gjyqësore. Këta objektiva, gjithashtu, përforcojnë dhe amplifikojnë rezultatet e Qëllimeve të Politikës I dhe II: parandalimi përfiton nga inteligjenca e ndarë e kërcënimit; ndjekja penale përfiton nga operacionet e përbashkëta dhe gjurmimi ndërkufitar i aseteve; dhe të dyja forcohen nga një sistem i fortë i ndihmës së ndërsjellë juridike. Koordinimi kombëtar nuk është përfshirë si objektiv specifik më vete në kuadër të Qëllimit të Politikës III, pasi është konceptuar si një funksion horizontal dhe mundësues që mbështet zbatimin e të gjithë strategjisë, dhe jo si një fushë e veçantë politike apo operative. Koordinimi efektiv ndërinstitucional është integruar në të gjithë strategjinë dhe reflektohet në të gjitha objektivat e politikës përmes roleve dhe përgjegjësive të institucioneve kompetente, mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional, strukturave të zbatimit dhe monitorimit, si dhe aktiviteteve konkrete të parashikuara në planin e veprimit.

Struktura e Qëllimit të Politikës III është ndërtuar me synimin që objektivat specifike të adresojnë dimensionin e jashtëm të bashkëpunimit, konkretisht bashkëpunimin policor ndërkombëtar (Objektivi Specifik 3.1) dhe bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar (Objektivi Specifik 3.2). Këto përbëjnë fusha të veçanta strategjike që kërkojnë masa, tregues dhe mekanizma të dedikuar monitorimi, ndaj edhe objektivat specifike janë fokusuar në forcimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, organizatat dhe rrjetet rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare.

Nga ana tjetër, koordinimi kombëtar është i integruar në vetë përmbajtjen e masave dhe përbën një parakusht të domosdoshëm për realizimin e tyre. Në praktikë, bashkëpunimi ndërkombëtar nuk mund të zhvillohet në mënyrë efektive pa koordinimin paraprak dhe të vazhdueshëm ndërmjet

institucioneve kombëtare përgjegjëse. Masa të tilla si shkëmbimi i informacionit me partnerët e huaj, pjesëmarrja në operacione të përbashkëta, krijimi dhe funksionimi i skuadrave të përbashkëta hetimore, bashkëpunimi me Europol, INTERPOL dhe Eurojust, ekzekutimi i kërkesave të ndihmës juridike ndërkombëtare, bashkëpunimi për rikuperimin e aseteve apo pjesëmarrja në platformat operacionale rajonale dhe ndërkombëtare, kërkojnë domosdoshmërisht bashkërendim të ngushtë ndërmjet autoriteteve kombëtare ligjzbatuese, prokurorive, institucioneve gjyqësore dhe institucioneve të tjera kompetente.

Për rrjedhojë, koordinimi kombëtar përbën njëkohësisht parakusht dhe element përbërës të vetë masave të bashkëpunimit ndërkombëtar të parashikuara në Qëllimin e Politikës III. Krijimi i një Objektivi Specifik të veçantë për koordinimin kombëtar do të sillte mbivendosje konceptuale dhe operacionale me objektivat dhe masat ekzistuese, pasi pothuajse çdo veprim i parashikuar në strategji kërkon dhe përfshin koordinim ndërinstitucional në nivel kombëtar.

Për këto arsye, strategjia ndjek një qasje të integruar, ku koordinimi kombëtar trajtohet si një mekanizëm horizontal zbatimi që mbështet arritjen e të gjitha objektivave strategjike, ndërsa Qëllimi i Politikës III fokusohet në rezultatet konkrete që lidhen me bashkëpunimin policor dhe gjyqësor ndërkombëtar.

Objektivi Specifik 3.1: Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar përmes rritjes së shkëmbimit të informacionit, operacioneve të përbashkëta, dhe ndërprerjes ndërkufitare të krimit të organizuar

Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar është thelbësor për luftën efektive kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe formave të tjera të kriminalitetit që kalojnë kufijtë shtetërorë. Ky shkëmbim do të kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe standardet e BE-së për shkëmbimin e sigurt të të dhënave dhe privatësinë. Duke ndarë informacionin dhe burimet midis agjencive të ndryshme policore në vende të ndryshme, mundësohet një përgjigje më e shpejtë dhe më e koordinuar ndaj kërcënimeve që prekin sigurinë globale dhe rajonale. Kjo formë bashkëpunimi gjithashtu kontribuon në përmirësimin e kapaciteteve hetimore dhe kapjen e personave në kërkim ndërkombëtar, duke përforcuar drejtësinë dhe sigurinë si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar.

Një aspekt i rëndësishëm është bashkëpunimi ndërkufitar, përfshirë promovimin e hetimeve të përbashkëta dhe shkëmbimin e inteligjencës mbi krimet ndërkufitare, përfshirë prerjen e paligjshme, trafikimin e mbetjeve dhe krimet ndaj kafshëve të egra, në përputhje me angazhimet rajonale dhe ndërkombëtare.

Për të arritur rezultate të qëndrueshme në këtë drejtim, nënshkrimi i marrëveshjeve dhe protokolleve të bashkëpunimit, përdorimi i teknologjive të avancuara dhe zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta për personelin policor janë thelbësore.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Rritja e vëllimit, shpejtësisë dhe cilësisë së shkëmbimit të inteligjencës policore me partnerët ndërkombëtarë.

Rezultati 2: Frekuencë dhe efektivitet më të lartë të operacioneve të përbashkëta policore kundër krimit të organizuar ndërkufitar.

Rezultati 3: Ndërprerje e qëndrueshme e rrjeteve të organizuara kriminale ndërkombëtare që veprojnë përmes Shqipërisë.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes Masave të mëposhtme:

Masa 3.1.1: Rritja e shkëmbimit të informacionit me agjencitë ligjzbatuese të rajonit dhe më gjerë, përmes kanaleve tradicionale të bashkëpunimit, si dhe duke integruar Drejtorinë e Rikuperimit të Aseteve (DRA) në shkëmbimin operacional të informacionit, me qëllim forcimin

e luftës kundër krimit të organizuar dhe përmirësimin e identifikimit, gjurmimit, sekuestrimit të aseteve që rrjedhin nga krimi.

Masa 3.1.2: Rritja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në hetimin e krimit të organizuar dhe goditjen e grupeve kriminale, përmes modernizimit të shkëmbimit të informacionit dhe nisjes së hetimeve të hershme financiare, përfshirë duke mbështetur identifikimin e aktiviteteve kriminale ndërkufitare dhe sigurimin e platformave dhe kanaleve të sigurta për shkëmbimin e informacionit në kohë reale, duke synuar përdorimin e pikave të kontaktit sektorial, me qëllim forcimin e përdorimit të pikave të kontaktit sektorial dhe përmirësimin e shpejtësisë dhe cilësisë së bashkëpunimit operacional.

Masa 3.1.3: Pjesëmarrja aktive në Europol, INTERPOL dhe platformat rajonale të bashkëpunimit, edhe përmes angazhimit të rregullt në takimet operacionale dhe nismat analitike, shkëmbimit në kohë të informacionit dhe ndjekjes sistematike të kërkesave, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe përgjigjeve të koordinuara ndaj krimit të organizuar dhe kërcënimeve të krimit të rëndë.

Masa 3.1.4: Rritja e numrit të operacioneve policore të përbashkëta kundër krimit të organizuar, përfshirë duke formuar skuadra të përbashkëta hetimore, sipas rastit, me vendet partnere, për hetime specifike, përdorimin e platformave dhe kanaleve të sigurta për shkëmbimin e informacionit, duke u dhënë akses edhe strukturave hetimore; si dhe pjesëmarrja në të gjitha nismat operacionale të INTERPOL-it dhe të Europolit, me qëllim përmirësimin e zhvillimit të çështjeve ndërkufitare, veprimeve të koordinuara të zbatimit dhe goditjes së rrjeteve kriminale.

Masa 3.1.5: Pjesëmarrja në takimet dhe trajnimet ENFAST, duke ndarë përvojat operacionale dhe praktikat më të mira, duke forcuar bashkëpunimin e pikave të kontaktit dhe duke përmirësuar kapacitetet për lokalizimin, arrestimin dhe dorëzimin e personave në kërkim ndërkombëtar, përmes veprimeve të koordinuara ndërkufitare.

Masa 3.1.6: Forcimi i bashkëpunimit midis institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, përfshirë masat për inkurajimin e bashkëpunimit ndërkufitar, promovimin e hetimeve të përbashkëta dhe shkëmbimin e inteligjencës mbi krimet mjedisore ndërkufitare, përfshirë prerjen e paligjshme, trafikimin e mbetjeve dhe kafshëve të egra, në përputhje me angazhimet rajonale dhe ndërkombëtare, me qëllim përmirësimin e parandalimit, zbulimit dhe zbatimit kundër rrjeteve të krimit mjedisor.

Masa 3.1.7: Monitorimi i zbatimit të detyrimeve nga marrëveshjet midis autoriteteve shqiptare dhe Shteteve Anëtare të BE-së dhe/ose vendeve të treta në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, edhe duke gjurmuar veprimet dhe afatet kohore të miratuara, duke identifikuar boshllëqet e zbatimit dhe duke koordinuar ndjekjen me institucionet përgjegjëse, me qëllim përmbushjen efektive dhe konsistente të angazhimeve të bashkëpunimit ndërkombëtar, si "Pompidou Group" etj.

Masa 3.1.8: Përditësimi/rishikimi i marrëveshjet mes autoriteteve shqiptare dhe vendeve të BE ose vendeve të treta në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Për të mbështetur arritjen e këtyre Masave, do të zbatohen Aktivitetet e mëposhtme:

Aktivitete për masën 3.1.1

- Krijimi i flukseve të strukturuara të shkëmbimit të informacionit me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë, duke siguruar transmetim në kohë të inteligjencës, sinjalizimeve operacionale dhe informacionit të gjurmimit të aseteve përmes kanaleve të sigurta.
- Integrimi i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (ZRA) në proceset operacionale të shkëmbimit të informacionit, duke mundësuar identifikimin, gjurmimin, sekuestrimin e koordinuar të aseteve kriminale ndërmjet kufijve.

Aktivitete për masën 3.1.2

- Modernizimi i sistemeve të shkëmbimit të informacionit dhe platforma të sigurta të komunikimit në kohë reale për bashkëpunim operacional ndërkufitar, përfshirë përdorimin e pikave të kontaktit sektorial.
- Nisja e hetimeve të hershme financiare në çështjet ndërkufitare duke ndarë pista të inteligjencës financiare, tregues të transaksioneve të dyshimta dhe kërkesa të gjurmimit të aseteve me autoritetet partnere.

Aktivitete për masën 3.1.3

- Pjesëmarrja e rregullt në takimet operacionale, projektet analitike dhe nismat e koordinimit të Europolit dhe INTERPOL-it, duke siguruar ndjekje në kohë të të gjitha kërkesave dhe produkteve të inteligjencës.
- Forcimi i angazhimit në platformat e bashkëpunimit rajonal, duke kontribuar me inteligjencë, duke marrë pjesë në vlerësimet e përbashkëta të kërcënimit dhe duke mbështetur përgjigjet e koordinuara ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar.

Aktivitete për masën 3.1.4

- Formimi i skuadrave të përbashkëta hetimore (SPH), aty ku është e zbatueshme, me vendet partnere, për çështje komplekse ndërkufitare, duke siguruar shkëmbim të sigurt të informacionit dhe planifikim operacional të koordinuar.
- Pjesëmarrja në nismat operacionale të INTERPOL-it dhe Europolit, duke u dhënë strukturave hetimore akses në platforma të sigurta për të mbështetur zhvillimin e çështjeve ndërkufitare dhe veprimet ligjzbatuese.

Aktivitete për masën 3.1.5

- Angazhimi aktiv në takimet, trajnimet dhe shkëmbimet operacionale të ENFAST-it, për të forcuar bashkëpunimin e pikave të kontaktit dhe për të përmirësuar kapacitetet për lokalizimin dhe arrestimin e personave në kërkim ndërkombëtar.
- Ndarja e përvojave operacionale dhe praktikave më të mira me partnerët e ENFAST-it, për të rritur koordinimin ndërkufitar dhe për të përshpejtuar kapjen e të kërkuarve.

Aktivitete për masën 3.1.6

- Ngritja e mekanizmave të strukturuar bashkëpunimi midis institucioneve të mbrojtjes së mjedisit dhe agjencive ligjzbatuese, për të promovuar hetime të përbashkëta dhe shkëmbim të inteligjencës mbi prerjen e paligjshme, trafikimin e mbetjeve dhe krimin ndaj kafshëve të egra.
- Pjesëmarrja në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare kundër krimit mjedisor, për të mbështetur veprimet ndërkufitare të zbulimit, parandalimit dhe zbatimit.

Aktivitete për masën 3.1.7

- Kryerja e një analize gjithëpërfshirëse mbi përfitimet, detyrimet, kostot dhe implikimet institucionale, ligjore dhe financiare të anëtarësimit të Shqipërisë në *Grupin Pompidou.*
- Zhvillimi i konsultimeve dhe takimeve teknike me institucionet kombëtare përgjegjëse, Sekretariatin e *Grupit Pompidou* dhe partnerët ndërkombëtarë për vlerësimin e gatishmërisë dhe procedurave të anëtarësimit.
- Përgatitja e raportit vlerësues dhe e propozimit institucional për fillimin e procedurave të anëtarësimit, duke përfshirë një plan veprimi për përmbushjen e kërkesave përkatëse.

Aktivitete për masën 3.1.8

- Ndërmarrja e një procesi të plotë rishikimi dhe vlerësimi i marrëveshjeve ekzistuese të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, me qëllim identifikimin e nevojave për përditësim, harmonizim dhe përshtatje me zhvillimet më të fundit ligjore, institucionale dhe operacionale në nivel evropian dhe ndërkombëtar.

- Zhvillimi i konsultimeve teknike dhe institucionale me autoritetet kompetente të vendeve partnere, agjencitë e Bashkimit Evropian dhe organizatat ndërkombëtare për të identifikuar fushat prioritare ku kërkohet forcimi i instrumenteve të bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar ndërkufitar për të iniciuar marrëveshje të reja, ndryshuar formën e aktit të bashkëpunimit, rishikuar ato ekzistuese;

- Propozimi nga strukturat përkatëse (të bashkëpunimit dhe teknike) për përditësimin e marrëveshjeve ekzistuese dypalëshe dhe shumëpalëshe, duke përfshirë dispozita që mundësojnë shkëmbim më të shpejtë dhe më efektiv të informacionit, mbështetje të ndërsjellë operative, zhvillimin e hetimeve të përbashkëta dhe bashkëpunimin në luftën kundër formave të reja të kriminalitetit,

- Intensifikimi i përpjekjeve përmes komunikimit të vazhdueshëm për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të reja me vendet e Bashkimit Evropian dhe vendet e treta me interes strategjik, me fokus të veçantë në luftën kundër trafikimit të narkotikëve, pastrimit të parave, krimit ekonomik-financiar, krimit kibernetik dhe formave të tjera të krimit të organizuar ndërkombëtar.

- Zhvillimi i takimeve periodike dypalëshe dhe shumëpalëshe me autoritetet homologe për të monitoruar zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe për të identifikuar mundësi të reja bashkëpunimi.

- Sigurimi i përafrimit të vazhdueshëm të kuadrit të bashkëpunimit me atë të Bashkimit Evropian dhe me standardet ndërkombëtare në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

- Zhvillimi i programeve të përbashkëta të trajnimit, shkëmbimit të eksperiencave dhe ngritjes së kapaciteteve për strukturat ligjzbatuese dhe ekspertët e përfshirë në negocimin, zbatimin dhe monitorimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkombëtar, në fushën e parandalimit dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Numri i oficerëve të ndërlidhjes të caktuar në vendet prioritare, përfshirë caktimin e dy oficerëve ndërlidhës nga BKH-ja në Europol dhe Qendrën e Zbatimit të Ligjit për Evropën Juglindore (SELEC).

Produkti 2: Numri i rasteve të informacionit policor të shkëmbyer me partnerët ndërkombëtarë.

Produkti 3: Numri i operacioneve të përbashkëta të kryera me partnerët ndërkombëtarë.

Institucionet përgjegjëse: Policia e Shtetit, Ministria e Punëve të Brendshme, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Institucionet mbështetëse: Shërbimi Informativ i Shtetit; Byroja Kombëtare e Hetimit; Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Ministria e Punëve të Brendshme, Ministritë relevante të linjës

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Niveli i goditjes së rrjeteve kriminale në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar.

Vlera bazë: 2025 – 130 operacione të përbashkëta;

Synimi deri më 2030: +10% e vlerës bazë.

Objektivi Specifik 3.2: Përmirësimi i efektivitetit të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar përmes shpejtimit të shkëmbimit të informacionit, forcimit të ndjekjes së çështjeve dhe rritjes së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të huaja

Bashkëpunimi gjyqësor me autoritetet e huaja në procedurat penale përbën një nga format më të rëndësishme të bashkëpunimit ndërkombëtar për adresimin e sfidave që lidhen me aktivitetet kriminale dhe individët e përfshirë në to. Globalizimi dhe lëvizja e lirë e njerëzve dhe qytetarëve,

sjellin sfida të përbashkëta në fushën e sigurisë, të cilat nuk mund të zgjidhen brenda kufijve të një juridiksioni të vetëm, duke kërkuar kështu bashkëpunim të ngushtë ndërkufitar. Kjo strategji synon të forcojë bashkëpunimin gjyqësor me autoritetet e huaja, si një mjet për të ndëshkuar individët që përpiqen të shmangin përgjegjësinë ligjore, si dhe të rrisë besimin e ndërsjellë me vendet partnere.

Për të arritur rezultate më të mira në drejtësinë penale kundër shkelësve dhe aktiviteteve të paligjshme që lidhen me krimin e organizuar dhe krimet e rënda, duhen shfrytëzuar maksimalisht instrumentet dhe mekanizmat ligjorë ndërkombëtarë, sigurisht duke zbatuar parimet e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Rezultatet e pritshme të këtij objektivi janë si vijon:

Rezultati 1: Përpunimi i ndihmës së ndërsjellë juridike është ndjeshëm më i shpejtë me afate kohore të parashikueshme.

Rezultati 2: Përqindja e kërkesave të bashkëpunimit ndërkombëtar të ekzekutuara me sukses rritet ndjeshëm.

Rezultati 3: Çështjet gjyqësore kryesore të krimit të organizuar me dimensione ndërkombëtare, gjurmohen deri në finalizim në çdo shkallë.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes Masave të mëposhtme:

Masa 3.2.1: Rritja efektivitetit, efikasitetit dhe shpejtësisë së bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar për ekzekutimin e kërkesave që bëhen nga Shqipëria ose nga shtete të huaja, duke forcuar menaxhimin e çështjes dhe ndjekjen, duke zbatuar parimet e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe duke garantuar transmetim dhe trajtim të sigurt të informacionit gjyqësor, me qëllim përmirësimin e normave të ekzekutimit dhe reduktimin e vonesave.

Masa 3.2.2: Përditësimi dhe sigurimi i aksesit të zgjeruar në regjistrin gjyqësor penal në lidhje me shtetasit shqiptarë të dënuar jashtë Shqipërisë, duke miratuar procedura për marrjen në kohë dhe verifikimin e informacionit nga autoritetet përgjegjëse të huaja, duke siguruar cilësi dhe gjurmueshmëri të të dhënave dhe duke mundësuar akses të autorizuar për institucionet përgjegjëse, në respektim të plotë të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Masa 3.2.3: Forcimi i mbështetjes për skuadrat e përbashkëta hetimore (përfshirë SPH-të dypalëshe dhe çështjet të mbështetura/koordinuara nga Eurojust), përfshirë përmes koordinimit ligjor dhe operacional në kohë, shkëmbimit të sigurt të informacionit, lehtësimit të takimeve të koordinimit dhe ndjekjes së vazhdueshme të çështjes, me qëllim përmirësimin e mbledhjes ndërkufitare të provave, efektivitetit hetimor dhe ekzekutimit të masave gjyqësore.

Për të mbështetur arritjen e këtyre Masave, do të zbatohen Aktivitetet e mëposhtme:

Aktivitete për masën 3.2.1

- Miratimi i procedurave të standardizuara të menaxhimit të çështjes për të gjitha kërkesat hyrëse dhe dalëse për ndihmë të ndërsjellë juridike, përfshirë regjistrimin, gjurmimin, afatet kohore dhe përgjegjësitë e ndjekjes, me qëllim që të reduktohen vonesat dhe të ketë parashikueshmëri të kohës që duhet për përpunimin e kërkesës.
- Përdorimi i kanaleve digjitale të sigurta për transmetimin dhe marrjen e informacionit gjyqësor, duke siguruar konfidencialitet, pajtueshmëri me mbrojtjen e të dhënave dhe qarkullim të shpejtë të kërkesave, sqarimeve dhe dokumenteve mbështetëse.

Aktivitete për masën 3.2.2

- Miratimi i procedurave për marrjen, verifikimin dhe regjistrimin në kohë të informacionit nga autoritetet e huaja në lidhje me dënimet, duke siguruar saktësi, gjurmueshmëri dhe pajtueshmëri me standardet e mbrojtjes së të dhënave personale.

- Mundësimi i aksesit të autorizuar për institucionet përgjegjëse, prokurorët, gjykatat, policinë, përmes mekanizmave të sigurt të autentifikimit, në mënyrë që regjistri të përdoret në mënyrë efektive për zhvillimin e çështjes, dënimin dhe vlerësimin e riskut.

Aktivitete për masën 3.2.3

- Koordinimi ligjor dhe operacional në kohë për SPH-të, përfshirë shkëmbimin e sigurt të informacionit, lehtësimin e takimeve të koordinimit dhe përpunimin e shpejtë të masave gjyqësore të kërkuara për mbledhjen ndërkufitare të provave.

- Miratimi i mekanizmave të strukturuar të ndjekjes për të gjitha veprimet e SPH-së, duke siguruar komunikim të vazhdueshëm me Eurojust, prokurorët partnerë dhe skuadrat hetimore, deri në përmbylljen e plotë të çdo çështjeje

Produktet e pritshme që do të rezultojnë janë:

Produkti 1: Numri i kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike të përpunuara dhe koha mesatare e përpunimit.

Produkti 2: Numri i kërkesave të bashkëpunimit ndërkombëtar të ekzekutuara me sukses.

Produkti 3: Numri i urdhrave të huaj të ngrirjes dhe konfiskimit të njohur dhe zbatuar.

Institucionet përgjegjëse: Ministria e Drejtësisë.

Institucionet mbështetëse: Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Rezultatet do të maten përmes Treguesit të mëposhtëm:

Norma e efektivitetit të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.

Vlera bazë: 2025 – 95 kërkesa, prej të cilave janë përfunduar 63 brenda afatit vjetor (66.3%).

Synimi deri më 2030: +15% e vlerës bazë

PJESA III
ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

3.1 Përgjegjësia e institucioneve

Zbatimi efektiv i Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 varet thelbësisht nga forca e sistemeve të saj të llogaridhënies, raportimit dhe monitorimit. Duke vendosur role institucionale të qarta, mekanizma rigorozë monitorimi, procese të forta të integrimit gjinor dhe koordinim transparent të asistencës së huaj, Strategjia ofron një bazë të fortë për progres të qëndrueshëm dhe përshtatje. Raportimi dhe vlerësimi gjithëpërfshirës, si i brendshëm ashtu edhe i jashtëm, krijojnë një cikël reagimi që nxit përmirësimin e vazhdueshëm dhe mbështet harmonizimin e Shqipërisë me standardet e BE-së. Institucionet përgjegjëse të ngarkuara me zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe Planit të Veprimit janë:

1. Ministria e Punëve të Brendshme
2. Ministria e Drejtësisë;
3. Ministria e Mbrojtjes;
4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
5. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit;
6. Ministria e Financave;
7. Ministria e Arsimit;
8. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
9. Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve;
10. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

11. Ministria e Mjedisit;
12. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit);
13. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
14. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
15. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
16. Këshilli i Lartë Gjyqësor;
17. Prokuroria e Përgjithshme;
18. Shërbimi Informativ i Shtetit;
19. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kombëtare;
20. Agjencia e Inteligjencës Financiare;
21. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
22. Banka e Shqipërisë;
23. Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;
24. Agjencia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës

Duke pasqyruar rolet, nivelin e maturimit dhe rëndësinë strategjike të çdo institucioni brenda përgjigjes kombëtare, korniza institucionale është organizuar përmes një **qasjeje me tri nivele**.

NIVELI 1 – INSTITUCIONET KRYESORE

Ministria e Punëve të Brendshme. Ministria e Punëve të Brendshme luan rol qendror në zbatimin e kësaj strategjie. Në përputhje me përgjegjësitë e saj ligjore, Ministria harton, koordinon dhe monitoron politikat e lidhura me parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Ministria mbikëqyr strukturat kryesore operacionale të përfshira në këtë fushë, përfshirë Policinë e Shtetit, Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Inspektoratin Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit. Përmes rolit të saj koordinues, Ministria siguron harmonizimin e politikave kombëtare me detyrimet ndërkombëtare dhe prioritetet e integrimit në BE.

Policia e Shtetit. Policia e Shtetit është autoriteti ligjzbatues kryesor, përgjegjës për parandalimin, identifikimin, zbulimin, hetimin dhe referimin për ndjekje penale të veprave penale të lidhura me krimin e organizuar dhe krimet e rënda. Brenda strukturës së saj organizative, Departamenti për Policinë Kriminale ka drejtori të specializuara përgjegjëse për hetimin e krimit të organizuar, krimeve të rënda, narkotikëve dhe trafikimit, krimeve ekonomike dhe financiare, krimit kibernetik dhe mashtrimit kompjuterik dhe krimeve mjedisore. Departamenti për Marrëdhëniet Ndërkombëtare siguron bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni me partnerët ndërkombëtarë, përfshirë Europolin, INTERPOL-in dhe agjenci të tjera ligjzbatuese. Policia e Shtetit luan rol themelor në zbatimin operacional të kësaj Strategjie, duke kontribuar në mbledhjen e inteligjencës, paralajmërimin e hershëm dhe veprimet e koordinuara hetimore. Pavarësisht aftësisë së lartë operacionale, Policia e Shtetit përballet dhe me burime të kufizuara dhe nevojën për mbështetje teknologjike të avancuar.

Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Njësisë së Pavarur Hetimore, të cilat së bashku përbëjnë Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), përcaktohen si organe kushtetuese në pikën 4, të nenit 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në përputhje me ligjin nr. 95/2016, *i ndryshuar*, neni 4 i tij, Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe Gjykatës së Lartë, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si

dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara me ligj. Ndërkohë në përputhje me nenin 5 të ligjit 95/2016, *i ndryshuar*, Byroja Kombëtare e Hetimit është strukturë e specializuar e Policisë Gjyqësore, që heton veprat penale në juridiksionin penal të Prokurorisë së Posaçme, veprimtaria hetimore e së cilës drejtohet dhe kontrollohet nga Prokuroria e Posaçme sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.

Referuar nenit 30 të Kodit të Procedurës Penale, nenit 28/1 dhe nenit 29/1 të ligjit nr. 95/2016, hetuesit dhe oficerët e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore të BKH-së, kanë të drejtë të kërkojnë burimet e provës dhe me cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore kur vihen në dijeni për rrethana dhe të dhëna për kryerjen e një vepre penale me iniciativën e vet ose nga burime të tjera duhet të kryejnë hetime dhe të grumbullojnë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal, duke referuar më tej veprën penale të kryer ose që tentohet të kryhet në Prokurorinë e Posaçme. Në zbatim të këtyre dispozitave, hetuesit e BKH-së nuk kryejnë vetëm veprimtari procedurale hetimore por edhe veprimtari parandaluese.

Megjithatë, ato përballen me presion të rëndësishëm për shkak të rritjes së ngarkesave të çështjeve dhe kompleksitetit të çështjeve, duke shtrirë shpesh burimet teknologjike dhe analitike deri në kufijtë e tyre.

Prokuroria e Përgjithshme. Prokuroria e Përgjithshme mbikëqyr punën e prokurorive të rrethit dhe siguron zbatimin konsistent të ligjit në procedimet penale. Ajo bashkëpunon me SPAK-un, Policinë e Shtetit dhe institucione të tjera në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të rënda.

Agjencia e Inteligjencës Financiare. Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF), që vepron nën Ministrinë e Financave, është autoriteti kombëtar përgjegjës për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. AIF mbledh, analizon dhe shpërndan inteligjencë financiare tek agjencitë e zbatimit të ligjit dhe mbikëqyr zbatimin e programeve kundër pastrimit të parave/financimit të terrorizmit nga subjektet raportuese. Përmes funksioneve të saj analitike dhe mbikëqyrëse, AIF-ja kontribuon në forcimin e integritetit të sistemit financiar dhe në parandalimin e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit.

Shërbimi Informativ i Shtetit. Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH), i themeluar me Ligjin nr. 8391, datë 28.10.1998, mbledh dhe analizon inteligjencën e lidhur me kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare. SHISH kryen aktivitete kundër-inteligjente dhe mbledh informacion mbi prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve, krimet mjedisore, armët e shkatërrimit në masë dhe forma të tjera të krimit të organizuar që kërcënojnë integritetin, pavarësinë dhe rendin kushtetues të Republikës së Shqipërisë. SHISH kontribuon me inteligjencë strategjike në sistemin kombëtar dhe mbështet koordinimin ndërinstitucional.

NIVELI 2 – MUNDËSUESIT KRITIKË

1. Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Agjencia është përgjegjëse për administrimin, ruajtjen dhe asgjësimin e aseteve të sekuestruara ose të konfiskuara si rezultat i procedimeve penale. Agjencia siguron menaxhimin e ligjshëm të aseteve të tilla dhe mbështet zbatimin e vendimeve gjyqësore të lidhura me konfiskimin.

2. Zyra e Rikuperimit të Aseteve. ARO luan rol kyç në gjurmimin, identifikimin dhe lokalizimin e aseteve kriminale, si brenda vendit ashtu edhe ndërkombëtarisht. ARO bashkëpunon me zyrat e huaja të rikuperimit të aseteve, Europolin dhe mekanizma të tjerë ndërkombëtarë për të mbështetur hetimet financiare dhe procedurat e konfiskimit. Funksionet e saj janë thelbësore për forcimin e ndërprerjes financiare të krimit të organizuar.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kontribuon në parandalimin dhe zbulimin e krimit të organizuar përmes kontrollit kufitar, analizës së riskut dhe inspektimit të mallrave që hyjnë ose dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë. Doganat

bashkëpunojnë me agjencitë e tjera ligjzbatuese për të parandaluar trafikimin e narkotikëve, armëve dhe mallrave të tjera të paligjshme, si dhe luan rol të rëndësishëm në identifikimin e skemave të pastrimit të parave të bazuar në tregti.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve kontribuon në luftën kundër krimit të organizuar duke identifikuar evazionin tatimor, strukturat e dyshimta të biznesit dhe parregullsitë financiare që mund të tregojnë aktivitet kriminal. Përmes inspektimeve të bazuara në rrezik dhe shkëmbimit të informacionit me agjencitë ligjzbatuese, DPT-ja mbështet hetimet financiare dhe qasjen administrative ndaj krimit të organizuar.

5. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore. Si institucioni përgjegjës që garanton në vetvete që shërbimet e policisë të jenë të besueshme, llogaridhënëse dhe strukturalisht të shëndosha mjaftueshëm për të qëndruar në lartësinë e kërkesave dhe përgjigjes ndaj krimit të organizuar 2026–2030. Mandati i saj është thelbësisht për integritetin e Policisë së Shtetit.

6. Banka e Shqipërisë. Në rolin e saj si autoritet mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë monitoron zbatimin e programeve kundër pastrimit të parave nga institucionet financiare nën juridiksionin e saj. BSH-ja kontribuon në integritetin e sistemit financiar dhe mbështet zbulimin e aktivitetit të dyshimtë financiar të lidhur me krimin e organizuar.

NIVELI 3 – QEVERISJA, MBIKËQYRJA DHE INSTITUCIONET E ZBATIMIT SEKTORIAL

Ministria e Drejtësisë siguron bashkëpunimin midis Prokurorisë, INTERPOL-it dhe autoriteteve gjyqësore të huaja në përputhje me Ligjin Nr. 10193, datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale". Ministria është edhe autoriteti kombëtar përgjegjës për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë. Përmes funksioneve të saj të politikës dhe koordinimit, Ministria e Drejtësisë kontribuon në harmonizimin e sistemit të drejtësisë me standardet e BE-së.

Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit. Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit (IKMT) identifikon ndërtimet e paligjshme dhe shkeljet mjedisore. Në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, IKMT-ja referon rastet e krimit mjedisor dhe ndërtimeve të paligjshme tek autoritetet e prokurorisë.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit luan rol të rëndësishëm në zbulimin dhe adresimin e krimeve mjedisore, përfshirë prerjen e paligjshme, trafikimin e mbetjeve dhe nxjerrjen e paligjshme. Bashkëpunon me Policinë e Shtetit dhe institucione të tjera për të siguruar zbatimin e legjislacionit mjedisor.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore luajnë rol kyç në luftimin e faktorëve themelorë që kontribuojnë në krimin e organizuar. Përpjekjet e tyre fokusohen në strategji proaktive dhe parandaluese që synojnë komunitetet e cenueshme dhe individët në rrezik. Këto institucione janë instrumentale në parandalimin e përfshirjes së të rinjve në aktivitete kriminale duke promovuar mundësi arsimore dhe stile jetese të shëndetshme. Përmes zhvillimit dhe mbështetjes së programeve të riintegrimit, ato ndihmojnë individët që kalojnë nga sistemi i drejtësisë penale përsëri në shoqëri, duke nxitur përfshirjen e tyre të suksesshme sociale dhe duke reduktuar recidivizmin. Për më tepër, ato zbatojnë nisma parandaluese të bazuara në komunitet që adresojnë nevojat vendore dhe shfrytëzojnë kohezionin social për të dekurajuar pjesëmarrjen në krimin e organizuar. Duke forcuar shërbimet sociale për grupet e cenueshme (si familjet që përballen me vështirësi ekonomike, personat me aftësi të kufizuara dhe popullatat e margjinalizuara), këto organizata punojnë për të hequr nxitjet sociale dhe ekonomike që shpesh i shtyjnë individët drejt aktiviteteve

të paligjshme. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në veçanti, janë vendimtare për identifikimin e hershëm të faktorëve të rrezikut brenda komuniteteve. Lidhja e tyre e ngushtë me qytetarët u mundëson të zbulojnë shenjat e cenueshmërisë ose kërcënimet në zhvillim dhe të koordinojnë përpjekjet e synuara të parandalimit në nivelin bazë. Së bashku, këto institucione krijojnë një rrjet sigurie gjithëpërfshirës, i cili adreson jo vetëm simptomat por edhe shkaqet rrënjësore të krimit të organizuar, duke kontribuar në rezistencën afatgjatë komunitare dhe stabilitetin social.

3.2. Llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi

Llogaridhënia

Arritja e suksesshme e qëllimeve dhe objektivave të Strategjisë varet nga zbatimi i fortë dhe mekanizmat rigorozë të monitorimit.

Procesi i zbatimit udhëhiqet nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 290 (11.4.2020) për Sistemin e Integruar të Planifikimit (IPSIS), duke siguruar harmonizim me prioritetet kombëtare dhe ato të BE-së.

Ministria e Punëve të Brendshme shërben si institucioni kryesor për koordinimin e të gjitha proceseve të raportimit dhe monitorimit. Monitorimi është i vazhdueshëm dhe i strukturuar rreth cikleve gjashtëmujore dhe vjetore të raportimit, me tregues të qartë performance për matjen e progresit dhe informimin e përshtatjes së strategjisë.

Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) "Demokracia, Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja e Mirë" dhe **Ekipi Tematik "Çështjet e Brendshme"** do të ngarkohen me rishikimin dhe miratimin e raporteve të zbatimit, sigurimin e koordinimit ndërinstitucional dhe ruajtjen e harmonizimit strategjik.

Përgjegjësitë kryesore të këtyre organeve përfshijnë rishikimin dhe miratimin e raporteve periodike të zbatimit, verifikimin e konformitetit me prioritetet kombëtare dhe ato të BE-së dhe mbikëqyrjen e koordinimit ndërinstitucional.

Monitorimi

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Strategji dhe planin e veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga këto dokumente konsiderohet i nevojshëm për të analizuar situatën reale gjatë zbatimit të tyre dhe për të mbikëqyrur zbatimin periodik, me qëllim përmbushjen e tyre sa më efektive të jetë e mundur.

Monitorimi dhe vlerësimi i punës së autoriteteve me detyrime për zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të shërbejnë për gjurmimin e progresit të Strategjisë, vlerësimin e shkallës së arritjes së politikave dhe objektivave të saj dhe përmbushjen e masave dhe aktiviteteve.

Monitorimi i Planit të Veprimit do të kryhet nga grupi i menaxhimit të integruar të politikave (GMIP) "Demokracia, Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja e Mirë", sipas dispozitave të urdhrit të Kryeministrit nr. 90, datë 1.8.2023, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit të integruar sektorial/ndërsektorial". Koordinimi i procesit të monitorimit do të kryhet nga struktura përgjegjëse për politikat kundër krimit të organizuar në Ministrinë e Brendshme.

Brenda një muaji nga miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit, Ministria e Punëve të Brendshme do të koordinojë organizimin e një seminari/takimi koordinimi me të gjitha palët përgjegjëse dhe mbështetëse të interesuara të përfshira në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Qëllimi i këtij takimi do të jetë paraqitja e kornizës së re strategjike, përgjegjësive institucionale, metodologjisë së monitorimit, afateve kohore dhe mënyrave të lidhura të zbatimit, me qëllim sigurimin e koordinimit efektiv ndërinstitucional që në fillim të zbatimit të kornizës së re strategjike.

Brenda kornizës së mekanizmit ekzistues të ekipeve tematike të vendosura me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 90 datë 01.08.2023, i cili, sipas dispozitës së pikës 13, mblidhet nën udhëheqjen e Zëvendësministrit përgjegjës për fushën përkatëse, specifikisht sipas Aneksit 1 të Urdhrit, grupi tematik "Çështjet e Brendshme", një nga fushat/sektorët dhe nënsektorët prioritarë të mbuluar nga ky grup tematik është "lufta kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda." Ky grup organizon takime çdo tre muaj, me të gjitha institucionet përkatëse dhe agjencitë ligjzbatuese dhe, në varësi të çështjeve që trajtohen, fton edhe përfaqësues nga institucione të pavarura, shoqëria civile dhe aktorë të tjerë përkatës.

Këto takime shërbejnë për të shkëmbyer informacion mbi panoramën e kërcënimeve që paraqet krimi i organizuar dhe krimet e rënda, për të prioritizuar raste specifike dhe për të planifikuar veprime të përbashkëta për t'i adresuar ato në kohë, duke mbështetur zbatimin efektiv të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të saj.

Treguesi për matjen e performancës së këtij mekanizmi është:

- Për vitin 2026, takimi i parë do të mbahet tre muaj pas miratimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit nga Këshilli i Ministrave dhe takimet e mëvonshme do të mbahen çdo tre muaj pas takimit të parë deri në fund të vitit 2026;
- Për vitet pasuese të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, do të mbahen katër takime në vit (në mars, qershor, shtator dhe dhjetor).

Institucioni përgjegjës për arritjen e këtij treguesi është ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme. Të dhënat/evidencat për verifikimin e arritjes së treguesit do të jenë procesverbalet dhe konkluzionet e takimeve, si dhe lista e pjesëmarrësve, përfshirë përfaqësuesit e institucioneve/agjencive ligjzbatuese dhe aktorëve të tjerë të ftuar, në varësi të çështjeve specifike të trajtuara në çdo takim.

Procesi do të zhvillohet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet kryesore përgjegjëse për çështjet e sigurisë (përfshirë MPB/PSH, MD, MM, MMSR etj.), donatorë dhe shoqëria civile (përfaqësues të organizatave joqeveritare). Ministria e Punëve të Brendshme do të vendosë një mekanizëm formal për përfshirjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile, përfaqësuesve të institucioneve akademike, aktorëve të platformës së partneritetit, përfaqësuesve të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare që kontribuojnë, zbatojnë projekte ose kryejnë aktivitetet e tyre në fushën e parandalimit dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë.

Treguesi për matjen e performancës së këtij mekanizmi do të jetë organizimi i një takimi në vit, në muajin dhjetor, duke filluar nga viti i parë pas miratimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të saj dhe duke vazhduar gjatë gjithë kohëzgjatjes së Strategjisë.

Institucioni përgjegjës për arritjen e këtij treguesi është ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme. Të dhënat/evidencat për verifikimin e arritjes së treguesit janë përbëjnë procesverbalet dhe konkluzionet e takimeve, si dhe lista e pjesëmarrësve, përfshirë përfaqësuesit e shoqërisë civile, institucioneve akademike, partnerëve brenda platformës së partneritetit dhe përfaqësuesve të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare që kontribuojnë dhe/ose zbatojnë projekte ose kryejnë aktivitete në fushën e parandalimit dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Zbatimi i përgjegjshëm ndaj gjinisë

Brenda mekanizmave të zbatimit të Strategjisë, integrimi gjinor do të operacionalizohet në bashkëpunim me UN Women, duke ndërtuar mbi projektet e saj në vazhdim dhe të kompletuara të zbatuara me institucionet shqiptare të përfshira në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar. Qasjet dhe standardet e UN Women të përgjegjshme ndaj gjinisë do të informojnë

ngritjen institucionale të kapaciteteve, zbatimin e politikave dhe proceset e monitorimit, përfshirë zbatimin e analizës ndërsektoriale gjinore, planifikimit të përgjegjshëm ndaj gjinisë dhe mbledhjes dhe përdorimit sistematik të të dhënave të ndara sipas seksit dhe gjinisë. Ky bashkëpunim do të garantojë që masat kundër krimit të organizuar të jenë gjithëpërfshirëse, efektive dhe të harmonizuara me standardet ndërkombëtare të barazisë gjinore, përfshirë CEDAW, agjendën "Gratë, paqja dhe siguria" dhe kornizat përkatëse të BE-së për barazinë gjinore.

Angazhimi dhe Koordinimi i Asistencës së Huaj

Agjencia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Asistencës së Huaj (ASPSKKH) shërben si autoriteti qendror për koordinimin e asistencës së huaj në Shqipëri, duke siguruar që mbështetja e donatorëve të harmonizohet me prioritetet kombëtare dhe objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030. Roli i ASPSKKH është të integrojë projektet e financuara nga donatorët në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke siguruar koherencë midis institucioneve zbatuese ndërsa shmang dyfishimin e mbështetjes së huaj.

Më konkretisht, ASPSKKH-ja garanton që nismat e mbështetura nga donatorët të kontribuojnë në zbatimin efektiv të strategjive kombëtare, në pajtim si me kornizat ligjore shqiptare, ashtu edhe me standardet e BE-së. Gjithashtu, monitoron zbatimin e projekteve të financuara nga donatorët, në mënyrë që kontributet e donatorëve të përdoren në mënyrë efikase, të arrijnë rezultate të matshme dhe të forcojnë strukturat institucionale përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe aktiviteteve kriminale të rënda.

Ministria e Punëve të Brendshme lehtëson të paktën një takim ose konferencë vjetore të donatorëve, duke shërbyer si platformë për të paraqitur shfrytëzimin e asistencës së huaj, rishikuar prioritetet ekzistuese dhe ato në zhvillim dhe nevojat dhe për të udhëhequr mbështetjen e donatorëve në zbatimin e kornizës strategjike dhe arritjen e objektivave në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Ministria e Punëve të Brendshme shfrytëzon në mënyrë efektive edhe mekanizmat e tjerë ekzistues kombëtarë, si GMIP/Ekipet Tematike, dhe kornizat rajonale, përfshirë Qeverisjen e Integruar të Sigurisë së Brendshme (IISG) nën Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC), për hartëzimin, koordinimin dhe angazhimin e ndihmës së huaj.

Për më tepër, Ministria e Punëve të Brendshme mbledh të dhëna periodike nga projektet e hartuara në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, me qëllim që të ofrojë një pamje gjithëpërfshirëse të angazhimit dhe kontributeve të donatorëve drejt zbatimit të kornizës strategjike në këtë sektor

Për përmbushjen e politikave në luftën kundër krimit të organizuar, bazuar në këtë dokument strategjik, do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- do të monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji (përfshirë të dhënat sipas gjinisë dhe moshës);
- do të bëhen rekomandime për ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat, risqet dhe rreziqet, si dhe përvojat e mëparshme, në përputhje me rekomandimet e raporteve të progresit të Bashkimit Evropian;
- do të bëhen konsultime me palët e interesuara dhe shoqërinë civile (OJF-të, aktorët e platformës së partneritetit etj.), partnerët ndërkombëtarë ose organizatat partnere që veprojnë në këtë fushë, që do të shërbejnë si burim shtesë i të dhënave për të finalizuar dhe për të përmirësuar monitorimin, veçanërisht në lidhje me aspekte si dimensioni social (gjinia, grupet e cenueshme etj.), si dhe për të siguruar transparencë në ndarjen e informacionit;

- do të përgatitet një raport për rritjen e konsistencës dhe integrimin e politikave e masave të sigurisë në të gjitha nivelet e administratës, si dhe për përdorimin më të mirë të burimeve.

Monitorimi do të kryhet bazuar në raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave dhe masave të planit të veprimit. Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/mbështesin harmonizimin e kornizës strategjike dhe prioriteteve në fusha të ndryshme dhe të informojnë politikat e vendit lidhur me adresimin e sfidave kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Forcimi dhe zgjerimi i kornizës statistikore në Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe institucione të tjera përgjegjëse do të lehtësojë hartimin e politikave të bazuara në evidenca/të dhëna, si dhe do të mundësojë vlerësimin objektiv të arritjes së objektivave.

Raportimi

Të gjitha institucionet e ngarkuara me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe të planit të veprimit, do të hartojnë raporte gjashtëmujore dhe vjetore, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë, si dhe do të hedhin të dhënat në sistemin IPSIS. Ministria e Punëve të Brendshme do të jetë institucioni kryesor, që do të mbledhë, do të përpunojë dhe do të analizojë raportet periodike gjashtëmujore dhe vjetore që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara me përmbushjen e objektivave dhe masave përkatëse.

Institucionet duhet të raportojnë periodikisht çdo 6 muaj mbi zbatimin e masave, përmes të dhënave të raportuara në Sistemin e Integruar të Informacionit të Planifikimit Strategjik (IPSIS) pranë Këshillit të Ministrave dhe te Sekretariati Teknik Ndërinstitucional.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm, progresi në arritjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të matet përmes dy metodave të vlerësimit:

Vlerësimi afatmesëm kryhet në fund të periudhës dyvjeçare, në fund të vitit 2028 dhe do të analizojë rezultatet e arritura, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e zbatimit. Kjo analizë do të tregojë ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm ekonomik dhe social, do të vlerësojë nëse objektivat mbeten relevantë duke bërë krahasimin me kontekstin fillestar dhe do të identifikojë veprimet e nevojshme.

Të gjitha raportet gjashtëmujore, vjetore dhe raporti përfundimtar i vlerësimit do të bëhen publike. Në rast se raportet përmbajnë të dhëna konfidenciale, do të përgatitet një version i përshtatshëm për publikim.

Bazuar në këtë vlerësim, do të hartohet Plani i Veprimit për 2029–2030 për të arritur objektivat e përcaktuara në strategji.

Vlerësimi përfundimtar, pas përfundimit të periudhës së zbatimit, do të analizojë të gjithë Strategjinë dhe ndikimin e saj të përgjithshëm, duke vlerësuar rezultatet e masave të ndërmarra, burimet e investuara dhe shkallën në të cilën janë arritur efektet e pritura. Vlerësimi përfundimtar do të kryhet duke analizuar të dhëna nga burime të ndryshme, përfshirë konstatimet e monitorimit të performancës dhe vlerësimit të ndikimit të programeve aktive në luftën kundër krimit të organizuar. Brenda kësaj kornize, si referencë do të shërbejnë edhe raportet e vlerësimit të ndikimit, si dhe raportet dhe studimet e kryera nga shoqëria civile dhe donatorët. Monitorimi i brendshëm do të vlerësojë progresin e bërë bazuar në performancën e treguesve:

Treguesit e brendshëm janë ato të parashikuar sipas objektivave specifikë

Treguesit e jashtëm do të jenë:

- vlerësime të publikut, qytetarëve dhe bizneseve të ndryshme, përmes matjes së perceptimit publik duke përdorur pyetësorë, intervista dhe organizimin e forumeve të hapura;

- vlerësime të institucioneve ndërkombëtare, në raporte ose buletine periodike;
- vlerësime të vendeve të rajonit për indikatorët e minimizimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda në Shqipëri.

PJESA IV
ANALIZA BUXHETORE

Ky kapitull paraqet shpërndarjen e kostove indikative dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026–2030. Llogaritja e kostos së Strategjisë është kryer bazuar në metodologjinë dhe praktikën e planifikimit të buxhetit, ndërsa vlerësimi i kostove indikative bazohet në objektivat e vendosur, si dhe masat dhe aktivitetet e identifikuara për çdo aktivitet. Llogaritjet buxhetore janë bërë duke përdorur instrumentin e rekomanduar nga IPSIS, të përshtatur sipas udhëzimeve përkatëse.

Kostoja totale e vlerësuar për zbatimin e **Planit të Veprimit 2026–2028 të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026–2030** është 37,530,821,822 **lekë.**

Kursi mesatar referues i këmbimit është llogaritur në 93.1 lekë për 1 euro.

Tabela 1: *Kostot totale, burimet e financimit dhe Boshllëku Financiar për periudhën 2026–2030.*

Nevojat kapitale (në lekë)

Qëllimi i politikave	Natyra/tipologjia e kostove	Kostoja totale 2026–2030	Kostot e planifikuara PBA 2026–2028 Buxheti	Kostot e planifikuara PBA 2026–2030 Buxheti	Kostot e planifikuara PBA 2026–2030 Donatorët	Hendeku financiar 2026–2030
Qëllimi i politikës I	Korrente	12,866,771,779	12,149,928,017	716,843,762	0	***0***
	Kapitale	1,844,487,408	1,108,967,000	0	735,520,408	
Qëllimi i politikës II	Korrente	11,744,518,345	7,348,567,277	4,395,951,068	0	2,992,554,000
	Kapitale	10,025,199,998	1,092,660,998	2,701,050,000	3,238,935,000	
Qëllimi i politikës III	Korrente	1,049,844,292	939,293,124	110,551,168	0	***0***
	Kapitale	0	0	0	0	
TOTALI [lekë]		**37,530,821,822**	**22,639,416,416**	**7,924,395,998**	**3,974,455,408**	***2,992,554,000***
TOTALI [euro] ***1 euro 93.1 lekë***		**403,123,757**	**243,173,109**	**85,117,035**	**42,690,176**	**32,143,437**

Efektet financiare janë llogaritur për të gjithë periudhën e zbatimit të strategjisë 2026–2030, duke marrë parasysh aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit 2026–2028 dhe dokumentin strategjik. Efektet financiare pritet të mbulohen nga buxhetet vjetore përkatëse të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e masave, nga buxhetet e donatorëve dhe nga institucione të tjera që janë përgjegjëse për zbatimin e masave.

Procesi i llogaritjes së kostos u bazua në konsultimin e dokumenteve të tjera kombëtare, përfshirë Programin Buxhetor Afatmesëm 2026–2028, Programin Buxhetor Afatmesëm 2028-2030 dhe konsultimet me të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin e planit, si dhe kostot historike nga zbatimi i planit të mëparshëm.

Plani i veprimit shoqërohet nga një llogaritje analitike e kostos së çdo mase, e cila mbështetet nga një ndarje e detajuar e shpenzimeve për çdo aktivitet. Llogaritja e strategjisë dhe planit të veprimit është kryer bazuar në metodologjitë dhe praktikat e planifikimit buxhetor, duke përdorur instrumentet e rekomanduara nga IPSIS.

Grafiku 1: *Financimi i strategjisë do të kryhet nga disa burime, duke përmendur këtu buxhetin e shtetit (81%) dhe financimin e huaj (11%). Boshllëku financiar është 8%.*

Kostot totale të Strategjisë	**37,530,821,822**	**Vlera në %**
PBA 2026–2028	22,639,416,416	**60**
PBA 2028–2030	7,924,395,998	**21**
Financimi i huaj	3,974,455,408	**11**
Boshllëku financiar 2026–2030	2,992,554,000	**8**

Kostoja korrente	**25,661,134,416**	68%
Kostoja kapitale	**11,869,687,406**	32%
Kostoja totale	**37,530,821,822**	100%

	LEKË	**EUR**
Kostoja totale e Strategjisë	**37,530,821,822**	**403,123,757**
PBA 26-28	**22,639,416,416**	**243,173,109**
PBA 28-30	**7,924,395,998**	**85,117,035**
Financimi i Huaj	**3,974,455,408**	**42,690,176**
Boshllëku Financiar	**2,992,554,000**	**32,143,437**
Kostoja Korrente	**25,661,134,416**	**275,629,800**
Kostoja Kapitale	**11,869,687,406**	**127,493,957**

Grafiku nr. 2: *Paraqitja grafike e kostove të Planit të Veprimit të Strategjisë, duke nxjerrë në pah ndarjen e shpenzimeve të financuara nga Programi Buxhetor Afatmesëm dhe nga financimi i huaj.*



Grafiku nr. 3: *Paraqitja grafike e natyrës së kostove ekonomike të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, duke nxjerrë në pah ndarjen në kostoja korrente dhe kostoja kapitale*

Kostot korrente përbëjnë rreth 68% të shpenzimeve totale, ndërsa kostot kapitale përbëjnë rreth 32%.

Analiza narrative e kostove kapitale

I. Objektivi Specifik 1.2 – Reduktimi i cenueshmërisë së komuniteteve me risk duke përmirësuar aksesin në mekanizmat e mbështetjes sociale, ekonomike dhe të riintegrimit

Brenda Objektivit Specifik 1.2, kostot indikative kapitale parashikohen për masat e mëposhtme:

- Masa 1.2.2 – Inkurajimi dhe promovimi i transferimit të pronave/aseteve të konfiskuara në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, në mënyrë që të përdoren për qëllime sociale dhe në dobi të komuniteteve.

- Masa 1.2.3 – Planifikimi dhe organizimi takimeve ndërgjegjësuese mbi procedurat për transferimin e aseteve të konfiskuara të aktivitetit kriminal, tek institucionet qendrore dhe vendore, me qëllim lehtësimin e ripërdorimit social të tyre.

Për zbatimin e kësaj mase parashikohet financim kapital, pasi zhvillimi i takimeve ndërgjegjësuese përfshin investime për ndërtimin e kapaciteteve institucionale, përgatitjen e materialeve të standardizuara dhe vendosjen e mekanizmave të qëndrueshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional për administrimin e aseteve të konfiskuara.

- Masa 1.2.4 – Përmirësimi i trajtimit të të burgosurve për sa u përket aspekteve psikosociale dhe kulturore, si dhe i kushteve të strukturave dhe infrastrukturës së burgjeve, përfshirë përmes hartimit dhe zbatimit të programeve sociale dhe trajnimeve ose kurseve profesionale.

Financim kapital nën këtë masë parashikohet edhe për investime afatgjata për përmirësimin e infrastrukturës dhe strukturave të burgjeve, krijimin e hapësirave për trajtim psikosocial, kulturor dhe profesional, si dhe për pajisje të qëndrueshme për zbatimin e programeve dhe trajnimeve rehabilituese.

II. Objektivi Specifik 1.4 - Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë

Brenda Objektivit Specifik 1.4, kostot indikative kapitale parashikohen për masat e mëposhtme:

- **Masa 1.4.8** – Operacionalizimi plotë i sistemit *e-Presto,* për të cilin masat administrative paraprake për zhvillimin teknologjik kanë përfunduar, ndërkohë që prokurorët e prokurorive të përgjithshme finalizojnë dhe përditësojnë çështjet dhe seksionet përkatëse.

Financim kapital parashikohet për këtë masë, pasi operacionalizimi i plotë i sistemit *e-Presto* kërkon investime kapitale për zhvillimin teknologjik dhe përmirësimin, përditësimin dhe zgjerimin e funksionaliteteve të sistemit dhe infrastrukturën dhe pajisjet e qëndrueshme TI për përdorim afatgjatë.

- **Masa 1.4.9** – Operacionalizimi plotë i i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve në Prokurorinë e Përgjithshme.

Financim kapital parashikohet për këtë masë, pasi operacionalizimi i plotë i SMÇ-së kërkon investime për zhvillimin dhe integrimin e sistemit, modernizimin e infrastrukturës TI, licencat dhe pajisjet e qëndrueshme të nevojshme për menaxhimin afatgjatë elektronik të çështjeve penale.

- **Masa 1.4.10** – Operacionalizimi plotë i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Financim kapital parashikohet për këtë masë, përfshirë investime për zhvillimin dhe përshtatjen teknologjike, integrimin me sisteme të tjera, infrastrukturën dhe pajisjet TI dhe sigurinë e avancuar të të dhënave për përdorim operacional afatgjatë.

III. Objektivi Specifik 1.5 – Reduktimi i stimujve dhe mundësive financiare për krimin e organizuar nëpërmjet forcimit të kontrolleve ekonomike dhe ndërprerjes së burimeve të financimit

- **Masa 1.5.4** – Monitorimi i mallrave me rrezik të lartë mallrave të cenueshme ndaj evazionit fiskal.

Kostot kapitale parashikohen për zbatimin e kësaj mase, pasi kontrolli i mallrave me rrezik të lartë kërkon investime afatgjata në pajisje teknike kontrolli, sisteme inteligjente të analizës së rrezikut, infrastrukturë TI dhe mjete monitorimi, të cilat klasifikohen si shpenzime kapitale dhe sigurojnë efektivitet të qëndrueshëm të kontrolleve.

IV. Objektivi Specifik 2.3 – Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë

- **Masa 2.3.5** – Trajnime për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit të organeve ligjzbatuesve, gjyqtarëve, prokurorëve dhe të inteligjencës për rreziqet e pastrimit të parave, me tematika të lidhura me rrezikun e mbledhjes, lëvizjes së fondeve të Shqipërisë, përdorimi i fondeve për territorin e Shqipërisë, përdorimit të personave juridik, strukturave komplekse, profesionistëve, për pastrimin e parave si vepër autonome, risku nga keqpërdorimi i OJF, financimi i terrorizmit i lidhur me tregtinë etj.

Financim kapital parashikohet për këtë masë, pasi trajnimet kërkojnë investime afatgjata për zhvillimin e platformave dhe pajisjeve të trajnimit, materialeve të trajnimit dhe krijimin e kapaciteteve institucionale të qëndrueshme për ndërgjegjësimin e vazhdueshëm mbi rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

V. Objektivi Specifik 2.5 – Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave

- **Masa 2.5.2** – Miratimi një plani të detajuar për sistemimin e strukturës së Policisë Shkencore në ambientet e reja, përfshirë planifikimin e hapësirës, zonimin funksional të laboratorëve dhe zonave të provave, kërkesat e sigurisë, masat e sigurisë në punë, afatet kohore të zhvendosjes në faza dhe modalitetet e vazhdimësisë së punës, për të shmangur ndërprerjen e shërbimeve kriminalistike.

Financim kapital parashikohet për këtë masë, pasi miratimi i planit të detajuar të sistemimit kërkon investime në infrastrukturë, pajisje të specializuara dhe përshtatje të strukturave për përdorim operacional afatgjatë.

- **Masa 2.5.3** – Zbatimi i standardeve minimale të cilësisë për hetimet në vendin e ngjarjes dhe për administrimin e provave nga vendi i ngjarjes deri në sallën e gjyqit, përfshirë procedurat standarde operacionale për sigurimin, dokumentimin, mbledhjen, paketimin, transportimin, ruajtjen, ekzaminimin dhe paraqitjen e provave, me qëllim garantimin e integritetit, gjurmueshmërisë dhe pranueshmërisë së provave.

Financim kapital parashikohet, pasi zbatimi i standardeve minimale të cilësisë kërkon investime në pajisje të specializuara, laboratorë, teknologji për menaxhimin e provave dhe infrastrukturë të qëndrueshme për hetime dhe procedimet gjyqësore.

- **Masa 2.5.7** – Arritja e akreditimit të shërbimeve të ofruara nga Instituti i Policisë Shkencore sipas standardeve ISO, i zbatuar në faza, duke prioritizuar disiplinat shkencore me ndikim të lartë, duke kryer auditimet e brendshme, duke adresuar mospërputhjet (identifikimi, dokumentimi, vlerësimi dhe korrigjimi i devijimeve nga standardet e cilësisë së vendosur) dhe duke siguruar përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë.

Financim kapital parashikohet, pasi akreditimi ISO kërkon investime afatgjata në infrastrukturë, pajisje laboratorike, procedura standarde dhe kapacitete të qëndrueshme për të siguruar cilësinë dhe pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare.

- **Masa 2.5.8** – Hartimi një plani të dedikuar për zbatimin e metodave novatore në shkencat kriminalistike në luftën kundër krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera kriminale, përfshirë identifikimin e metodave prioritare, pajisjeve dhe trajnimit të kërkuar, procedurat e validimit dhe integrimin në flukset operacionale të punës.

Financim kapital parashikohet, pasi zhvillimi i këtij plani kërkon investime në pajisje dhe teknologji laboratorike, protokolle standarde dhe krijimin e kapaciteteve institucionale të qëndrueshme për përdorim afatgjatë.

- **Masa 2.5.9** – Mbështetja dhe forcimi i kapaciteteve për procesin e menaxhimit të cilësisë në nivel rajonal të hetimit të vendngjarjes dhe në nivel qendror, përfshirë përmes procedurave të harmonizuara, mentorimit, kontrolleve të brendshme dhe rishikimeve periodike të cilësisë për të siguruar zbatim konsistent të standardeve në të gjithë vendin.

Financim kapital parashikohet, pasi mbështetja e menaxhimit të cilësisë kërkon investime në pajisje teknologjike, infrastrukturë të përshtatur dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale rajonale dhe qendrore të qëndrueshme.

- **Masa 2.5.12** – Ndërtimi i Serverit të Stacionit të Kontrollit në Distancë për të mundësuar krahasimin e drejtpërdrejtë të të dhënave daktiloskopike në sistemin AFIS Papillon të Institutit të Policisë Shkencore, duke siguruar ndërlidhje të sigurt, kapacitet të mjaftueshëm të serverit, integrim me flukset ekzistuese të punës dhe auditueshmëri të kërkimeve dhe përputhjeve.

Financim kapital parashikohet, pasi ndërtimi i serverit kërkon investime në pajisje të specializuara teknologjike, infrastrukturë IT të qëndrueshme dhe integrim me sistemin AFIS Papillon për operim efikas afatgjatë.

VI. Objektivi Specifik 2.6 – Rritja e efektivitetit në gjurmimin, ngrirjen, konfiskimin dhe ripërdorimin e aseteve, duke hequr sistematikisht të ardhurat kriminale dhe duke i riinvestuar për dobi publike

- **Masa 2.6.3** – Përmirësimi i administrimit dhe ripërdorimit të aseteve të konfiskuara, me qëllim ruajtjen dhe/ose rritjen së vlere për ripërdorim të mëvonshëm ripërdorimit, duke forcuar planifikimin e menaxhimit të aseteve, masat e mirëmbajtjes dhe mbrojtjes, praktikat e vlerësimit dhe vendimmarrjen transparente mbi asgjësimin ose ripërdorimin.

Financim kapital parashikohet, pasi përmirësimi i procedurave kërkon investime në sisteme teknologjike, infrastrukturë dhe mjete të qëndrueshme për menaxhim efektiv dhe ruajtje të vlerës.

- **Masa 2.6.4** – Ripërdorimi i aseteve të konfiskuara, përfshirë ripërdorimin social, brenda 6 muajve nga konfiskimi, duke thjeshtuar procedurat administrative, duke standardizuar rrugët e vendimmarrjes dhe duke forcuar koordinimin midis Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe institucioneve përfituese përkatëse..

Financim kapital parashikohet, pasi kjo kërkon investime në infrastrukturë, pajisje dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale për menaxhim efektiv dhe ripërdorim social.

- **Masa 2.6.8** – Përmirësimi i elementeve funksionale të regjistrit elektronik të aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara, me përmirësimin e kontrollit të cilësisë së të dhënave, sigurimin e përditësimeve në kohë, përmirësimin e menaxhimit të aksesit të përdoruesit dhe të auditueshmërisë, duke mundësuar funksionalitetet raportuese dhe analitike në mbështetje të vendimmarrjes për administrimin, asgjësimin dhe ripërdorimin..

Financim kapital parashikohet, pasi përmirësimi i regjistrit elektronik kërkon investime për zhvillimin e sistemit, infrastrukturën TI dhe mjetet e qëndrueshme për operim efektiv dhe siguri afatgjatë.

VII. Objektivi Specifik 2.7 – Përmirësimi i matshëm në hetimet dhe ndjekjet penale të udhëheqësve dhe anëtarëve të strukturave të krimit të organizuar, e demonstruar me rritjen e dënimeve të rënda dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

- **Masa 2.7.6** – Parandalimi dhe goditja e krimeve në burgjet e vendit, në bashkëpunim me SPAK-un, prokuroritë e rretheve gjyqësore, si dhe agjencitë ligjzbatuese, përfshirë përmes veprimeve të koordinuara operacionale, shkëmbimit të strukturuar të informacionit dhe planifikimit të përbashkët për hetime dhe ndërhyrje.

Financim kapital parashikohet, pasi rritja e hetimeve proaktive kërkon investime në pajisje teknologjike, sisteme të mbledhjes dhe analizës së të dhënave dhe infrastrukturë të qëndrueshme për mbështetjen e operacioneve hetimore.

- **Masa 2.7.7** – Rritja e përdorimit të metodave të posaçme të hetimit, me qëllim zbulimin dhe dokumentimin e aktiviteteve kriminale, përfshirë përgjimin, infiltrimin, mbikëqyrjen fizike, dhe rritjen e performancës profesionale të oficerëve që zbatojnë këto metoda përmes trajnimit të specializuar, mbikëqyrjes dhe sigurimit të cilësisë.

Financim kapital parashikohet, pasi parandalimi dhe ndërhyrja kërkojnë investime afatgjata në pajisje, teknologji mbikëqyrjeje, sisteme të menaxhimit të informacionit dhe infrastrukturë të qëndrueshme për operacione efektive ndërinstitucionale.

- **Masa 2.7.12** – Rinovimi i pajisjes Router-VPN të instaluar në serverat e INTERPOL NCB Tirana, që mundëson enkriptim të komunikimeve në sistemin e INTERPOL-it, për të garantuar shkëmbim të sigurt të informacionit dhe për të ruajtur konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave që transmetohen.

Financim kapital parashiko het, pasi rinovimi kërkon investime në teknologji sigurie, infrastrukturë të qëndrueshme dhe sigurimin e komunikimit të sigurt brenda sistemit INTERPOL.

Strategjia është fokusuar kryesisht në ndjekjen penale dhe luftimin e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, gjë që dëshmohet edhe në paraqitjen grafike të mëposhtme, ku qëllimi politik II ka peshën specifike më të lartë në koston totale të planit të veprimit të kësaj strategjie.

Grafiku nr. 4: *Paraqitja grafike e shpërndarjes së kostove sipas objektivave të politikës*

ANEKSI 1
KORNIZA LIGJORE

KORNIZA LIGJORE NË FUQI NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA

Shqipëria ka një kornizë gjithëpërfshirëse të legjislacionit ligjor dhe dytësor, si dhe një numër të konsiderueshëm dokumentesh strategjike që adresojnë krimin e organizuar dhe krimin e rëndë. Korniza ligjore për luftimin e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda përbëhet nga një grup ligjesh dhe aktesh nënligjore që përbëjnë bazën e nevojshme rregullatore në këtë fushë.

Gjatë vitit 2025, Shqipëria ndërmori një nismë të rëndësishme legjislative në lidhje me ndryshimet në Kodin Penal. Dinamikat e reja shoqërore dhe ekonomike e bënë të nevojshëm hapjen e një debati thelbësor mbi dekriminalizimin e disa sjelljeve dhe kriminalizimin e të tjerave, veçanërisht në kontekstin e zhvillimeve të shpejta teknologjike. Shfaqja e faktorëve të rinj kriminogjenë kërkon një përgjigje të përshtatshme dhe efektive, e cila mund të sigurohet vetëm përmes legjislacionit modern penal të aftë për të adresuar sfidat bashkëkohore.

Në këtë kontekst, hartimi i një Kodi të ri Penal u shfaq si domosdoshmëri e pashmangshme, me qëllim harmonizimin e tij me të gjitha instrumentet ndërkombëtare të cilëve Shqipëria u është bashkuar ndër vite, standardet e të cilave duhet të reflektohen në legjislacionin penal të brendshëm. Pasi Shqipëria është e angazhuar në një proces të pakthyeshëm drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, rëndësi të veçantë i kushtohet harmonizimit të legjislacionit penal me *Acquis*-në e BE-së.

Disa nga aktet kryesore ligjore dhe strategjike përfshijnë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 10192/2009, *"Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit përmes Masave Parandaluese kundër Pasurisë"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2025, *"Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve";*
- Ligji nr. 7975/1995, *"Për Lëndët Narkotike dhe Substancat Psikotrope"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 82/2024, *"Për Policinë e Shtetit"*;
- Ligji nr. 9917/2008, *"Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10173/2009, *"Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë*";
- Ligji nr. 34/2019, *"Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 38/2025, *"Për Përpunimin e Informacionit të Pasagjerëve në Republikën e Shqipërisë*";
- Ligji nr. 10193/2009, *"Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale*";
- Ligji nr. 112/2020, *"Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 154/2020, *"Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare*";
- Ligji nr. 79/2020, *"Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale*";
- Akti normativ nr. 1/2020, *"Për Masat Parandaluese në Kuadër të Forcimit të Luftës kundër Terrorizmit, Krimit të Organizuar, Krimeve të Rënda dhe Konsolidimit të Rendit Publik*";
- Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Shqipërisë nr. 44, datë 10.6.2009, *"Për miratimin e rregullores për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit"*;
- Ligji nr. 95/2016, *"Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 27/2018, *"Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"*, i ndryshuar;

- Ligji nr. 8523, datë 09.09.1999, *"Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Mjetet e Ndalimit dhe Parandalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë së Pasurive Kulturore"*;

- Ligji nr. 123/2024, *"Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Veprat Penale që Lidhen me Pasurinë Kulturore"*, nënshkruar në Nikozi, më 19.5.2017.

Dokumentet strategjike përfshijnë:

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2024–2030;
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030;
- Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027;
- Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës Kapitullin 24;
- Strategjia Ndërsektoriale për Sigurinë në Komunitet dhe Plani i Veprimit 2024–2026;
- Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit dhe Planet e Veprimit 2023–2025;
- Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030;
- Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2024–2030;
- Strategjia Ndërsektoriale për Menaxhimin e Integruar të Kufijve dhe Plani i Veprimit 2021–2027;
- Strategjia për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Municionit dhe Lëndëve Plasëse dhe Plani i Veprimit 2019–2025;
- Plani Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE);
- Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030;
- Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit;
- Marrëveshjet me Europol dhe INTERPOL.

Shqipëria është gjithashtu palë në instrumente të rëndësishme ndërkombëtare të lidhura me luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (UNTOC) dhe protokollet e saj plotësuese:
- Protokolli për Parandalimin, Goditjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave;
- Protokolli kundër Kontrabandës së Migrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri;
- Protokolli kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit, Pjesëve dhe Komponentëve të Tyre dhe Municionit;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Veprimet kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA);
- Konventa Evropiane për Ekstradimin dhe protokollet e saj plotësuese;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe për Financimin e Terrorizmit (Konventa e Varshavës);
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit);
- Koalicioni Global për Adresimin e Kërcënimeve të Drogave Sintetike;
- Rregulloret dhe Direktivat e BE-së në fushën e bashkëpunimit gjyqësor dhe policor në çështjet penale;
- Rekomandimet e Task-Forcës për Veprimin Financiar (FATF/ICRG);
- Raportet vjetore të Departamentit të Shtetit të SHBA (DASH);
- Marrëveshjet operacionale me Europolin dhe INTERPOL-in;
- Nisma Globale kundër Krimit të Organizuar Transnacional (GI-TOC);

- Deklaratat dhe agjendat e Procesit të Berlinit dhe Konferencave Ministrore të Ballkanit Perëndimor mbi Sigurinë.

KORNIZA LIGJORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE NË INSTITUCIONET E ZBATIMIT TË LIGJIT NË SHQIPËRI

1. Themelet Kushtetuese dhe Ndërkombëtare

E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale garantohet nga neni 35 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila e njeh privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale si të drejta themelore. Ky parim kushtetues ofron themelin për të gjithë legjislacionin e mëvonshëm që rregullon përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet publike, përfshirë institucionet e zbatimit të ligjit.

Shqipëria ka ratifikuar gjithashtu instrumente të rëndësishme ndërkombëtare që vendosin parime për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe Konventën për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (Konventa 108 dhe 108+). Këto instrumente sigurojnë që të dhënat personale të përpunohen sipas ligjit, drejtë dhe me transparencë, si dhe në kuadër të hetimeve penale dhe sistemit të drejtësisë.

2. Legjislacioni Kombëtar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Korniza ligjore parësore që rregullon mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri është Ligji Nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i cili është plotësisht i harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së. Ky ligj zëvendëson Ligjin Nr. 9887/2008, duke zgjeruar dispozitat e mbrojtjes së të dhënave, duke sqaruar përgjegjësitë e kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhënave dhe duke vendosur masa të avancuara për të mbrojtur të drejtat e individëve.

Veçoritë kryesore të ligjit përfshijnë:

- Përpunim i ligjshëm, proporcional dhe i kufizuar nga qëllimi i të dhënave personale;
- Detyrime për zbatimin e masave teknike dhe organizative për të siguruar sigurinë e të dhënave;
- Të drejta individuale për akses, korrigjim dhe apelim të vendimeve në lidhje me të dhënat e tyre;
- Mbikëqyrje dhe zbatim nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDHP).

Kjo kornizë mbështet drejtpërdrejt institucionet e zbatimit të ligjit që përpunojnë të dhëna personale gjatë hetimeve ose ndjekjeve penale të krimit të organizuar dhe veprave të rënda.

3. Pajtueshmëria me standardet e BE-së

Korniza ligjore shqiptare është dizajnuar të jetë plotësisht në pajtim me standardet e BE-së, përfshirë:

- Parimet e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR, Reg. (BE) 2016/679) për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale;
- Direktiva (BE) 2016/680 për përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet përgjegjëse për qëllime të zbatimit të ligjit;
- Zbatimi i masave të sigurta teknike dhe organizative, përfshirë enkriptim, VPN dhe kontrolle të aksesit për të dhënat e ndjeshme të zbatimit të ligjit;
- Politikat për ruajtjen dhe fshirjen e të dhënave, në përputhje me udhëzimet e BE-së për transparencën, llogaridhënien dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve.

Kjo pajtueshmëri siguron ndërveprueshmëri të plotë me mekanizmat e bashkëpunimit të BE-së për zbatimin e ligjit si SIENA, Europol dhe INTERPOL, duke garantuar respektimin e standardeve të mbrojtjes së të dhënave në operacionet ndërkufitare.

4. Roli i Autoritetit të Pavarur të Mbrojtjes së të Dhënave

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti i pavarur mbikëqyrës që siguron pajtueshmërinë me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave në sektorët publikë dhe privatë. Për institucionet e zbatimit të ligjit, Komisioneri:

- Monitoron aktivitetet e përpunimit të të dhënave;
- Ofron udhëzime për garancitë teknike dhe procedurale;
- Kryen auditime të pajtueshmërisë;
- Bashkëpunon me autoritetet e BE-së dhe ato ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave për të siguruar harmonizim me *Acquis* të BE-së.

5. Mbrojtja e të Dhënave nga Zbatimi i Ligjit në Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe të Rëndë

Institucionet e zbatimit të ligjit që veprojnë në fushat e krimit të organizuar dhe veprave të rënda (p.sh., Policia e Shtetit, SPAK, autoritetet gjyqësore, agjencitë e inteligjencës) veprojnë brenda kësaj kornize ligjore për të siguruar:

- Përpunim të ligjshëm, të nevojshëm dhe proporcional të të dhënave personale;
- Masa të sigurta teknike, përfshirë enkriptim, VPN dhe kontrolle të aksesit;
- Pajtueshmëri ligjore në ndarjen ndërinstitucionale dhe ndërkufitare të të dhënave;
- Ruajtja dhe fshirja e të dhënave sipas kërkesave ligjore, duke shmangur ruajtjen e tepërt ose të panevojshme.

Kjo kornizë garanton që operacionet e zbatimit të ligjit mbrojnë privatësinë individuale duke ruajtur pajtueshmërinë e plotë me standardet e BE-së dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale

ANEKSI 2: Plani i Veprimit për periudhën 2026–2028

ANEKSI 3: Pasaporta e treguesve të performancës

PASAPORTAT E TREGUESVE

Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026–2030

Pasaporta përbëhet nga dy pjesë:

Pjesa I. **17 tregues rezultati**, një për secilin Objektiv Specifik, në përputhje me modelin IPSIS.

Pjesa II. **52 tregues produkti**, të grupuar sipas Objektivit Specifik / IPSIS të përafruar për monitorimin në nivel produkti

Shënim: ***Për të gjithë treguesit, vlerat bazë dhe/ose vlerat e synuara të të cilëve nuk janë përcaktuar ende, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet përgjegjëse do të përcaktojnë këto vlera brenda pesë muajve nga miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave. Gjatë kësaj periudhe, do të kryhet puna e nevojshme për të prodhuar, mbledhur dhe standardizuar të dhënat përkatëse të kërkuara për matjen e këtyre treguesve***

PJESA I — Treguesit e rezultateve
TREGUESI I REZULTATIT 1.1.O

1. Treguesi	1.1.O
2. Titulli i treguesit	Përqindja e grupeve të synuara të anketuara (veçanërisht të rinj të grup-moshës 15-24 vjeç) që raportojnë njohuri të përmirësuara mbi rreziqet e krimit të organizuar
2.1 Lloji i treguesit	Rezultati
3. Titulli i dokumentit, Nr., Data e miratimit të SKPLKKOKR dhe PV	VKM për miratimin e strategjisë
4. Lidhja me SKZHIE	Shtylla 8 — Themelet: Qeverisja e Mirë, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës
5. Shtylla	Demokracia, forcimi i institucioneve dhe qeverisja e mirë
6. Qëllimi i Politikës/Objektivi Strategjik në SKZHIE	Transparencë, drejtësi dhe luftë kundër krimit
7. Qëllimi i politikës	Qëllimi i Politikës I: Parandalimi i krimit të organizuar dhe krimeve të rënda
8. Objektivi specifik i lidhur me treguesin	OS 1.1: Rritja e qëndrueshmërisë publike dhe institucionale ndaj krimit të organizuar përmes përmirësimit të ndërgjegjësimit, njohurive dhe angazhimit proaktiv.
9. Burimi/Rëndësia e Treguesit – Lidhja me Acquis Communautaire të BE-së	Strategjia Evropiane për Sigurinë e Brendshme ProtectEU (COM(2025) 148 final); Strategjia e EU për të luftuar krimin e organizuar 2021–2025 (COM/2021/170); Kapitulli 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria) i Acquis
10. Burimi i të dhënave për monitorim	Anketë kombëtarisht përfaqësuese e familjeve e kryer me INSTAT; Raporte vjetore të MPB/Policisë së Shtetit; Të dhëna nga njësitë e vetëqeverisjes vendore pjesëmarrëse;
11. Institucioni(et) përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Punëve të Brendshme – Sekretariati Teknik i SKPLKKOKR/Policia e Shtetit; INSTAT;
12. Përshkrimi i Metodologjisë	Tregues i matur përmes një anketimi kombëtar trevjeçar mbi perceptimet dhe njohuritë për krimin e organizuar, i kryer nga INSTAT sipas metodologjisë së standardizuar, me një kampion përfaqësues të grupeve të synuara (n ≥3,000). Vlera bazë përcaktohet në vitin 2026 me anketimin e parë; progresi matet kundrejt nivelit bazë. I ndarë sipas: gjinisë, grupmoshës, qarkut, statusit socio-ekonomik.
13. Frekuenca e matjes	2027, 2030
14. Natyra e treguesit [Kumulative/Direkte] Prirja (Në rritje/Në rënie/Konstante)]	Kumulative dhe prirja në rritje
15. Të dhëna të drejtpërdrejta ose të përbëra	Të përbëra (e ndarë sipas gjinisë; grupmoshës; qarkut; nivelit të arsimit; statusit socio-ekonomik)

Shënim: ***Për të gjithë treguesit, vlerat bazë dhe/ose vlerat e synuara të të cilëve nuk janë përcaktuar ende, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet përgjegjëse do të përcaktojnë këto vlera brenda pesë muajve nga miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave. Gjatë kësaj periudhe, do të kryhet puna e nevojshme për të prodhuar, mbledhur dhe standardizuar të dhënat përkatëse të kërkuara për matjen e këtyre treguesve***

16. Formula e llogaritjes	**Periudha e raportimit: Periudha vjetore: nuk matet vazhdimisht; raportohet vetëm në vitet e anketimit.** **Llogaritja: Treguesi = (Numri i të anketuarve që raportojnë njohuri të mira ose shumë të mira mbi rreziqet e krimit të organizuar / Numri total i të anketuarve të vlefshëm) × 100, krahasuar me nivelin bazë të vitit 2027**
17. Ndarja e të dhënave për treguesit e përbërë	Sipas: grup-moshës (15–24, 25–34, 35–54, 55+); gjinisë; qarkut; nivelit të arsimit; statusit të socio-ekonomik/punësimit;
18. Përshkrimi i trendit të progresit	Rritje progresive e pritshme prej +30% deri në vitin 2030
19. Vlera bazë	**Viti bazë: 2027** Vlera bazë do të përcaktohet në vitin 2027 *(hera e parë për matjen e këtij treguesi, pa evidenca të mëparshme)*
20. Vlera e synuar (vjetore)	**Objektivat vjetore:** 2026: Instrumentet e anketimit të përgatitura; Identifikimi i burimeve financiare për mbështetjen e realizimit të anketës (buxhetore/projekte/partnerë) nën koordinimin e MPB; 2027: Anketa e përfunduar; 2030: +30% kundrejt vlerës bazë (viti 2027)
21. Vlera bazë aktuale	Nuk disponohet – vlera bazë do përcaktohet në 2027
22. Lidhja me OZHQ (Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm)	OZHQ 16.A

Shënim: ***Për të gjithë treguesit, vlerat bazë dhe/ose vlerat e synuara të të cilëve nuk janë përcaktuar ende, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet përgjegjëse do të përcaktojnë këto vlera brenda pesë muajve nga miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave. Gjatë kësaj periudhe, do të kryhet puna e nevojshme për të prodhuar, mbledhur dhe standardizuar të dhënat përkatëse të kërkuara për matjen e këtyre treguesve***

TREGUESI I REZULTATIT 1.2.O

1. Tregues	1.2.O
2. Titulli i treguesit	Ulja e normës së rasteve të regjistruara të krimit të rëndë dhe të organizuar për 10,000 banorë në qarqet me rrezik të lartë të identifikuara
2.1 Lloji i treguesit	Rezultati
3. Titulli i dokumentit, Nr., Data e miratimit të SKPLKKOKR dhe PV	VKM për miratimin e Strategjisë
4. Lidhja me SKZHIE	Shtylla 8 — Themelet: Qeverisja e Mirë, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës
5. Shtylla	Demokracia, forcimi i institucioneve dhe qeverisja e mirë
6. Qëllimi i Politikës/Objektivi Strategjik në SKZHIE	Transparenca, drejtësia dhe lufta kundër krimit
7. Qëllimi i politikës	Qëllimi i Politikës I: Parandalimi i krimit të organizuar dhe krimeve të rënda
8. Objektivi specifik i lidhur me treguesin	OS 1.2: Reduktimi i cenueshmërisë së komuniteteve me risk duke përmirësuar aksesin në mekanizmat e mbështetjes sociale, ekonomike dhe të riintegrimit.
9. Burimi/Rëndësia e Treguesit – Lidhja me Acquis Communautaire të BE-së	Strategjia Evropiane për Sigurinë e Brendshme ProtectEU (COM(2025) 148 final); Strategjia e EU për të luftuar Krimin e Organizuar 2021–2025 (COM/2021/170); Kapitulli 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria) i Acquis.
10. Burimi i të dhënave për monitorim	Statistikat e krimit të Policisë së Shtetit (Sistemi i Menaxhimit të Çështjes); të dhënat e popullsisë të INSTAT sipas qarqeve; hartëzimi i cenueshmërisë së qarqeve;
11. Institucioni(et) përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	MPB – Ministria e Punëve të Brendshme – Sekretariati Teknik i SKPLKKOKR; Policia e Shtetit – struktura përgjegjëse për statistikat; INSTAT;
12. Përshkrimi i Metodologjisë	Treguesi mat uljen e rasteve të regjistruara të krimit të rëndë dhe të organizuar (drogë, vepra penale të dhunshme të krimit të organizuar, rekrutim, vepra penale të ekonomisë së jashtëligjshme) për 10,000 banorë në qarqet e identifikuara si me rrezik të lartë në hartëzimin vjetor të cenueshmërisë. Të dhënat për krimin nxirren nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjes i Policisë së Shtetit duke përdorur një grup të pandryshueshëm kodesh të veprave penale; të dhënat për popullsinë merren nga vlerësimet e INSTAT në mes të vitit. Vlera bazë është norma e vitit 2025; progresi matet si ndryshim në përqindje kundrejt nivelit bazë.
13. Frekuenca e matjes	Vjetor
14. Natyra e treguesit [Kumulative/Direkte] Prirja (Në rritje/Në rënie/Konstante)]	Direkt, Prirja në rënie
15. Të dhëna të drejtpërdrejta ose të përbëra	I përbërë (norma për njësi të vetëqeverisjes vendore + kumulativ në nivel kombëtar)

Shënim: ***Për të gjithë treguesit, vlerat bazë dhe/ose vlerat e synuara të të cilëve nuk janë përcaktuar ende, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet përgjegjëse do të përcaktojnë këto vlera brenda pesë muajve nga miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave. Gjatë kësaj periudhe, do të kryhet puna e nevojshme për të prodhuar, mbledhur dhe standardizuar të dhënat përkatëse të kërkuara për matjen e këtyre treguesve***

16. Formula e llogaritjes	**Periudha e raportimit: Periudha vjetore** **Llogaritja: Norma = (rastet e identifikuara në veprat penale në fushëveprim / popullsia) × 10,000; agregati = mesatarja e ponderuar sipas popullsisë nëpër qarqet me rrezik të lartë** $$\text{Norma}_i = \left(\frac{\text{Rastet e regjistruara/identifikuara}_i}{\text{Popullsia}_i}\right) \times 10{,}000$$ Ku: • Norma_i= norma e incidenteve për qarqet i • Rastet e regjistruara/identifikuara$_i$= numri i rasteve të regjistruara/të identifikuara nga policia në veprat penale në fushëveprim në qarqe i • Popullsia_i= popullsia e qarkut i
17. Ndarja e të dhënave për treguesit e përbërë	Nga: qarku; lloji i veprës penale; gjinia e viktimës/autorit të veprës; grupmosha
18. Përshkrimi i trendit të progresit	Reduktim gradual i pritshëm prej 15% deri në vitin 2030 kundrejt bazës referuese të vitit 2025
19. Vlera bazë	**Viti bazë: 2025** 2025: 9567 raste gjithsej; 40 raste për 10'000 banorë
20. Vlera e synuar (vjetore)	**Objektivat vjetore:** 2026: Konfirmimi i vlerës bazë; Rifreskimi i hartëzimit; 2027: −3% kundrejt vlerës bazë 2028: −6% kundrejt vlerës bazë 2029: −10% kundrejt vlerës bazë 2030: −15% kundrejt vlerës bazë
21. Vlera bazë aktuale	9567 raste gjithsej; 40 raste për 10'000 banorë
22. Lidhja me OZHQ (Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm)	OZHQ 16.1; OZHQ 11.7;

Shënim: ***Për të gjithë treguesit, vlerat bazë dhe/ose vlerat e synuara të të cilëve nuk janë përcaktuar ende, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet përgjegjëse do të përcaktojnë këto vlera brenda pesë muajve nga miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave. Gjatë kësaj periudhe, do të kryhet puna e nevojshme për të prodhuar, mbledhur dhe standardizuar të dhënat përkatëse të kërkuara për matjen e këtyre treguesve***

TREGUESI I REZULTATIT 1.3.O

1. Tregues	1.3.O
2. Titulli i treguesit	Shkalla e suksesit të mbrojtjes së individëve me risk, përfshirë dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë
2.1 Lloji i treguesit	Rezultati
3. Titulli i dokumentit, Nr., Data e miratimit të SKPLKKOKR dhe PV	VKM për miratimin e strategjisë
4. Lidhja me SKZHIE	Shtylla 8 — Themelet: Qeverisje e Mirë, Demokraci dhe Sundimi i Ligjit
5. Shtylla	Demokracia, forcimi i institucioneve dhe Qeverisja e Mirë
6. Qëllimi i Politikës/Objektivi Strategjik në SKZHIE	Transparenca, drejtësia dhe lufta kundër krimit
7. Qëllimi i politikës	Qëllimi i Politikës I: Parandalimi i krimit të organizuar dhe krimeve të rënda
8. Objektivi specifik i lidhur me treguesin	OS 1.3: Forcimi i sigurisë dhe i mbrojtjes së individët me risk, përfshirë dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë, përmes standardeve të mbrojtjes të harmonizuara me ato të BE-së.
9. Burimi/Rëndësia e Treguesit – Lidhja me Acquis Communautaire të BE-së	Direktiva 2012/29/EU që përcakton standarde minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit; Direktiva 2011/36/EU; Rekomandimi i KE Rec (2005) 9 për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë; Kapitulli 24
10. Burimi i të dhënave për monitorim	Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve (DMD) raportet vjetore; Prokuroria e Përgjithshme; Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
11. Institucioni(et) përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Policia e Shtetit – Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve (DMD);
12. Përshkrimi i Metodologjisë	Tregues rezultati që mat pjesën e personave të pranuar në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve/bashkëpunëtorëve të drejtësisë, të cilët dalin nga programi ose me marrëveshje të ndërsjellë ose me mbarimin e afatit, pa asnjë cenim të sigurisë (i përcaktuar si ekspozim i identitetit, materializim i kërcënimit, ose kontakt i paautorizuar me mjedisin kriminal). Rastet ndiqen mbi një bazë rrëshqitëse; norma vjetore llogaritet për kohortën që del nga programi gjatë vitit.
13. Frekuenca e matjes	Vjetore
14. Natyra e treguesit [Kumulative/Direkte] Prirja (Në rritje/Në rënie/Konstante)]	Direkt, Prirja në rritje/konstante ≥96%
15. Të dhëna të drejtpërdrejta ose të përbëra	Të përbëra (dalje nga programi i mbrojtjes + incidente/thyerje të sigurisë)
16. Formula e llogaritjes	**Periudha e raportimit: Periudha vjetore** **Llogaritja:**

Shënim: ***Për të gjithë treguesit, vlerat bazë dhe/ose vlerat e synuara të të cilëve nuk janë përcaktuar ende, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet përgjegjëse do të përcaktojnë këto vlera brenda pesë muajve nga miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave. Gjatë kësaj periudhe, do të kryhet puna e nevojshme për të prodhuar, mbledhur dhe standardizuar të dhënat përkatëse të kërkuara për matjen e këtyre treguesve***

	Niveli i sigurisë së programeve të mbrojtjes së individëve me risk, përfshirë dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë $= \left(\frac{\text{Dalje nga programi i mbrojtjes pa thyerje/cenim të sigurisë}}{\text{Numri total i daljeve nga programi gjatë vitit raportues}}\right) \times 100$ Ku: • Dalje nga programi i mbrojtjes pa thyerje/cenim të sigurisë = numri i personave të mbrojtur që dalin nga programi i mbrojtjes së dëshmitarëve pa asnjë shkelje të sigurisë gjatë periudhës së raportimit • Daljet totale në vitin raportues = të gjitha daljet e regjistruara gjatë periudhës së raportimit
17. Ndarja e të dhënave për treguesit e përbërë	Sipas: gjinisë; shtetësisë; llojit të programit (dëshmitar, bashkëpunëtor i drejtësisë, viktimë); rajonit
18. Përshkrimi i trendit të progresit	Ruajtja e një norme mbrojtjeje pothuajse afër 100%; përmirësime modeste në afatin kohor të përfundimit
19. Vlera bazë	**Viti bazë: 2025** 2025: ~93%
20. Vlera e synuar (vjetore)	**Objektivat vjetore:** 2026: ≥94%; 2027: ≥95% 2028: ≥96% 2029: ≥96% 2030: ≥96%
21. Vlera bazë aktuale	93%
22. Lidhja me OZHQ (Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm)	OZHQ 16.3; OZHQ 16.A

Shënim: ***Për të gjithë treguesit, vlerat bazë dhe/ose vlerat e synuara të të cilëve nuk janë përcaktuar ende, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet përgjegjëse do të përcaktojnë këto vlera brenda pesë muajve nga miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave. Gjatë kësaj periudhe, do të kryhet puna e nevojshme për të prodhuar, mbledhur dhe standardizuar të dhënat përkatëse të kërkuara për matjen e këtyre treguesve***

TREGUES REZULTATI 1.4.O

1. Tregues	1.4.O
2. Titulli i treguesit	Përqindja e çështjeve të krimit të organizuar të dërguara për gjykim që përfshijnë hetim financiar paralel
2.1 Lloji i treguesit	Rezultati
3. Titulli i dokumentit, Nr., Data e miratimit të SKPLKKOKR dhe PV	VKM për miratimin e strategjisë
4. Lidhja me SKZHIE	Shtylla 8 — Themelet: Qeverisje e Mirë, Demokraci dhe Shteti i së Drejtës
5. Shtylla	Demokracia, forcimi i institucioneve dhe Qeverisja e Mirë
6. Qëllimi i Politikës/Objektivi Strategjik në SKZHIE	Transparenca, drejtësia dhe lufta kundër krimit
7. Qëllimi i politikës	Qëllimi i Politikës I: Parandalimi i krimit të organizuar dhe krimeve të rënda
8. Objektivi specifik i lidhur me treguesin	OS 1.4: Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë
9. Burimi/Rëndësia e Treguesit – Lidhja me Acquis Communautaire të BE-së	Direktiva (EU) 2018/843 (5AMLD); Direktiva (EU) 2024/1640 (6AMLD); Rregullorja (EU) 2024/1624 (AMLR); Rekomandimet e FATF; kuadri i vlerësimit i MONEYVAL; Kapitulli 24 i Acquis; Direktiva 2014/42/EU për bllokimin dhe konfiskimin; Direktiva (EU) 2024/1260 (ripërpunim); Rregullorja (EU) 2018/1805 për njohjen e ndërsjellë të urdhrave të bllokimit dhe konfiskimit; Kapitulli 24
10. Burimi i të dhënave për monitorim	Policia e Shtetit – Drejtoria e Hetimit të Krimit Ekonomik dhe Financiar; SPAK;
11. Institucioni(et) përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Policia e Shtetit; SPAK; Prokuroria e Përgjithshme;
12. Përshkrimi i Metodologjisë	Matja e % së rasteve të krimit të organizuar (rastet nën juridiksionin e SPAK ose të lidhura në thelb me veprimtarinë e grupeve të krimit të organizuar) të dërguara në gjykatë që përfshijnë një dosje të dokumentuar hetimi financiar paralel. Dosja e hetimit financiar duhet të përmbajë hartëzim të pasurive, analizë të flukseve financiare dhe një propozim për bllokim/sekuestro. Numëruesi dhe emëruesi merren nga sistemi i menaxhimit të çështjes së PP duke përdorur shenjuesin e rastit krimit të organizuar dhe shënjuesin e dedikuar të hetimit financiar.
13. Frekuenca e matjes	Vjetor
14. Natyra e treguesit [Kumulative/Direkte] Prirja (Në rritje/Në rënie/Konstante)]	Direkte Prirja (në rritje)
15. Të dhëna të drejtpërdrejta ose të përbëra	Të përbëra
16. Formula e llogaritjes	**Periudha e raportimit: Periudha vjetore**

QP I	1.3	Forcimi i sigurisë dhe i mbrojtjes së individëve me rrezik, përfshirë dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë, përmes standardeve të mbrojtjes të harmonizuara me ato të BE-së	1.3.4	Ofrimi i mbështetjes dhe testimit periodik dhe vjetor psikologjik për personat e përfshirë në programin e mbrojtjes.	1.3.4	Kryerja e vlerësimeve periodike psikologjike dhe e sesioneve të këshillimit, për të monitoruar mirëqenien emocionale, reagimet ndaj traumës dhe nivelet e stresit të personave të mbrojtur. Hartimi i planeve të personalizuara të mbështetjes psikologjike, përfshirë mekanizmat e ndërhyrjes në krizë dhe referimet te profesionistët e specializuar të shëndetit mendor, kur është e nevojshme.	91604AD	Policia e Shtetit		2026	2028	-	
QP I	1.3	Forcimi i sigurisë dhe i mbrojtjes së individëve me rrezik, përfshirë dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë, përmes standardeve të mbrojtjes të harmonizuara me ato të BE-së	1.3.5	Rehabilitimi social i personave të përfshirë në programin e mbrojtjes me Vendim të Komisionit për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.	1.3.5	Realizimi i programeve të strukturuara të rehabilitimit, që përfshijnë zhvillimin e aftësive sociale, mbështetjen familjare dhe rrugët e riintegrimit komunitar, të përshtatura me nevojat individuale. Koordinimi me ofruesit e shërbimeve sociale, bashkitë dhe shoqërinë civile, për të siguruar strehim, arsim, kujdes shëndetësor dhe rrjete mbështetëse me bazë komunitare.	91604AD	Policia e Shtetit		2026	2028	-	
QP I	1.3	Forcimi i sigurisë dhe i mbrojtjes së individëve me rrezik, përfshirë dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë, përmes standardeve të mbrojtjes të harmonizuara me ato të BE-së	1.3.6	Ofrimi i ndihmës financiare për personat e përfshirë në programin e mbrojtjes me Vendim të Komisionit për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.	1.3.6	Alokimi dhe menaxhimi i paketave të mbështetjes financiare, që mbulojnë shpenzimet bazë të jetesës, nevojat emergjente dhe kostot e riintegrimit, për individët në programin e mbrojtjes. Rishikime periodike të ndihmës financiare për të siguruar mjafueshmëri, transparencë dhe harmonizim me nevojat e ndryshueshme të personave të mbrojtur.	91604AD	Policia e Shtetit		2026	2028	-	
QP I	1.3	Forcimi i sigurisë dhe i mbrojtjes së individëve me rrezik, përfshirë dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë, përmes standardeve të mbrojtjes të harmonizuara me ato të BE-së	1.3.7	Ofrimi i rikualifikimeve profesionale, me qëllim integrimin pas përfundimit të programit të mbrojtjes, për personat e përfshirë në programin e mbrojtjes me Vendim të Komisionit për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.	1.3.7	Përgatitja dhe zbatimi i programeve të trajnimit profesional dhe të zhvillimit të aftësive, të përshtatura me nevojat e tregut të punës dhe profilet personale të personave të mbrojtur. Mbështetje për punësim, përfshirë këshillimin e karrierës, angazhimin e punëdhënësve dhe referimin te shërbimet e punësimit për të siguruar riintegrim të qëndrueshëm.	91604AD	Policia e Shtetit		2026	2028	-	
QP I	1.3	Forcimi i sigurisë dhe i mbrojtjes së individëve me rrezik, përfshirë dëshmitarët, bashkëpunëtorët e drejtësisë, përmes standardeve të mbrojtjes të harmonizuara me ato të BE-së	1.3.8	Ofrimi i këshillimit dhe ndihmës ligjore të specializuar për personat e përfshirë në programin e mbrojtjes me Vendim të Komisionit për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.	1.3.8	Ofrimi i këshillimit të vazhdueshëm ligjor për personat e mbrojtur mbi të drejtat, detyrimet dhe aspektet procedurale të bashkëpunimit gjyqësor, duke siguruar njesëmarrje të informuar në procedime. Ofrimi i përfaqësimit ligjor të specializuar dhe mbështetjes gjatë proceseve gjyqësore, procedurave administrative dhe çështjeve	91604AD	Policia e Shtetit		2026	2028	-	

						ligjore të lidhura me riintegrimin.							
Nëntotali — OS 1.3												**-**	
OS 1.4 — Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë													
QP I	1.4	Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë.	1.4.1	Reformimi i Policisë Kriminale përmes modernizimit të strukturës organizative, përmirësimit të kapaciteteve teknologjike, trajnimit, zhvillimit profesional të personelit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, përfshirë zbatimin e dispozitave të ligjit të ri nr. 82/2024 për Policinë e Shtetit.	1.4.1	Zbatimi i masave të ristrukturimit organizativ dhe modernizimit që kërkon Ligji nr. 82/2024, përfshirë rolet e përditësuara funksionale, strukturat e thjeshtuara të komandimit dhe mekanizmat e përmirësuar të llogaridhënies së brendshme. Modernizimi i kapaciteteve teknologjike (si mjetet e hetimit digjital, sistemet e komunikimit të sigurt dhe platformat analitike) dhe ofrimi i programeve të vazhdueshme të zhvillimit profesional të harmonizuara me standardet e policisë në BE.	91604AD	Policia e Shtetit	Ministria e Punëve të Brendshme	2026	2028	-	
QP I	1.4	Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë.	1.4.2	Rritja e kapaciteteve hetimore kundër të gjitha formave të krimit të organizuar (në veçanti krimit ekonomik dhe financiar, krimit kibernetik, hetimit financiar, identifikimit dhe sekuestrimit të aseteve), përmes trajnimeve të avancuara, futjes dhe përdorimit të vazhdueshëm të teknologjive moderne, forcimit të kapaciteteve teknike, financiare, dhe infrastrukturore, përdorimit të inteligjencës kriminale, dhe bashkëpunimit e shkëmbimit të informacionit me partnerët ndërkombëtarë.	1.4.2	Ofrimi i programeve të avancuara të trajnimit mbi krimin ekonomik dhe financiar, hetimin e krimit kibernetik, profilizimin financiar dhe teknikat e gjurmimit të aseteve, duke siguruar zbatim të metodologjive moderne nga ana e hetuesve. Zgjerimi i përdorimit të inteligjencës kriminale, kriminalistikës digjitale dhe mjeteve analitike, dhe forcimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për të mbështetur hetime komplekse ndërkufitare.	91604AR	Policia e Shtetit	Ministria e Punëve të Brendshme	2026	2028	-	
QP I	1.4	Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë.	1.4.3	Rekrutimi punonjësve për shërbimin e policisë gjyqësore, në përputhje me nevojat operacionale të identifikuara dhe boshllëqet e prioritizuara të aftësive.	1.4.3	Kryerja e vlerësimeve të nevojave për të identifikuar boshllëqet operacionale dhe fushat prioritare ku kërkohet personel shtesë të policisë gjyqësore. Zbatimi i proceseve transparente të rekrutimit për të garantuar përzgjedhjen e kandidatëve të kualifikuar me aftësitë e nevojshme për funksionet e specializuara hetimore.	91601AB	Byroja Kombëtare e Hetimit		2026	2028	-	
QP I	1.4	Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë.	1.4.4	Profilizimi i programeve të Akademisë së Sigurisë dhe arsimimi/trajnimi i punonjësve të Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë përmes përditësimit të kurrikulave dhe ofrimit të moduleve të specializuara të Akademisë së Sigurisë.	1.4.4	Përditësimi i kurrikulave të Akademisë së Sigurisë, duke futur module të specializuara mbi krimin e organizuar, hetimin financiar, krimin kibernetik dhe policimin e udhëhequr nga inteligjenca. Ofrimi i cikleve të vazhdueshme të trajnimit për punonjësit e Policisë së Shtetit, duke siguruar harmonizim me tendencat evoluese të krimit, standardet e BE-së dhe nevojat operacionale.	91604AM	Policia e Shtetit/Akademia e Sigurisë		2026	2028	-	
QP I	1.4	Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë.	1.4.5	Trajnimi i oficerëve të policisë gjyqësore për hetimin financiar paralel me hetimin penal, për veprat parësore që gjenerojnë të ardhura kriminale.	1.4.5	Ofrimi i trajnimeve të specializuara për kryerjen e hetimeve financiare krahas hetimeve të veprave penale parësore, përfshirë gjurmimin e aseteve, analizën financiare dhe mbledhjen e provave. Përgatitja e procedurave standarde operacionale dhe e ushtrimeve praktike të çështjeve, për të siguruar zbatim konsistent të teknikave të hetimit paralel financiar.	91604AM	Policia e Shtetit	Prokuroria e Përgjithshme; Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Byroja Kombëtare e Hetimit;	2026	2028	-	
QP I	1.4	Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë.	1.4.6	Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe efikasitetin e hetimit dhe ndjekjeve të veprave penale.	1.4.6	Rekrutimi i prokurorëve shtesë të specializuar, analistë dhe personel mbështetës, për të forcuar aftësinë e SPAK-ut, si dhe të hetuesve dhe oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore në Byronë Kombëtare të hetimit, me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale për hetimin dhe ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në kuadër të zbatimit të strukturës së re organizative, BKH-ja parashikohet të rekrutojë 40 hetues dhe 40 oficerë të shërbimeve të policisë gjyqësore. Prokurimi i teknologjive të avancuara hetimore, sistemeve digjitale të sigurta dhe mjeteve analitike dhe pajisjeve në funksion të pavarësisë operacionale, për të rritur efikasitetin operacional të SPAK-ut dhe kapacitetet për trajtimin e çështjeve.	94101AB	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;		2026	2028	-	
QP I	1.4	Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë.	1.4.7	Rritja kapaciteteve hetimore dhe analitike (njerëzore dhe teknike) të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe efikasitetin e hetimit dhe ndjekjeve të veprave penale.	1.4.7	Ngritja e skuadrave analitike shumëdisiplinore, të pajisura me mjete moderne për analizën e të dhënave, skicimin e lidhjeve, profilizimin financiar dhe përpunimin e provave digjitale. Ofrimi i trajnimit të vazhdueshëm për hetuesit dhe analistët e SPAK-ut mbi ndërtimin e çështjeve komplekse, shfrytëzimin e inteligjencës dhe mekanizmat e bashkëpunimit ndërkombëtar.	91604AB; 91604AR	Policia e Shtetit		2026	2028	-	
QP I	1.4	Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë.	1.4.8	Operacionalizimi plotë i sistemit *e-Presto,* për të cilin masat administrative paraprake për zhvillimin teknologjik kanë përfunduar, ndërkohë që prokurorët e prokurorive të përgjithshme finalizojnë dhe përditësojnë çështjet dhe seksionet përkatëse.	1.4.8	Përfundimi i hedhjes së të dhënave, përditësimeve të çështjeve dhe popullimit të seksioneve nga prokurorët në zyrat me juridiksion të përgjithshëm, për të siguruar funksionalitet të plotë të sistemit *e-Presto*. Ofrimi i trajnimit dhe mbështetjes teknike për prokurorët dhe personelin administrativ, për të siguruar përdorim konsistent të sistemit për menaxhimin dhe	19Ah805	Prokuroria e Përgjithshme		2026	2026	3,738,600	Misioni Euralius

						raportimin e çështjeve.							
QP I	1.4	Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë.	1.4.9	Operacionalizimi plotë i i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve në Prokurorinë e Përgjithshme.	1.4.9	Finalizimi i integrimit të sistemit, aksesit të përdoruesit dhe migrimit të të dhënave, për të mundësuar përdorim të plotë operacional të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve në Prokurorinë e Përgjithshme. Ofrimi i trajnimit për prokurorët dhe personelin administrativ mbi funksionalitetet e SMÇ-së, që të përmirësohet cilësia e të dhënave, gjurmimi i çështjeve dhe alokimi i burimeve bazuar në evidenca.	92801AA	Prokuroria e Përgjithshme	Policia e Shtetit/Akademia e Sigurisë; Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;	2026	2028	723,750,000	Financim i plotë nga Bashkimi Evropian: Procesi i vlerësimit të nevojave tani ka përfunduar dhe është në fazën e analizës, fazat që i paraprijnë fazës së tenderimit të firmës që do të bëjë programimin. Nuk ka një vlerë të caktuar për sistemin, por financimi do të mbështetet plotësisht nga BE, përmes projektit EU4Digital Justice të zbatuar nga UNOPS dhe të financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të IPA III me një buxhet prej 7.5 milionë eurosh për të gjithë sistemin e drejtësisë, ku në terma tregues parashikohet që rreth 2.5 milionë euro do të merren për zbatimin e këtij sistemi në Prokurorinë Publike për një periudhë zbatimi prej 48 muajsh.
QP I	1.4	Rritja e profesionalizmit, kapacitetit teknologjik dhe efikasitetit operacional të institucioneve ligjzbatuese dhe të drejtësisë.	1.4.10	Operacionalizimi plotë i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.	1.4.10	Instalimi, konfigurimi dhe funksionimi i sigurt i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve brenda SPAK-ut, përfshirë integrimin me mjetet hetimore dhe analitike. Ofrimi i trajnimit të specializuar për prokurorët dhe personelin e SPAK-ut për të maksimizuar përdorimin e sistemit për menaxhimin e çështjeve komplekse, monitorimin e performancës dhe planifikimin strategjik	94101AB	Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	Policia e Shtetit, Byroja Kombëtare e Hetimit, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë;	2026	2026	-	Pritet konfirmimi i financimit nga UNOPS.
Nëntotali — OS 1.4												**727,488,600**	
OS 1.5 — Reduktimi i stimujve dhe mundësive financiare për krimin e organizuar nëpërmjet forcimit të kontrolleve ekonomike dhe ndërprerjes së burimeve të financimit													
QP I	1.5	Reduktimi i stimujve dhe mundësive financiare për krimin e organizuar nëpërmjet forcimit të kontrolleve ekonomike dhe ndërprerjes së burimeve të financimit.	1.5.1	Kryerja e vlerësimit kombëtar të kërcënimeve nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda.	1.5.1	Kryerja e një vlerësim gjithëpërfshirës kombëtar të kërcënimeve, duke integruar inteligjencën ligjzbatuese, të dhënat e sektorit financiar dhe treguesit specifikë sektorialë të rrezikut, për të identifikuar tregjet kriminale, tendencat në zhvillim dhe sektorët me rrezik të lartë. Përgatitja e një raport analitik me kërcënimet e prioritizuara, masat zbutëse të rekomanduara dhe inteligjencën që orienton veprimet, me qëllim që të udhëheqë planifikimin operacional dhe alokimin e burimeve nëpër institucione.	91603AA	Ministria e Punëve të Brendshme	Ministritë relevante të linjës; Policia e Shtetit, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Shërbimi Informativ i Shtetit, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, Prokuroria e Përgjithshme; Prokuroria e Posaçme; Byroja Kombëtare e Hetimit;	2026	2028	-	
QP I	1.5	Reduktimi i stimujve dhe mundësive financiare për krimin e organizuar nëpërmjet forcimit të kontrolleve ekonomike dhe ndërprerjes së burimeve të financimit.	1.5.2	Rritja e kontrolleve të bazuara në rrezik, të kryera kundër informalitetit, evazionit fiskal dhe shmangies tatimore	1.5.2	Zbatimi i inspektimeve dhe auditime të shënjestruara të bazuara në rrezik, në sektorët me ekspozim të lartë ndaj informalitetit dhe evazionit fiskal, duke përdorur analitikë të të dhënave dhe shkëmbim ndërinstitucional të informacionit për të prioritizuar çështjet. Forcimi i zbatueshmërisë duke integruar rezultatet e inteligjencës financiare, treguesit e transaksioneve të dyshimta dhe profilet specifike sektoriale të rrezikut në planifikimin e inspektimeve dhe procedurat vijuese.	91004AA	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Policia e Shtetit	2026	2028	-	
QP I	1.5	Reduktimi i stimujve dhe mundësive financiare për krimin e organizuar nëpërmjet forcimit të kontrolleve ekonomike dhe ndërprerjes së burimeve të financimit.	1.5.3	Forcimi i kontrolleve dhe inspektimeve të koordinuara dhe inspektimeve te bizneset me rrezik të lartë.	1.5.3	Ngritja e skuadrave të përbashkëta të inspektimit/kontrollit/mbikëqyrje s, që përfshijnë autoritetet mbikëqyrëse në fushën e PPP/FT, autoritetet doganore dhe tatimore, autoritetet licencuese, për të kryer kontrolle të koordinuara të bizneseve me rrezik të lartë, duke siguruar zbatim konsistent dhe dublikim të reduktuar, sipas fushës së përgjegjësisë. Zhvillimi dhe zbatimi i mjeteve specifike sektoriale të vlerësimit të rrezikut, për të identifikuar bizneset me ekspozim të shtuar ndaj infiltrimit të krimit të organizuar, duke mundësuar ndërhyrje të hershme dhe mbikëqyrje të bazuar në risk.	91004AA	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Policia e Shtetit	2026	2028	-	
QP I	1.5	Reduktimi i stimujve dhe mundësive financiare për krimin e organizuar nëpërmjet forcimit të kontrolleve ekonomike dhe ndërprerjes së burimeve të financimit.	1.5.4	Monitorimi i mallrave me rrezik të lartë mallrave të cenueshme ndaj evazionit fiskal	1.5.4	Monitorimi sistematik i mallrave me rrezik të lartë, si karburanti, duhani, alkooli dhe produktet e akcizës, duke përdorur sistemet digitale të gjurmimit, të dhënat doganore dhe profilizimin e bazuar në rrezik. Kryerja e veprimeve të përbashkëta operacionale për të zbuluar parregullsitë në zinxhirët e importit, eksportit dhe shpërndarjes, duke siguruar referim në kohë të rasteve të dyshimta për hetim dhe ndjekje financiare.	91005AA	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Policia e Shtetit	2026	2028	-	
Nëntotali — OS 1.5												**-**	
OS 1.6 — Zbatimi efikas i qasjes administrative për të parandaluar infiltrimin e krimit të organizuar në ekonomi dhe në administratën publike													
QP I	1.6	Zbatimi efektshëm i qasjes administrative për të parandaluar infiltrimin e krimit të organizuar në ekonomi dhe në administratën publike.	1.6.1	Hartimi i Udhëzuesit Kombëtar për Qasjen Administrative ndaj Krimit të Organizuar	1.6.1	Hartimi i Udhëzuesit Kombëtar duke konsoliduar praktikat më të mira të BE-së (ENAA), legjislacionin kombëtar dhe mandatet institucionale, si dhe duke vendosur procedura të qarta për parandalimin, shkëmbimin e informacionit dhe zbutjen e riskut administrativ. Kryerja e konsultimeve ndërinstitucionale me autoritetet ligjzbatuese dhe tatimore, doganat, inspektoratet, qeverisjen vendore dhe shoqërinë civile, për të konsoliduar Udhëzuesin dhe për të siguruar zbatueshmëri praktike nëpër sektorë.	91601AA	Ministria e Punëve të Brendshme	Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes; Agjencia e Inteligjencës Financiare; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Kontrolli i Lartë i Shtetit; Bashkitë	2026	2026	791,300	Projekti "Promovimi i përdorimit sistematik të qasjes administrative për të luftuar krimin e organizuar në Shqipëri" i financuar nga Fondi Bullgar i Zhvillimit dhe i zbatuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes
QP I	1.6	Zbatimi efektshëm i qasjes administrative për të parandaluar infiltrimin e krimit të organizuar në ekonomi dhe në administratën publike.	1.6.2	Ngritja e një rrjeti ndërinstitucional për zbatimin e qasjes administrative, që përfshin të gjitha agjencitë me kompetenca inspektimi dhe licencimi, për shkëmbimin e të	1.6.2	Formalizimi i rrjetit ndërinstitucional përmes memorandumeve të bashkëpunimit, duke përcaktuar role, përgjegjësi, protokolle të shkëmbimit të të dhënave dhe procedura të sinjalizimit të rrezikut midis të gjitha organeve të inspektimit dhe licencimit.	91601AA	Ministria e Punëve të Brendshme	Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes; Agjencia e Inteligjencës Financiare; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Kontrolli i	2026	2026	181,420	Projekti "Promovimi i përdorimit sistematik të qasjes administrative për të luftuar krimin e organizuar në Shqipëri" i financuar nga Fondi Bullgar i Zhvillimit dhe i zbatuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes

				dhënave dhe sinjalizimin e rrezikut.		Ngritja dhe vënia në punë e një platformë të sigurt për ndarjen e informacionit, e cila mundëson shkëmbim në kohë reale të të dhënave administrative, sinjalizimeve dhe tregues të rrezikut, midis institucioneve pjesëmarrëse.			Lartë i Shtetit; Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit; ASIG; Bashkitë				
QP I	1.6	Zbatimi efektshëm i qasjes administrative për të parandaluar infiltrimin e krimit të organizuar në ekonomi dhe në administratën publike.	1.6.3	Ngritja e mekanizmave të verifikimit të integritetit për operatorët ekonomikë që marrin pjesë në tenderë publikë, licenca, ose subvencione shtetërore, përmes filtrave të bazuar në të dhëna administrative.	1.6.3	Miratimi dhe zbatimi i filtrave administrativë të integritetit, bazuar në të dhënat tatimore, historikun e licencimit, konstatimet e inspektimeve, informacionin për pronësinë përfituese dhe sinjalizimet e autoriteteve ligjzbatuese, me qëllim skanimin e operatorëve ekonomikë përpara se të merren vendimet publike. Integrimi i procedurave të verifikimit të integritetit në praktikat e prokurimit, licencimit dhe subvencionit, duke siguruar që operatorët me rrezik të lartë të sinjalizohen, rishikohen ose përjashtohen në përputhje me dispozitat ligjore.	91601AA	Ministria e Punëve të Brendshme	Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes; Agjencia e Inteligjencës Financiare; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Kontrolli i Lartë i Shtetit; Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit; ASIG; Bashkitë	2026	2026	540,400	Projekti "Promovimi i përdorimit sistematik të qasjes administrative për të luftuar krimin e organizuar në Shqipëri" i financuar nga Fondi Bullgar i Zhvillimit dhe i zbatuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes
QP I	1.6	Zbatimi efektshëm i qasjes administrative për të parandaluar infiltrimin e krimit të organizuar në ekonomi dhe në administratën publike.	1.6.4	Trajnimi i zyrtarëve të administratës publike dhe vendore mbi qasjen administrative, menaxhimin e rrezikut dhe parandalimin e infiltrimit kriminal në vendimmarrjen administrative.	1.6.4	Trajnimi i zyrtarëve të administratës publike dhe vendore mbi qasjen administrative, menaxhimin e rrezikut dhe parandalimin e infiltrimit kriminal.	91601AA	Ministria e Punëve të Brendshme	Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes; Shkolla Shqiptare e Administratës Publike; Ministria e Financave; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Bashkitë	2026	2026	518,688	Projekti "Promovimi i përdorimit sistematik të qasjes administrative për të luftuar krimin e organizuar në Shqipëri" i financuar nga Fondi Bullgar i Zhvillimit dhe i zbatuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes
Nëntotali — OS 1.6												**2,031,808**	
QËLLIMI POLITIK II — NDJEKJA PENALE DHE GODITJA E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA													
OS 2.1 — Reduktimi i disponueshmërisë, prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve përmes forcimit të zbulimit, hetimit dhe koordinimit ndërinstitucional.													
QP II	2.1	Reduktimi i disponueshmërisë, prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve përmes forcimit të zbulimit, hetimit dhe koordinimit ndërinstitucional.	2.1.1	Goditja në fushën e narkotikëve përmes operacioneve të zbulimit të udhëhequra nga inteligjenca dhe teknologjia, përfshirë përdorimin sistematik të inteligjencës kriminale, mjeteve analitike, kapaciteteve të mbikëqyrjes dhe veprimeve operacionale të synuara për të identifikuar, ndërpreré dhe shkatërruar rrjetet kriminale të lidhura me drogën.	2.1.1	Forcimi i operacioneve të zbulimit të udhëhequra nga inteligjenca dhe teknologjia, duke kryer veprime të shënjestruara bazuar në inteligjencën kriminale, mjetet analitike dhe kapacitetet e mbikëqyrjes, me qëllim identifikimin dhe goditjen e rrjeteve të lidhura me drogën. Përmirësimi i efektivitetit operacional përmes instalimit, të koordinuar dhe të bazuar në rrezik, të sistemeve të zbulimit teknologjik si skanerët, dronet dhe njësitë mobile të mbikëqyrjes në zonat me rrezik të lartë, me qëllim mbështetjen e ndërhyrjeve proaktive.	91604AA	Policia e Shtetit	Prokuroria e Përgjithshme; Policia Ushtarake; Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes; Shërbimi Informativ i Shtetit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;	2026	2028	-	
QP II	2.1	Reduktimi i disponueshmërisë, prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve përmes forcimit të zbulimit, hetimit dhe koordinimit ndërinstitucional.	2.1.2	Përditësimi dhe mirëmbajtja i bazës së veçantë të të dhënave për kultivimin e bimëve narkotike me informacion nga të gjitha burimet e mundshme të brendshme dhe të jashtme, përfshirë raportimin e autoriteteve ligjzbatuese, konstatimet e monitorimit në distancë, informacionin gjyqësor dhe kontributet e partnerëve ndërkombëtarë, për të mbështetur analizën e rrezikut, synimin dhe planifikimin operacional.	2.1.2	Përditësimi i vazhdueshëm i bazës së veçantë të të dhënave për kultivimin e bimëve narkotike, duke integruar informacion nga raportimet e autoriteteve ligjzbatuese, monitorimi në distancë, të dhënat gjyqësore dhe partnerët ndërkombëtarë. Përgatitja e përmbledhjeve analitike periodike nga baza e të dhënave, për të mbështetur analizën e rrezikut, planifikimin operacional dhe identifikimin e hershëm të tendencave të reja të kultivimit.	91604AA	Policia e Shtetit		2026	2028	-	
QP II	2.1	Reduktimi i disponueshmërisë, prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve përmes forcimit të zbulimit, hetimit dhe koordinimit ndërinstitucional.	2.1.3	Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe efikasitetit me agjencitë e ligjzbatuese, si Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, BKH-ja dhe Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm, përmes aktiviteteve periodike të përbashkëta për çështje specifike, me qëllim operacionet e përbashkëta kundër krimit të organizuar që synojnë rritjen e zbulimit, hetimit dhe ndjekjes penale të veprave penale përfshirë përmes protokolleve të bashkëpunimit, planifikimit të koordinuar operacional, dhe trajnimeve të përbashkëta.	2.1.3	Organizimi i takimeve periodike të koordinimit, seminareve tematike dhe sesioneve të përbashkëta të planifikimit me SPAK-un, BKH-në dhe prokurorët me juridiksion të përgjithshëm, me qëllim forcimin e bashkëpunimit operacional. Hartimi dhe zbatimi i protokolleve të bashkëpunimit dhe moduleve të trajnimit të përbashkëta, të cilat rrisin shkëmbimin e informacionit, hetimet e koordinuara dhe veprimet operacionale ndërinstitucionale.	91604AA	Policia e Shtetit	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Byroja Kombëtare e Hetimit; Prokuroria e Përgjithshme	2026	2028	-	
QP II	2.1	Reduktimi i disponueshmërisë, prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve përmes forcimit të zbulimit, hetimit dhe koordinimit ndërinstitucional.	2.1.4	Rritja e hetimeve proaktive të veprave penale në fushën e narkotikëve me qëllim parandalimin dhe goditjen e aktiviteteve kriminale, përfshirë përmes nisjes së çështjeve të bazuara në inteligjencë, zbatimit të teknikave proaktive të hetimit special dhe prioritizimit të hetimeve që synojnë organizatorët, lehtësuesit, logjistikën dhe të ardhurat nga krimi.	2.1.4	Nisja e hetimeve proaktive, të bazuara në inteligjencë, që synojnë organizatorët, lehtësuesit dhe mundësuesit logjistikë të trafikimit të narkotikëve. Zbatimi i teknikave të posaçme të hetimit, si dhe prioritizimi i rasteve me elemente ndërkufitare ose me të ardhura të konsiderueshme financiare, me qëllim goditjen e strukturave kriminale me vlerë të lartë.	91604AA	Policia e Shtetit	Prokuroria e Përgjithshme;	2026	2028	-	
QP II	2.1	Reduktimi i disponueshmërisë, prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve përmes forcimit të zbulimit, hetimit dhe koordinimit ndërinstitucional.	2.1.5	Monitorimi dhe kontrolli i territorit për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike, përfshirë përmes kontrolleve të koordinuara në terren, monitorimit ajror dhe teknologjik, planifikimit të patrullave të bazuar	2.1.5	Kryerja e inspektimeve të koordinuara në terren dhe e patrullimeve në zonat me risk të lartë, për parandalimin dhe zbulimin e kultivimit të bimëve narkotike. Instalimi i mjeteve të monitorimit ajror dhe teknologjik, si dhe miratimi i mekanizmave të	91604AA 91604AR	Policia e Shtetit	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit; Shërbimi Informativ i Shtetit; Policia Ushtarake;	2026	2028	-	

				në rrezik dhe veprimeve të reagimit të shpejtë për identifikimin, verifikimin dhe eliminimin e zonave të dyshuara të kultivimit.		reagimit të shpejtë, për verifikimin dhe eliminimin e vendndodhjeve të dyshuara të kultivimit.							
QP II	2.1	Reduktimi i disponueshmërisë, prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve përmes forcimit të zbulimit, hetimit dhe koordinimit ndërinstitucional.	2.1.6	Forcimi i kapaciteteve dhe procedurave për shkëmbimin e informacionit mbi Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm për lëndet e reja psikotrope (NPS), me qëllim rritjen e koordinimit institucional dhe efikasitetit në identifikimin dhe përgjigjen ndaj NPS, përfshirë përmes rrugëve të qarta të raportimit, bashkëpunimit laboratorik dhe flukseve të strukturuara të informacionit me partnerët përkatës kombëtarë dhe ndërkombëtarë.	2.1.6	Forcimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm, duke vendosur praktika të qarta raportimi dhe flukse të strukturuara informacioni për substancat e reja psikotrope të identifikuara. Përmirësimi i bashkëpunimit laboratorik dhe pjesëmarrja në shkëmbimet ndërkombëtare të EWS-së, për të siguruar identifikim në kohë, vlerësim dhe shpërndarje të sinjalizimeve për substancat e reja.	91301AA; 91604AA	Policia e Shtetit	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; ISHP; AKBPM; Observatori Kombëtar për Drogat; ZSKD; AKPB;MSHMS; QSUT; AKKC; Ministria e Punëve të Brendshme; Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm/PSH; Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; Ministria e Arsimit; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Mjedist; Prokuroria e Përgjithshme; Shërbimi Informativ i Shtetit; Organizatat joqeveritare që veprojnë në fushën e drogave dhe shëndetit publik; EUDA;	2027	2028	-	
QP II	2.1	Reduktimi i disponueshmërisë, prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve përmes forcimit të zbulimit, hetimit dhe koordinimit ndërinstitucional.	2.1.7	Rritja e kapaciteteve teknologjike për shkatërrimin e sigurt dhe mjedisor neutral të substancave narkotike dhe psikotrope, përfshirë përmes përmirësimit të infrastrukturës dhe pajisjeve përkatëse, zbatimit të standardeve të sigurisë dhe mjedisit dhe sigurimit të procedurave të gjurmueshme për ruajtjen, transportin dhe shkatërrimin.	2.1.7	Modernizimi i infrastrukturës, pajisjeve dhe procedurave për shkatërrimin e sigurt, të gjurmueshëm dhe në pajtim me mjedisin të substancave narkotike dhe psikotrope. Trajnimi i personelit të specializuar mbi protokollet e trajtimit të sigurt, ruajtjen, transportin dhe shkatërrimin, për të siguruar respektim të plotë të standardeve të sigurisë dhe mjedisit.	90604AR	Policia e Shtetit		2026	2028	-	
QP II	2.1	Reduktimi i disponueshmërisë, prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve përmes forcimit të zbulimit, hetimit dhe koordinimit ndërinstitucional.	2.1.8	Koordinimi dhe mbështetja e zbatimit të projektit "Horizon Europe - Cluster 3, Civil Security for Society", në fushën e zbulimit, identifikimit dhe gjurmimit të shpejtë dhe novator të farave dhe bimëve të kanabisit në kufirin doganor, përfshirë përmes koordinimit ndërinstitucional, testimit operacional dhe integrimit të produkteve të projektit në praktikat e kontrollit kufitar.	2.1.8	Koordinimi i zbatimit kombëtar të projektit "Horizon Europe - Cluster 3", duke lehtësuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe testimin operacional të teknologjive të zbulimit në dogana. Integrimi i produkteve të verifikuara të projektit në praktikat e kontrollit kufitar, si dhe raportimi i progresit te palët e interesuara kombëtare dhe ndërkombëtare.	0745091305AK	Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Canabisit	Ministria e Punëve të Brendshme/Policia e Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	2026	2028	-	
QP II	2.1	Reduktimi i disponueshmërisë, prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve përmes forcimit të zbulimit, hetimit dhe koordinimit ndërinstitucional.	2.1.9	Ndryshimi i Ligjit nr. 8874, date 29.3.2002 "Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope", me qëllim harmonizimin e plotë me *Acquis* të BE-së në këtë fushë, përfshirë harmonizimin e përkufizimeve, masave të kontrollit, përgjegjësive të mbikëqyrjes dhe dispozitave sanksionuese.	2.1.9	Realizimi i një analize të boshllëqeve ligjore të ligjit nr. 8874 përkundër *Acquis* të BE-së dhe standardeve ndërkombëtare, duke identifikuar ndryshimet e kërkuara. Hartimi dhe konsultimi i ndryshimeve ligjore të propozuara, duke siguruar harmonizimin e përkufizimeve, masave të kontrollit, përgjegjësive të mbikëqyrjes dhe sanksioneve.	91301AA	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	Ministria e Punëve të Brendshme/Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme	2026	2026	-	
QP II	2.1	Reduktimi i disponueshmërisë, prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve përmes forcimit të zbulimit, hetimit dhe koordinimit ndërinstitucional.	2.1.10	Identifikimi dhe trajtimi i rasteve të devijimit nga sasitë e kanabisit të mbjellë, të identifikuara përmes mbikëqyrjes dhe monitorimit të zbatimit të lejeve ose licencave, përfshirë verifikimin e vendimeve për shkatërrimin e kultivimit të paautorizuar, dhe zbatimin e sanksioneve administrative dhe/ose penale, sipas rastit.	2.1.10	Monitorimi i përditësimeve të BE-së për substancat e kontrolluara dhe substancat e reja psikoaktive (NPS) dhe përgatitja e propozimeve për përfshirjen në kohë të substancave të reja në planet kombëtare. Konsultimi me laboratorët, autoritetet shëndetësore dhe ligjzbatuese, për të konsoliduar përditësimet dhe për të siguruar shpërndarjen e listave të rishikuara.	0745091305AK	Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Canabisit	Policia e Shtetit;Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	2026	2028	-	
QP II	2.1	Reduktimi i disponueshmërisë, prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve përmes forcimit të zbulimit, hetimit dhe koordinimit ndërinstitucional.	2.1.11	Shkëmbimi informacionit të mbledhur sipas Ligjit nr. 61/2023 me autoritetet përgjegjëse, me qëllim identifikimin e prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, përfshirë pastrimin e të ardhurave nga aktivitetet e paligjshme të lidhura me lëndët narkotike, duke siguruar ndjekje operacionale të koordinuar dhe referim në kohë të rasteve përkatëse.	2.1.11	Miratimi i mekanizmave të strukturuar për shkëmbimin e informacionit të mbledhur sipas Ligjit nr. 61/2023 me autoritetet përgjegjëse. Analizimi i të dhënave të ndara për identifikimin e prodhimit të paligjshëm, trafikimit dhe pastrimit të parave të lidhura me to, si dhe referimi i rasteve për ndjekje operacionale.	0745091305AK	Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Canabisit	Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Prokuroria e Përgjithshme;Byroja Kombëtare e Hetimit; Policia e Shtetit	2027	2028	-	
Nëntotali — OS 2.1												-	
OS 2.2 — Reduktimi i ndjeshëm i trafikimit, duke rritur zbulimin, goditjen e rrjeteve kriminale dhe forcimin e kontrolleve kufitare dhe kapaciteteve hetimore.													
QP II	2.2	Reduktimi i ndjeshëm i trafikimit, duke rritur zbulimin, goditjen e rrjeteve kriminale dhe forcimin e kontrolleve kufitare dhe hetimore.	2.2.1	Rritja e aktivitetit hetimor për parandalimin e trafikimit të paligjshëm bazuar në inteligjencën dhe provat e disponueshme, përfshirë përmes zbatimit të metodave të posaçme hetimore, përdorimit sistematik të teknologjisë dhe mjeteve analitike, dhe një qasjeje proaktive që synon rrjetet e krimit të organizuar si dhe	2.2.1	Kryerja e hetimeve proaktive, të udhëhequra nga inteligjenca, që synojnë rrjetet e organizuara kriminale të përfshira në trafikimin e personave, kalimin e paligjshëm të kufirit nga emigrantët, trafikimin e armëve dhe krimin ndaj pasurive kulturore, duke përdorur metoda të posaçme hetimore aty ku është e ligjshme. Zgjerimi i përdorimit sistematik të mjeteve analitike, kriminalistikës digjitale dhe inteligjencës operacionale, për të	91604AA	Policia e Shtetit	gjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes; Shërbimi Informativ i Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	2026	2028	-	

				logjistikën, lehtësuesit dhe të ardhurat kriminale të tyre.		identifikuar zinxhirët e logjistikës, lehtësuesit, flukset financiare dhe lidhjet ndërkufitare, duke mundësuar ndërprerjen e hershme të aktivitetit kriminal.							
QP II	2.2	Reduktimi i ndjeshëm i trafikimit, duke rritur zbulimin, goditjen e rrjeteve kriminale dhe forcimin e kontrolleve kufitare dhe hetimore.	2.2.2	Rritja e kontrollit kufitar për parandalimin dhe luftimin e trafikimit ndërkombëtar të drogës, përfshirë përmes profilizimit të bazuar në risk, kontrolleve të forcuara në pikat e kalimit kufitar, përdorimit të zgjeruar të teknologjive të zbulimit, procedurave të përmirësuara të shënjestrimit dhe veprimeve të koordinuara midis strukturave kufitare, doganore dhe hetimore.	2.2.2	Forcimi i profilizimit të bazuar në rrezik dhe proceduravë të shënjestrimit në pikat e kalimit kufitar, përmes përdorimit të zgjeruar të teknologjive të zbulimit, inteligjencës doganore dhe bazave të integruara të të dhënave. Kryerja e operacioneve të koordinuara të kontrollit kufitar midis Policisë Kufitare, Doganave dhe strukturave hetimore, për të zbuluar narkotikët e fshehur, për të goditur trafikimin dhe për të siguruar referim në kohë për hetimet.	91604AA	Policia e Shtetit	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	2026	2028	-	
QP II	2.2	Reduktimi i ndjeshëm i trafikimit, duke rritur zbulimin, goditjen e rrjeteve kriminale dhe forcimin e kontrolleve kufitare dhe hetimore.	2.2.3	Rritje e numrit dhe efektivitetit operacional të patrullave të Policisë Kufitare, me qëllim luftimin e kontrabandës dhe kalimit të paligjshëm të kufirit, përfshirë përmes vendosjes të bazuar në rrezik, patrullave të intensifikuara në zonat me rrezik të lartë, koordinimit të përmirësuar me strukturat e tjera ligjzbatuese dhe përdorimit të informacionit operacional, me qëllim zbulimin dhe parandalimin e aktivitetit kriminal ndërkufitar.	2.2.3	Dislokimi i patrullave të Policisë Kufitare bazuar në vlerësimet e rrezikut, duke u fokusuar në zonat me rrezik të lartë dhe korridoret e njohura të kontrabandës dhe trafikimit, dhe duke përdorur informacionin operacional për të udhëhequr modelet e patrullimit. Përmirësimi i koordinimit midis Policisë Kufitare, Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera ligjzbatuese, për të siguruar përgjigje të shpejtë, patrullime të përbashkëta dhe zbulim efektiv të aktivitetit kriminal ndërkufitar.	91604AK; 901604AA	Policia e Shtetit	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	2026	2028	-	
QP II	2.2	Reduktimi i ndjeshëm i trafikimit, duke rritur zbulimin, goditjen e rrjeteve kriminale dhe forcimin e kontrolleve kufitare dhe hetimore.	2.2.4	Forcimi i bashkëpunimit me strukturat ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, përfshirë përmes shkëmbimit të informacionit, analizës së përbashkët të rrezikut dhe veprimeve operacionale të koordinuara, me qëllim parandalimin, zbulimin dhe luftimin aktivitetit kriminal në fushën e trafikimit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore.	2.2.4	Miratimi i mekanizmave të strukturuar të shkëmbimit të informacionit dhe proceseve të analizës së përbashkët të rrezikut me agjencitë vendase dhe partnerët ndërkombëtarë, për të identifikuar rrjetet e trafikimit dhe lehtësuesit ndërkufitarë. Kryerja e veprimeve të koordinuara operacionale, si hetime të përbashkëta, dorëzime të kontrolluara dhe operacione të njëkohshme zbatimi, me qëllim parandalimin, zbulimin dhe goditjen e rrjeteve të trafikimit të paligjshëm.	91604AA; 91604AC	Policia e Shtetit	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit/Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore; Shërbimi Informativ i Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;	2026	2028	-	
QP II	2.2	Reduktimi i ndjeshëm i trafikimit, duke rritur zbulimin, goditjen e rrjeteve kriminale dhe forcimin e kontrolleve kufitare dhe hetimore.	2.2.5	Rritje e aktivitetit hetimor dhe operacioneve të përbashkëta të Policisë së Shtetit kundër trafikimit të armëve të zjarrit dhe municioneve, përfshirë përmes shënjestrimit të orientuar nga inteligjenca, hetimet proaktive dhe metodat e posaçme të hetimit, duke pasur mbështetjen e ligjshme në gjurmim dhe balistikë si dhe bashkëpunim të përforcuar me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.	2.2.5	Zbatimi i shënjestrimit bazuar në inteligjencë të rrjeteve të trafikimit të armëve, mbështetur nga hetimet proaktive, metodat e posaçme të hetimit dhe kapacitetet e zgjeruara të gjurmimit balistik. Forcimi i bashkëpunimit me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, përfshirë Europolin dhe platformat rajonale, për të gjurmuar armët, për të identifikuar zinxhirët e furnizimit dhe për të goditur rrjetet e organizuara të përfshira në trafikimin e armëve.	91604AA; 91604AC	Policia e Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;	2026	2028	-	
QP II	2.2	Reduktimi i ndjeshëm i trafikimit, duke rritur zbulimin, goditjen e rrjeteve kriminale dhe forcimin e kontrolleve kufitare dhe hetimore.	2.2.6	Rritje e kontrollit kufitar për parandalimin dhe luftën kundër kontrabandës së mjeteve motorike, përfshirë përmes profilizimit të riskut, kontrolleve të përforcuara të mjeteve motorike dhe dokumentacionit, përdorimit përkatës të bazave kombëtare dhe ndërkombëtare të të dhënave, si edhe koordinimit ndërmjet Policisë Kufitare, doganave dhe strukturave hetimore, me qëllim zbulimin dhe referimin në kohë të rasteve.	2.2.6	Zbatimi i teknikave të profilizuara të rrezikut dhe kontrolleve të zgjeruara të dokumenteve dhe mjeteve motorike në pikat kufitare, duke përdorur bazat e të dhënave kombëtare dhe ndërkombëtare (si p.sh., regjistrat e mjeteve të vjedhura), për të zbuluar parregullsitë. Koordinimi i veprimeve midis Policisë Kufitare, Doganave dhe strukturave hetimore për të siguruar referim, sekuestrim dhe hetim në kohë të rasteve të dyshuara të trafikimit.	91604AA; 91604AC	Policia e Shtetit	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	2026	2028	-	
QP II	2.2	Reduktimi i ndjeshëm i trafikimit, duke rritur zbulimin, goditjen e rrjeteve kriminale dhe forcimin e kontrolleve kufitare dhe hetimore.	2.2.7	Rritje e kontrollit kufitar për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit ndërkombëtar të pasurive kulturore, përfshirë përmes kontrolleve të shënjestruara në pikat kufitare, procedurave të përmirësuara të identifikimit dhe verifikimit, përdorimit të ekspertizës së specializuar dhe bazave të të dhënave dhe veprimit të koordinuar me institucionet përgjegjëse kombëtare dhe partnerët ndërkombëtarë.	2.2.7	Kryerja e kontrolleve të shënjestruara në pikat e kalimit kufitar, duke përdorur procedura të specializuara identifikimi, mbështetje eksperte dhe akses në bazat e të dhënave kombëtare dhe ndërkombëtare të pasurive kulturore. Koordinimi me institucionet përgjegjëse kombëtare dhe partnerët ndërkombëtarë, me qëllim verifikimin e autencitetit, zbulimin e lëvizjeve të paligjshme të objekteve kulturore dhe ndjekjen e shpejtë operacionale.	91604AA	Policia e Shtetit	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit; Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore	2026	2028	-	
QP II	2.2	Reduktimi i ndjeshëm i trafikimit, duke rritur zbulimin, goditjen e rrjeteve kriminale dhe forcimin e kontrolleve kufitare dhe hetimore.	2.2.8	Hartimi dhe miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit "Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme", për vitet 2026-2028.	2.2.8	Hartimi dhe miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit "Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme", për vitet 2026-2028, duke përcaktuar përgjegjësi, masa, afate kohore dhe mekanizma koordinimi të qartë midis të gjitha institucioneve përgjegjëse. Monitorimi periodik dhe raportimi mbi progresin e zbatimit, përfshirë vlerësimin e	91202AB	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit/Instituti i Regjistrimit të Pasurisë Kulturor	Ministria e Punëve të Brendshme/Policia e Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	2026	2028	-	

						rezultateve operacionale, bashkëpunimit institucional dhe rreziqeve në zhvillim.							
QP II	2.2	Reduktimi i mjeshëm i trafikimit, duke rritur zbulimin, goditjen e rrjeteve kriminale dhe forcimin e kontrolleve kufitare dhe hetimore.	2.2.9	Ngritja dhe vënia në funksion e databazës së Objekteve të Humbura, bazuar në procedura të standardizuara për administrimin dhe përditësimin e të dhënave	2.2.9	Ngritja dhe vënia në përdorim e bazës së të dhënave të Objekteve të Humbura me procedura të standardizuara procedura për hedhjen e të dhënave, përgjegjësi institucionale për mirëmbajtjen dhe mekanizma të kontrollit të cilësisë. Përditësimi periodik i bazës së të dhënave dhe Regjistrit Kombëtar të Pasurive Kulturore, si dhe vendosja e kanale të shkëmbimit të informacionit me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të mbështetur identifikimin dhe rikuperimin e objekteve kulturore të vjedhura.	91202AB	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit/Instituti i Regjistrimit të Pasurisë Kulturor	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	2028	2028	-	
Nëntotali — OS 2.2												-	
OS 2.3 —Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë													
QP II	2.3	Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë.	2.3.1	Forcimi i luftës kundër pastrimit të parave përmes një qasjeje të udhëhequr nga inteligjenca, duke u mbështetur në hetim proaktiv, analizë të thelluar të riskut dhe bashkëpunim të ngushtë me prokurorinë, me qëllim përmirësimin e zbulimit, hetimit dhe ndjekjes penale të pastrimit të parave si vepër autonome dhe si komponent paralel i hetimeve të krimit të organizuar.	2.3.1	Kryerja e hetimeve proaktive për pastrimin e parave, duke u udhëhequr nga inteligjenca dhe duke përdorur analizë të thelluar financiare, modele transaksionesh të dyshimta dhe inteligjencë ndërinstitucionale, për të zbuluar pastrimin e parave si vepër autonome dhe si komponent paralel i çështjeve të krimit të organizuar. Forcimi i bashkëpunimit me organin e akuzës përmes takimeve të përbashkëta të përzgjedhjes së çështjeve, planeve të koordinuara hetimore dhe zbatimit të hershëm të masave të sekuestrimit për të ruajtur të ardhurat kriminale.	91604AA	Policia e Shtetit	Prokuroria e Përgjithshme; Byroja Kombëtare e Hetimit; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Agjencia e Inteligjencës Financiare,	2026	2028	-	
	2.3	Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë.	2.3.2	Shkëmbimi i informacionit nga Agjencia e Inteligjencës Financiare me agjencitë ligjzbatuese dhe ato të inteligjencës, në kuadër të zbatimit të fushës së saj të veprimtarisë.	2.3.2	Dërgimi i informacioneve midis Agjencisë së Inteligjencës Financiare dhe organeve ligjzbatuese, që janë të sigurta dhe shkëmbejnë informacion në kohë reale, Zbatimi i mekanizmave të strukturuar të reagimit, për të përmirësuar cilësinë e raporteve të transaksioneve të dyshimta dhe për të rritur rëndësinë e inteligjencës financiare për hetimet proaktive.	91006AA	Agjencia e Inteligjencës Financiare	Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm; Prokuroria e Posaçme; PSH; BKH; SHISH; DPT.	2026	2028	-	
QP II	2.3	Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë.	2.3.3	Kryerja e inspektimeve të bazuara në risk për subjektet e përcaktuara sipas Ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008, i pandryshuar.	2.3.3	Kryerja e inspektimeve të bazuara në rrezik duke përdorur tregues specifikë sektorialë të rrezikut, duke prioritizuar subjektet me rrezik të lartë si agjentët e pasurive të paluajtshme, kontabilistët, kazinotë dhe bizneset e shërbimeve monetare. Ndjekja e vazhdueshme e gjetjeve të inspektimit, përmes planeve për veprime korrigjuese dhe sanksioneve, aty ku është e përshtatshme, si dhe monitorimit të përmirësimeve të pajtueshmërisë me kalimin e kohës.	91006AA	Agjencia e Inteligjencës Financiare	Agjencia e Mbikëqyrjes Financiare; Banka e Shqipërisë; Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit; Ministria e Drejtësisë; BMP.	2026	2028	-	
QP II	2.3	Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë.	2.3.4	Kryerja e Vlerësimit Kombëtar të Riskut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, përfshirë duke mbledhur dhe analizuar të dhënat sasiore dhe cilësore nga autoritetet përgjegjëse dhe subjektet e detyruara, duke identifikuar dhe prioritizuar risqet sektoriale dhe tematike, si dhe duke shndërruar konstatimet në masa zbutëse të koordinuara dhe në prioritete politikash.	2.3.4	Mbledhja dhe analizimi i të dhënave sasiore dhe cilësore nga autoritetet përgjegjëse dhe subjektet e detyruara, për të identifikuar risqet sektoriale dhe tematike të pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit. Shndërrimi i konstatimeve të NRA-së në masa zbutëse të koordinuara, politika të përditësuara dhe veprime operacionale të prioritizuara në të gjitha institucionet përkatëse.	91006AA	Agjencia e Inteligjencës Financiare	Shërbimi Informativ i Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare; Agjencia për Inteligjencën dhe Sigurinë e Mbrojtjes; Banka e Shqipërisë; Qendra Kombëtare e Biznesit; Dhoma Kombëtare e Avokatisë; Prokuroria e Përgjithshme; Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara	2027	2028	-	
QP II	2.3	Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë.	2.3.5	Trajnime për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit të organeve ligjzbatuesve, gjyqtarëve, prokurorëve dhe të inteligjencës për rreziqet e pastrimit të parave, me tematika të lidhura me rrezikun e mbledhjes, lëvizjes së fondeve të Shqipërisë, përdorimin e fondeve për territorin e Shqipërisë, përdorimin e personave juridik, strukturave komplekse, profesionistëve, për pastrimin e parave si vepër autonome, risku nga keqpërdorimi i OJF, financimin e terrorizmit (përfshirë edhe atë të lidhur me tregtinë apo forma të tjera të mundshme etj.).	2.3.5	Ofrimi i trajnimeve të specializuara mbi tipologjitë e pastrimit të parave, qarkullimin ndërkufitar të fondeve, keqpërdorimin e personave juridikë, strukturat komplekse të pronësisë dhe financimin e terrorizmit (përfshirë edhe atë të lidhur me tregtinë apo forma të tjera të mundshme etj.). Ofrimi i moduleve të posaçme mbi risqet e keqpërdorimit të OJF-ve, profesioneve me rrezik të lartë dhe teknologjive financiare në zhvillim, duke siguruar harmonizim me standardet FATF-së.	91006AA	Agjencia e Inteligjencës Financiare	Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Policia e Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Shërbimi Informativ i Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Këshilli i Lartë i Prokurorisë	2026	2028	2,235,000	Financim nga partnerët
QP II	2.3	Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë.	2.3.6	Rritja e kapaciteteve të specializuara qendrore dhe vendore për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar, përmes integrimit të metodave novatore hetimore, mbështetjes teknologjike, menaxhimit të përmirësuar të burimeve, si dhe një plani të integruar trajnimi midis strukturave policore dhe aktorëve të tjerë	2.3.6	Integrimi i metodave hetimore novatore, si mjetet kriminalistike e digjitale, kontabilitetin kriminalistik dhe analitikën e avancuar, në strukturat hetimore qendrore dhe vendore. Zbatimi i një plani trajnimi të koordinuar midis policisë, autoriteteve tatimore, doganave dhe prokurorëve, me qëllim forcimin e kapaciteteve të përbashkëta hetimore.	91604AB	Policia e Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Agjencia e Inteligjencës Financiare; Qendra Kombëtare e Biznesit	2026	2028	-	

				shtetërorë që kontribuojnë në hetimin dhe ndjekjen penale									
QP II	2.3	Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë.	2.3.7	Konsolidimi i praktikave për zbatimin e njëkohshëm të hetimeve financiare paralele me hetimet për vepra penale të krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, me qëllim identifikimin, gjurmimin, ngrirjen dhe konfiskimin e të ardhurave, pasurive dhe mjeteve kriminale në kohë dhe në mënyrë të koordinuar.	2.3.7	Zbatimi sistematik i hetimeve paralele financiare në të gjitha çështjet kryesore të krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, me qëllim identifikimin, gjurmimin, ngrirjen dhe konfiskimin e të ardhurave kriminale. Zbatimi i proceduravе standarde operacionale dhe protokolleve të përbashkëta operacionale, për të siguruar nisje të hershme të hetimit financiar dhe veprime të koordinuara të gjurmimit të aseteve.	91604AA; 91604AR	Policia e Shtetit	Prokuroria e Përgjithshme; Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Agjencia e Inteligjencës Financiare; Byroja Kombëtare e Hetimit; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	2026	2028	-	
QP II	2.3	Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë.	2.3.8	Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional për trajtimin e korrupsionit në të gjitha format dhe nivelet e tij, përfshirë përmes punës së koordinuar në trajtimin e çështjeve, shkëmbimit të informacionit, produkteve të përbashkëta analitike dhe protokolleve të forcuara të bashkëpunimit midis institucioneve hetimore, mbikëqyrëse dhe të prokurorisë.	2.3.8	Koordinimi i punës me çështjet dhe produktet e përbashkëta analitike, midis institucioneve hetimore, mbikëqyrëse dhe të prokurorisë, me qëllim evidentimin e modeleve të korrupsionit dhe sektorët me rrezik të lartë. Forcimi i protokolleve të bashkëpunimit dhe mekanizmave të shkëmbimit të informacionit, për të siguruar referim në kohë, hetim të përbashkët dhe ndjekje konsistente të çështjeve të korrupsionit.	91604AA; 91604AR	Policia e Shtetit	Prokuroria e Përgjithshme; Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Agjencia e Inteligjencës Financiare; Byroja Kombëtare e Hetimit; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;	2026	2028	-	
QP II	2.3	Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë.	2.3.9	Rritja e kërkesave për hetime paralele dhe të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë, përmes veprimeve hetimore proaktive, të mbështetura nga analiza e tendencave më të fundit kriminale, në fushën e krimit ekonomik dhe aseteve të përfluara në mënyrë të paligjshme në Shqipëri dhe jashtë vendit, si dhe me qëllim forcimin e gjurmimit, ngrirjes dhe konfiskimit të aseteve ndërkufitare.	2.3.9	Nisja e hetimeve paralele dhe të përbashkëta me autoritetet e huaja, bazuar në tendencat në zhvillim kriminal, flukset financiare ndërkufitare dhe inteligjencën mbi asetet e mbajtura jashtë vendit. Forcimi i gjurmimit, sekuestrimit dhe konfiskimit ndërkufitar të aseteve, përmes bashkëpunimit të zgjeruar me Europolin, Njësitë e Inteligjencës Financiare (NjIF-të) dhe rrjetet ndërkombëtare të hetimit financiar.	91604AA	Policia e Shtetit	Prokuroria e Përgjithshme; Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Agjencia e Inteligjencës Financiare; Byroja Kombëtare e Hetimit;	2026	2028	-	
QP II	2.3	Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë.	2.3.10	Trajtimi i krimit ekonomik dhe mashtrimit financiar përmes hetimeve proaktive, përfshirë përmes përzgjedhjes së çështjeve të udhëhequr nga inteligjenca, zbatimit të teknikave të posaçme të hetimit, aty ku lejohet me ligj, forcimit të kapaciteteve të kontabilitetit kriminalistik dhe gjurmimit digjital, si dhe prioritizimit të çështjeve me ndikim të lartë dhe të ardhura të konsiderueshme kriminale.	2.3.10	Zhvillimi i proceseve të përzgjedhjes së çështjeve, të udhëhequra nga inteligjenca, me qëllim që të prioritizohen çështjet e krimit ekonomik me ndikim të lartë, të cilat përfshijnë të ardhura të rëndësishme ose cenueshmëri sistemike. Zbatimi i teknikave të posaçme të hetimit, forcimi i kapaciteteve të kontabilitetit kriminalistik dhe zgjerimi i mjeteve të gjurmimit digjital, me qëllim zbulimin e skemave komplekse të mashtrimit.	91604AA	Policia e Shtetit	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Byroja Kombëtare e Hetimit; Prokuroria e Përgjithshme	2026	2028	-	
QP II	2.3	Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë.	2.3.11	Zgjerimi i aksesit dhe verifikimit *online* në bazat e të dhënave, për qëllime të verifikimeve paraprake dhe hetimeve në fushën ekonomiko-financiare, përfshirë duke forcuar ndërveprueshmërinë, duke përmirësuar procedurat e aksesit të ligjshëm dhe duke mundësuar verifikim në kohë të informacionit të nevojshëm për analizën e riskut dhe zhvillimin e çështjes.	2.3.11	Forcimi i ndërveprueshmërisë dhe i proceduravе të aksesit të ligjshëm në bazat kryesore të të dhënave që përdoren në hetimet ekonomiko-financiare, duke mundësuar verifikim të shpejtë të pronësisë, transaksioneve dhe treguesëve të rrezikut. Ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes teknike për hetuesit, që të sigurojnë përdorim konsistent dhe efektiv të mjeteve të verifikimit *online* për zhvillimin e çështjes.	91604AA	Policia e Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare; Agjencia për Inteligjencën dhe Sigurinë e Mbrojtjes; Qendra Kombëtare e Biznesit; Dhoma Kombëtare e Avokatisë; Prokuroria e Përgjithshme; Byroja Kombëtare e Hetimit	2026	2028	-	
QP II	2.3	Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë.	2.3.12	Rritja e sekuestrimeve dhe konfiskimeve të pasurive që kanë prejardhje kriminale mbështetur në hetime thelluara.	2.3.12	Përmirësimi i metodologjive të gjurmimit të aseteve, zhvillimit të provave dhe koordinimit me prokurorët, për të mbështetur ngrirjen dhe konfiskimin në kohë të të ardhurave kriminale. Forcimi i bashkëpunimit me strukturat e menaxhimit të aseteve, për të siguruar trajtim të duhur, vlerësim dhe asgjësim të aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara.	91604AA	Policia e Shtetit	Prokuroria e Përgjithshme; Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Byroja Kombëtare e Hetimit; Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë	2026	2028	-	
QP II	2.3	Forcimi i kapaciteteve kombëtare për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar, që rezulton në rritje të sekuestrimeve dhe ulje të pandëshkueshmërisë.	2.3.13	Inicimi i procesit të vlerësimit për ngritjen e një Task-Force ad hoch të specalizuar për Pastrimin e Parave në fushën e Pronave të Paluajtshme për ndërgjegjësim dhe kontroll të forcuar mbi profesionet e lira dhe kategorive të caktuara të bizneseve dhe profesioneve jofinanciare, duke përfshirë avokatët, agjentët e pasurive të paluajtshme, kontabilistët etj.	2.3.13	Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të cenueshmërive sektoriale në sektorin e pasurive të paluajtshme, profesionet e lira dhe bizneset jofinanciare për të përcaktuar nevojën dhe strukturën e një Task-Force të specializuar kundër pastrimit të parave. Hartimi i propozimeve për forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe kontrollit për profesionet dhe sektorët e identifikuar me risk të lartë ndaj pastrimit të parave, sipas gjetjeve të Vlerësimit Kombëtar të Riskut për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, por duke mbajtur në vëmendje të veçantë edhe sektorët me risk të mesëm (si p.sh.) ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme, kontabilistët dhe profesionet e tjera relevante), me qëllim përmirësimin e zbulimit dhe raportimit të aktiviteteve të dyshimta.	91601AA	Ministria e Punëve të Brendshme	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Prokuroria e Përgjithshme; Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Byroja Kombëtare e Hetimit; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Qendra Kombëtare e Biznesit; Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë	2026	2027	-	
Nëntotali — OS 2.3												**2,235,000**	
OS 2.4 — Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik, përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.													
QP II	2.4	Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të	2.4.1	Forcimi kapaciteteve hetimore, operacionale dhe teknologjike për trajtimin e krimit kibernetik, duke	2.4.1	Zhvillimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të kriminalistikës digjitale dhe analizës kibernetike, duke pajisur njësitë e specializuara me mjete moderne	91604AR; 91604AA	Policia e Shtetit	Ministria e Drejtësisë; Prokuroria e Posaçme; Byroja Kombëtare e Hetimit; Agjencia e Inteligjencës	2026	2028	-	

		krimit kibernetik, përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.		përfshirë ndërtimin e kapaciteteve për analizën digjitale dhe kriminalistikën digjitale, si dhe duke përdorur mjete moderne dhe platformave për të mbështetur zbulimin, hetimin dhe dokumentimin e krimit kibernetik.		për nxjerrjen e të dhënave, analizën e maluerëve, kriminalistikën e rrjetit dhe ruajtjen e provave. Zbatimi i punës së strukturuar operacionale për hetimin e krimit kibernetik, duke përdorur platforma të avancuara për zbulimin, dokumentimin dhe gjetjen e autorëve të incidenteve kibernetike.			Financiare				
QP II	2.4	Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik, përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.	2.4.2	Hartimi dhe zbatimi i programeve edukative dhe ndërgjegjësuese për qytetarët dhe bizneset mbi rreziqet kibernetike dhe masat mbrojtëse, përfshirë udhëzime për sjelljen e sigurt *online*, higjienën bazë kibernetike, rrugët e raportimit dhe masat parandaluese për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aseteve digjitale.	2.4.2	Përgatitja dhe ofrimi i fushatave të ndërgjegjësimit në të gjithë vendin, për qytetarët dhe bizneset, mbi rreziqet kibernetike, sjelljen e sigurt *online*, higjienën kibernetike dhe rrugët e raportimit për incidentet kibernetike. Hartimi i materialeve praktike udhëzuese, si listat e kontrollit, tutorialet dhe këshillat specifike sektoriale, për të ndihmuar individët dhe bizneset të mbrojnë të dhënat personale dhe asetet digjitale.	91604AR; 91604AA	Policia e Shtetit	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës	2026	2028	-	
QP II	2.4	Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik, përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.	2.4.3	Trajtimi efektiv dhe i qëndrueshëm i të gjitha formave të krimit kibernetik, përmes realizimit të hetimeve proaktive, përfshirë përdorimin e inteligjencës digjitale dhe metodave të avancuara teknologjike hetimore, me qëllim parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e aktiviteteve kriminale në hapësirën kibernetike.	2.4.3	Kryerja e hetimeve proaktive të krimit kibernetik, duke përdorur inteligjencën digjitale, inteligjencën nga burime të hapura (OSINT) dhe mjete të avancuara teknologjike, për të zbuluar aktivitetin kriminal në hapësirën kibernetike. Zbatimi i teknikave të specializuara hetimore, si monitorimi i rrjetit, gjurmimi i kriptovalutave dhe operacionet e fshehta *online*, aty ku lejohet me ligj, me qëllim parandalimin dhe ndërprerjen e veprimeve penale kibernetike.	91604AA	Policia e Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Agjencia e Inteligjencës Financiare.	2026	2028	-	
QP II	2.4	Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik, përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.	2.4.4	Ofrimi i trajnimit të vazhdueshëm për të përditësuar njohuritë dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional, përfshirë trajnime të specializuara, përdorimin e softuerëve modernë dhe mjeteve hetimore, si dhe trajnime të përbashkëta me agjencitë ligjzbatuese, me fokus të veçantë te gjurmimi i aktiviteteve të paligjshme që përfshijnë kriptovalutat, hetimi i krimit kibernetik dhe identifikimi i grupeve kriminale që veprojnë *online*.	2.4.4	Ofrimi i programeve të specializuara të trajnimit për policët, prokurorët dhe zyrtarët e inteligjencës, mbi hetimin e krimit kibernetik, gjurmimin e kriptovalutave, trajtimin e provave digjitale dhe tendencat e reja të krimit *online*. Organizimi i ushtrimeve trajnuese të përbashkëta me agjencitë ligjzbatuese vendase dhe ndërkombëtare, me qëllim përmirësimin e koordinimit operacional dhe kuptimin e përbashkët të kërcënimeve kibernetike.	91604AA	Policia e Shtetit	Shërbimi Informativ i Shtetit; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Agjencia e Inteligjencës Financiare; Banka e Shqipërisë; Byroja Kombëtare e Hetimit; Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës; Prokuroria e Posaçme; Prokuroria e Përgjithshme	2026	2028	-	
QP II	2.4	Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik, përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.	2.4.5	Rritja e bashkëpunimit me institucionet publike, subjektet private dhe partnerët ndërkombëtarë për trajtimin e shpejtë dhe të saktë të rasteve të abuzimit seksual të fëmijëve *online*, përfshirë identifikimin dhe prioritizimin e rasteve urgjente, si dhe analizën efektive të provave në mbështetje të hetimit dhe ndjekjes penale.	2.4.5	Vendosja e procedurave të reagimit të shpejtë me institucionet publike, subjektet private dhe partnerët ndërkombëtarë, për të siguruar identifikim, prioritizim dhe hetim në kohë të materialit të abuzimit seksual *online* të fëmijëve. Forcimi i kapacitetit të kriminalistikës digjitale për të analizuar provat në mënyrë efikase dhe për të mbështetur ndjekjet penale, përfshirë përmes mjeteve të specializuara dhe personelit të trajnuar.	91604AA	Policia e Shtetit	Prokuroria e Përgjithshme	2026	2028	-	
QP II	2.4	Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik, përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.	2.4.6	Hartimi dhe zbatimi i programeve edukative dhe ndërgjegjësuese për fëmijët mbi sigurinë në internet dhe mbrojtjen nga rreziqet kibernetike, si dhe ofrimi i trajnimit të vazhdueshëm të përbashkët për punonjësit e policisë dhe aktorët vendore të vijës së parë, mbi tendencat në zhvillim të krimit kibernetik, dëmet *online* dhe procedurat e duhura të reagimit dhe referimit.	2.4.6	Zbatimi i programeve edukative të përshtatshme për moshën në shkolla dhe qendra komunitare, me qëllim që fëmijët të mësojnë mbi sigurinë *online*, rreziqet kibernetike dhe sjelljen e përgjegjshme digjitale. Ofrimi i trajnimit të vazhdueshëm të përbashkët për oficerët e policisë, mësuesit dhe aktorët vendorë në vijën e parë, mbi dëmet e aktivitetit *online*, procedurat e referimit dhe protokollet e mbrojtjes së fëmijëve.	91604AA	Policia e Shtetit	Ministria e Arsimit; Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike; Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës.	2026	2028	-	
QP II	2.4	Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik, përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.	2.4.7	Krijimi dhe aktivizimi i kapaciteteve teknike dhe teknologjike për të monitoruar Dark Web-in, me qëllim forcimin e parandalimit dhe zbulimit e hershëm të krimeve kibernetike, përfshirë përmes mjeteve të dedikuara, personelit të trajnuar dhe procedurave për mbledhjen e inteligjencës dhe ndjekjen operacionale.	2.4.7	Alokimi i kapaciteteve të dedikuara për monitorimin e DarWeb-it, përfshirë mjete të specializuara, analistë të trajnuar dhe procedura operacionale për mbledhjen e inteligjencës dhe zbulimin e hershëm të krimit kibernetik. Integrimi i inteligjencës së Dark Web-it në praktikën hetimore, për të mbështetur zhvillimin e çështjes, vlerësimet e kërcënimit dhe ndjekjen operacionale.	91604AA	Policia e Shtetit		2026	2028	-	
QP II	2.4	Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik, përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.	2.4.8	Forcimi i rrjeteve të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimit të informacionit në luftën kundër krimit kibernetik, përmes pikave të kontaktit 24/7, me qëllim sigurimin e asistencës në kohë, shkëmbim të shpejtë të informacionit dhe përgjigje të koordinuara operacionale ndaj incidenteve dhe hetimeve kibernetike ndërkufitare.	2.4.8	Mbajtja e bashkëpunimit aktiv 24/7 me pikat e kontaktit të partnerëve ndërkombëtarë, për të siguruar shkëmbim të shpejtë informacioni, asistencë në kohë dhe përgjigje të koordinuara ndaj incidenteve kibernetike ndërkufitare. Pjesëmarrja në platformat e koordinimit ndërkombëtar të krimit kibernetik, operacionet e përbashkëta dhe nismat e shkëmbimit të inteligjencës për të rritur kapacitetin hetimor ndërkufitar.	91604AA	Policia e Shtetit	Byroja Kombëtare e Hetimit	2026	2028	-	
QP II	2.4	Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik,	2.4.9	Standardizimi dhe optimizimi i procedurave për funksionim efektiv të pikës së kontaktit 24/7, përfshirë duke sqaruar	2.4.9	Hartimi dhe zbatimi i procedurave standarde operacionale që përcaktojnë rolet, përgjegjësitë, afatet kohore të reagimit dhe kërkesat e dokumentimit për të gjitha	91604AA	Policia e Shtetit		2026	2028	-	

		përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.		rolet dhe përgjegjësitë, duke vendosur afatet kohore të reagimit, duke siguruar komunikim dhe dokumentim të sigurt dhe duke miratuar mekanizma të sigurimit të cilësisë për kërkesat dhe shkëmbimet e lidhura me krimin kibernetik.		operacionet e pikave të kontaktit 24/7. Miratimi i mekanizmave të sigurimit të cilësisë, që garantojnë komunikim të sigurt, përpunim të saktë të kërkesave dhe ndjekje konsistente të shkëmbimeve ndërkombëtare.							
QP II	2.4	Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik, përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.	2.4.10	Forcimi i bashkëpunimit me institucionet publike, OJF-të, ofruesit e shërbimeve të internetit, kompanitë telefonike dhe organizatat globale për të siguruar akses në kohë dhe informacion në kohë reale, aty ku është përshtatshme, si dhe për të parandaluar aktivitetet kriminale në hapësirën kibernetike, përfshirë përmes koordinimit operacional, procedurave të thjeshtuara të ruajtjes dhe dhënies së informacionit, si dhe ndërgjegjësimit dhe masave parandaluese të përbashkëta.	2.4.10	Thjeshtimi i procedurave për ruajtjen e të dhënave, zbulimin e ligjshëm të informacionit dhe koordinimin operacional me ofruesit e shërbimeve të internetit, operatorët e telekomunikimit dhe platformat *online*, për të mbështetur hetimet e krimit kibernetik. Realizimi i nismave të përbashkëta të ndërgjegjësimit dhe parandalimit me OJF-të, institucionet publike dhe partnerët e sektorit privat, me qëllim reduktimin e rreziqeve *online* dhe përmirësimin e raportimit të hershëm.	91604AA	Policia e Shtetit		2026	2028	-	
QP II	2.4	Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik, përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.	2.4.11	Pjesëmarrja në projektet e BE-së dhe të tjera ndërkombëtare që mbështesin raportimin dhe mbrojtjen e të miturive dhe qytetarëve nga abuzimi *online*, duke shfrytëzuar nismat ekzistuese dhe duke ndjekur pjesëmarrjen në platformat e reja të raportimit si "Help4U", përmes organizimit të takimeve, pjesëmarrjes aktive në aktivitetet e projektit, dhe ndjekjes së procedurave të aplikimit.	2.4.11	Angazhimi aktiv në nismat e BE-së dhe ato ndërkombëtare, si "Help4U" dhe platformat e ngjashme, duke marrë pjesë në takimet e projektit, aktivitetet pilote dhe proceset e aplikimit. Integrimi i produkteve të projektit në mekanizmat kombëtarë të raportimit dhe mbrojtjes, për të rritur sigurinë *online* të të miturve dhe të grupeve të cenueshme.	91604AA	Policia e Shtetit		2026	2028	-	
QP II	2.4	Rritja e kapaciteteve kombëtare në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të krimit kibernetik, përmes teknologjisë së përparuar, aftësive të specializuara dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.	2.4.12	Propozimi i ndryshimeve nënligjore për të siguruar mbështetje të qëndrueshme financiare për kapacitetet hetimore të krimit kibernetik, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së strukturave të specializuara, mirëmbajtjes dhe modernizimit të mjeteve teknologjike, dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të kapaciteteve të krimit kibernetik brenda strukturave të Policisë së Shtetit.	2.4.12	Realizimi i vlerësimit institucional të nevojave afatgjata financiare për njësitë hetimore të krimit kibernetik, përfshirë personelin, mjetet dhe mirëmbajtjen. Hartimi dhe propozimi i ndryshimeve nënligjore për të siguruar financim të qëndrueshëm për strukturat e specializuara të krimit kibernetik dhe modernizime të vazhdueshme teknologjike.	91604AA	Policia e Shtetit		2026	2028	-	
Nëntotali — OS 2.4												**-**	
OS 2.5 — Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave .													
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.1	Miratimi i projektvendimit "Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Policisë Shkencore" dhe hartimi i një plani veprimi bazuar në vendimin e miratuar, ku përcaktohen përgjegjësitë, afatet kohore, burimet dhe modalitetet e monitorimit për të siguruar zbatim efektiv të reformës.	2.5.1	Finalizimi dhe miratimi i projektvendimit për organizimin dhe funksionimin e IPSH-së, duke siguruar harmonizim me kërkesat ISO 17025 dhe modelet ndërkombëtare të qeverisjes kriminalistike. Hartimi i një plan veprimi të detajuar për zbatim, që përcakton përgjegjësitë, afatet kohore, nevojat për burime dhe modalitetet e monitorimit për të udhëhequr procesin e reformës.	91601AA	Ministria e Punëve të Brendshme/Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore; FFA;	FFA	2026	2026	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.2	Miratimi një plani të detajuar për sistemimin e strukturës së Policisë Shkencore në ambientet e reja, përfshirë planifikimin e hapësirës, zonimin funksional të laboratorëve dhe zonave të provave, kërkesat e sigurisë, masat e sigurisë në punë, afatet kohore të zhvendosjes në faza dhe modalitetet e vazhdimësisë së punës, për të shmangur ndërprerjen e shërbimeve kriminalistike.	2.5.2	Përgatitja e planit të sistemimit gjithëpërfshirës që detajon zonën e laboratorit, zonat e trajtimit të provave, sistemet e sigurisë dhe kërkesat e sigurisë në punë për ambientet e reja të IPSh-së. Zbatimi i një kalendari për zhvendosjen me faza, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve kriminalistike, përfshirë rregullimet e kontingjencës për të shmangur ndërprerjen e shërbimit.	I8AU307	Policia e Shtetit	FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.3	Zbatimi i standardeve minimale të cilësisë për hetimet në vendin e ngjarjes dhe për administrimin e provave nga vendi i ngjarjes deri në sallën e gjyqit, përfshirë procedurat standarde operacionale për sigurimin, dokumentimin, mbledhjen, paketimin, transportimin, ruajtjen, ekzaminimin dhe paraqitjen e provave, me qëllim garantimin e integritetit, gjurmueshmërisë dhe pranueshmërisë së provave.	2.5.3	Hartimi dhe zbatimi i procedurave standarde operacionale për sigurimin, dokumentimin, mbledhjen, paketimin, transportimin, ruajtjen dhe paraqitjen e provave nga vendngjarja deri në sallën e gjyqit. Kryeja e auditimeve periodike dhe vlerësime praktike për të siguruar zbatim konsistent të procedurave standarde operacionale dhe gjurmueshmëri të plotë të provave gjatë gjithë zinxhirit të ruajtjes.	M160510	Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore	FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.4	Krijimi dhe sigurimi i funksionimit të bazave të të dhënave për administrimit të të dhënave të ADN-së dhe daktiloskopike, në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", përfshirë duke përcaktuar	2.5.4	Instalimi dhe vënia në punë e bazës së të dhënave të ADN-së dhe gjurmëve të gishtave, me qëllime të qarta përpunimi, kontrolle aksesi, rregulla ruajtjeje dhe gjurmë auditimi, në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 për mbrojtjen e të dhënave personale. Zbatimi i garancive të sigurisë së të dhënave dhe kontrolleve	Pa Kod në PBA	Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore	FFA	2026	2028	-	

				qëllimet e ligjshme të përpunimit, kontrollet e aksesit, rregullat e ruajtjes, gjurmët e auditimit dhe garancitë e sigurisë së të dhënave për të mbrojtur të dhënat personale, ndërsa mundësohet krahasimi efektiv kriminalistik.		periodike të cilësisë, për të siguruar saktësinë, integritetin dhe përdorimin e ligjshëm të të dhënave kriminalistike.							
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.5	Rishikimi dhe përditësimi i programit fillestar dhe të vazhdueshëm të trajnimit për oficerët e Policisë Shkencore dhe personelin civil të Institutit të Policisë Shkencore, përfshirë vlerësimet e nevojave, përditësimin e kurrikulës, kërkesat e certifikimit/kompetencës dhe modulet praktike të harmonizuara me standardet ISO dhe metodat e reja kriminalistike.	2.5.5	Kryerja e vlerësimeve të nevojave për trajnim dhe përditësimi i kurrikulave, me qëllim që të reflektohen standardet ISO, metodat e reja kriminalistike dhe teknologjitë e reja. Zbatimi i moduleve të trajnimit bazuar në certifikim dhe kompetencë, përfshirë ushtrime praktike laboratorike dhe vlerësime të bazuara në skenarë.	91604AR	Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore/Akademia e Sigurisë	Instituti i Mjekësisë Ligjore; FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.6	Mundësimi i shkëmbimit me partnerët të të dhënave të automatizuara në fushën e të dhënave të ADN-së dhe daktiloskopike, në bazë të dispozitave të Marrëveshjes PCC Prum, duke siguruar ndërvepruesh mëri teknike, kanale të sigurta komunikimi, procedura të standardizuara të kërkimit dhe ndjekjes, si dhe pasjtueshmërinë me kërkesat e mbrojtjes së të dhënave.	2.5.6	Sigurimi i ndërvepruesh mërisë teknike dhe kanaleve të sigurta të komunikimit për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së dhe gjurmëve të gishtave me shtetet partnere, sipas Marrëveshjes PCC Prüm. Hartimi i procedurave të standardizuara për kërkimin, protokollet e ndjekjes dhe përputhshmërinë me garancitë e mbrojtjes së të dhënave, me qëllim që të sigurohet bashkëpunim kriminalistik ndërkufitar i ligjshëm dhe efikas.	91604AS	Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore	FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.7	Arritja e akreditimit të shërbimeve të ofruara nga Instituti i Policisë Shkencore sipas standardeve ISO, i zbatuar në faza, duke prioritizuar disiplinat shkencore me ndikim të lartë, duke kryer auditimet e brendshme, duke adresuar mospërputhjet (identifikimi, dokumentimi, vlerësimi dhe korrigjimi i devijimeve nga standardet e cilësisë së vendosur) dhe duke siguruar përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë	2.5.7	Prioritizimi i disiplinave kriminalistike me ndikim të lartë për akreditim fillestar dhe kryerja e auditimeve të brendshme për identifikimin dhe korrigjimin e mospërputhjeve. Zbatimi i proceseve të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë, përfshirë përditësimet e dokumentacionit, veprimet korrigjuese dhe rishikimet periodike të menaxhimit.	M160510	Polica e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore	FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.8	Hartimi një plani të dedikuar për zbatimin e metodave novatore në shkencat kriminalistike në luftën kundër krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera kriminale, përfshirë identifikimin e metodave prioritare, pajisjeve dhe trajnimit të kërkuar, procedurat e validimit dhe integrimin në flukset operacionale të punës.	2.5.8	Identifikimi i metodave kriminalistike prioritare novatore (p.sh., kriminalistika digjitale, ADN e shpejtë, balistika e avancuar) dhe përcaktimi i nevojave për pajisje, trajnim dhe validim. Integrimi i metodave të validuara në flukset operacionale të punës, për të rritur kapacitetin hetimor kundër krimit të organizuar.	Pa Kod në PBA	Mininstria e Punëve të Brendshme/Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore	FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.9	Mbështetja dhe forcimi i kapaciteteve për procesin e menaxhimit të cilësisë në nivel rajonal të hetimit të vendngjarjes dhe në nivel qendror, përfshirë përmes procedurave të harmonizuara, mentorimit, kontrolleve të brendshme dhe rishikimeve periodike të cilësisë për të siguruar zbatim konsistent të standardeve në të gjithë vendin.	2.5.9	Harmonizimi i procedurave të hetimit të vendngjarjes në të gjitha rajonet, përmes mentorimit, kontrolleve të brendshme dhe rishikimeve periodike të cilësisë. Ngritja e një kornize kombëtare të menaxhimit të cilësisë, duke siguruar zbatim konsistent të standardeve kriminalistike në të gjithë vendin.	91604AR	Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore	FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.10	Ngritja dhe mirëmbajtja e një regjistri për inventarin e pajisjeve kriminalistike duke identifikuar sistematikisht nevojat për kalibrim, mirëmbajtje, rinovim ose zëvendësim të tyre, përfshirë duke vendosur afate, caktuar përgjegjësi dhe siguruar gjurmueshmërinë e ndërhyrjeve për të mbrojtur besueshmërinë e rezultateve kriminalistike.	2.5.10	Krijimi i një regjistri të centralizuar që dokumenton kalibrimin, mirëmbajtjen, rinovimin dhe nevojat e zëvendësimit për të gjitha pajisjet kriminalistike. Zbatimi i mirëmbajtjes së planifikuar dhe procedurave të gjurmueshmërisë, për të siguruar besueshmërinë dhe saktësinë e rezultateve kriminalistike.	91604AS	Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore	FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.11	Hartimi i një plani investimi për 1, 3 dhe 5 vjet për ofrimin e shërbimeve të policisë shkencore, përfshirë nevojat e prioritizuara të prokurimit dhe infrastrukturës, buxhetimin dhe burimet e financimit, kërkesat për burime njerëzore dhe trajnim, dhe pikat e referimit të lidhura me akreditimin e shërbimit dhe objektivat e cilësisë.	2.5.11	Hartimi i planeve shumëvjeçare të investimeve që përfshijnë prioritetet e prokurimit, nevojat për infrastrukturë, kërkesat e burimeve njerëzore dhe programet e trajnimit. Lidhja e prioriteteve të investimeve me objektivat e akreditimit dhe synimet e përmirësimit të cilësisë, për të siguruar zhvillim strategjik të shërbimeve kriminalistike.	91601AA	Mininstria e Punëve të Brendshme/Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore	FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe	2.5.12	Ndërtimi i Serverit të Stacionit të Kontrollit në Distancë për të mundësuar krahasimin e drejtpërdrejtë të të dhënave daktiloskopike në sistemin AFIS	2.5.12	Ndërtimi dhe konfigurimi i Serverit të Stacionit të Kontrollit në Distancë për të mundësuar krahasimin e drejtpërdrejtë të të dhënave daktiloskopike në sistemin AFIS Papillon.	M160510	Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore	FFA	2026	2028	-	Donacioni IPA 2019

		pranueshmërinë e provave.		Papillon të Institutit të Policisë Shkencore, duke siguruar ndërlidhje të sigurt, kapacitet të mjafueshëm të serverit, integrim me flukset ekzistuese të punës dhe auditueshmëri të kërkimeve dhe përputhjeve									
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.13	Organizimi i trajnimeve dhe vlerësimeve periodike të kompetencave të ekspertëve të vendngjarjes, përfshirë vlerësimet praktike, proceset e certifikimit/ricertifikimit dhe ngritjen e kapaciteteve të shënjestruara për të garantuar zbatim konsistent të standardeve minimale të cilësisë dhe trajtim të duhur të provave.	2.5.13	Ofrimi i programeve periodike të trajnimit dhe ricertifikimi për ekspertët e vendngjarjes, përfshirë vlerësimet praktike dhe ushtrimet e bazuara në skenarë. Kryerja e vlerësimeve periodike të kompetencave, për të garantuar zbatim konsistent të standardeve të cilësisë dhe trajtim të duhur të provave.	91604AS; 91604AR	Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore/Akademia e Sigurisë	FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.14	Integrimi i IPSH në komunitetin ndërkombëtar të shkencave kriminalistike, përfshirë përmes pjesëmarrjes në rrjete përkatëse, shkëmbime dhe ushtrimet krahasimore, me qëllim përshtatjen modeleve, praktikave dhe metodave novatore të përdorura nga vendet e zhvilluara dhe brendësimin e tyre në politikat kombëtare të zhvillimit të shërbimit kriminalistik në Shqipëri.	2.5.14	Pjesëmarrja në rrjetet ndërkombëtare kriminalistike, shkëmbimet dhe ushtrimet krahasimore, për të përdorur praktikat më të mira dhe metoda novatore. Materializimi i modeleve ndërkombëtarë dhe i mësimeve të nxjerra në politikat kombëtare të zhvillimit të shërbimit kriminalistik.	91604AS	Ministria e Punëve të Brendshme/Instituti i Policisë Shkencore	FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.15	Rishikimi dhe propozimi i ndryshimeve ligjore në lidhje me mbledhjen e mostrave të ADN-së nga të dyshuarit dhe të arrestuarit, përfshirë duke sqaruar bazën ligjore, garancitë procedurale, kërkesat e zinxhirit të ruajtjes, periudhat e ruajtjes dhe garancitë e mbrojtjes së të dhënave, me qëllim forcimin e efektivitetit hetimor dhe respektimin e të drejtave themelore.	2.5.15	Kryerja e analizës së boshllëqeve ligjore dhe propozimi i ndryshimeve që sqarojnë bazën ligjore, garancitë procedurale, rregullat e zinxhirit të ruajtjes, periudhat e ruajtjes dhe garancitë e mbrojtjes së të dhënave. Garantimi që ndryshimet e propozuara të forcojnë efektivitetin hetimor, ndërsa të drejtat themelore respektohen plotësisht.	91601AA	Ministria e Punëve të Brendshme	Ministria e Drejtësisë; FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.16	Përditësimi i programeve të trajnimit me zhvillime të reja teknologjike, bazuar në nevojave të identifikuara dhe zhvillim trajnimeve për sigurimin dhe ekzaminimin e vendngjarjes, përfshirë modulet mbi pajisjet e reja, dokumentimin digjital, parandalimin e kontaminimit dhe integritetin e provave.	2.5.16	Integrimi, në kurrikulat e trajnimit, i pajisjeve të reja, i mjeteve të dokumentimit digjital, teknikave të parandalimit të kontaminimit dhe moduleve të integritetit të provave. Ofrimi i sesioneve praktike të trajnimit mbi sigurimin dhe ekzaminimin e vendngjarjes, duke përdorur metodologji të përditësuara.	91604AR	Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore/Akademia e Sigurisë	FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.17	Rishikimi dhe përditësimi i programit fillestar dhe të vazhdueshëm të trajnimit për oficerët e policisë gjyqësore, përfshirë modulet mbi koordinimin efektiv me ekspertët kriminalistë, trajtimin dhe referimin e provave, kërkimin dhe interpretimin e ekspertizave dhe paraqitjen në sallën e gjyqit të konstatimeve kriminalistike.	2.5.17	Përditësimi i moduleve të trajnimit për oficerët e policisë gjyqësore, mbi koordinimin efektiv me ekspertët kriminalistë, trajtimin e provave dhe procedurat e referimit. Ofrimi i trajnimit mbi kërkimin, interpretimin dhe paraqitjen e ekzaminimeve kriminalistike në gjykatë për të forcuar fuqinë provuese.	91604AR	Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore/Akademia e Sigurisë	FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.18	Forcimi i kapaciteteve teknike dhe profesionale për kryerjen e ekzaminimeve digjitale, përfshirë përmes personelit të specializuar, mjeteve moderne kriminalistike digjitale, metodologjive të standardizuara dhe trajnimit të vazhdueshëm për të mbështetur hetimet që përfshijnë pajisjet elektronike, provat *online* dhe gjurmët digjitale komplekse.	2.5.18	Rritja e personelit të specializuar dhe prokurimi i mjeteve digjitale moderne të kriminalistikës, për të mbështetur ekzaminimet e pajisjeve elektronike, provave *online* dhe gjurmëve digjitale komplekse. Zbatimi i metodologjive të standardizuara dhe trajnimit të vazhdueshëm për të siguruar produkte digjitale kriminalistike të cilësisë së lartë.	91604AS	Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore	FFA	2026	2028	-	
QP II	2.5	Shërbime kriminalistike të akredituara dhe të cilësisë së lartë, të cilat garantojnë integritetin, besueshmërinë dhe pranueshmërinë e provave.	2.5.19	Hartimi dhe shpërndarja e një udhëzuesi që përditësohet çdo vit, mbi paketimin dhe ruajtjen e provave fizike, problematikat e afateve, si dhe rishikimi i strategjisë për çështjet kriminalistike dhe protokolleve të marrjes në dorëzim, me qëllim që të sigurohet trajtim konsistent i provave dhe forcim i pranueshmërisë dhe besueshmërisë së rezultateve kriminalistike.	2.5.19	Hartimi dhe përditësimi i një udhëzuesi vjetor mbi paketimin, ruajtjen dhe trajtimin e provave fizike, përfshirë problematikat e afateve dhe protokollet e marrjes në dorëzim. Shpërndarja e udhëzuesit te të gjitha institucionet përkatëse dhe kryerja e trajnimit për të siguruar zbatim konsistent dhe pranueshmëri të përmirësuar të provave kriminalistike.	91604AR	Policia e Shtetit/Instituti i Policisë Shkencore	Ministria e Drejtësisë/Instituti i Mjekësisë Ligjore; FFA	2026	2028	-	
Nëntotali — OS 2.5												-	
OS 2.6 — Rritja e efektivitetit në gjurmimin, sekuestrim, konfiskimin dhe ripërdorimin e aseteve, duke hequr sistematikisht të ardhurat kriminale dhe duke i riinvestuar për dobi publike.													
QP II	2.6	Rritja e efektivitetit në gjurmimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe ripërdorimin e aseteve, duke hequr sistematikisht të ardhurat kriminale	2.6.1	Miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit nr. 44/2025 "Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve, duke përcaktuar organizimin e brendshëm, mandatet,	2.6.1	Hartimi, konsultimi dhe miratimi i të gjitha akteve nënligjore që kërkohen për ta bërë ZRA-në plotësisht funksionale, përfshirë organizimin e brendshëm, mandatet, flukset e punës dhe procedurat e bashkëpunimit me organet hetimore dhe të	91604AR	Policia e Shtetit	Ministria e Punëve të Brendshme	2026	2026	-	

